


# S4J

Aftësi për Punë  
Skills for Jobs




# Nga vizioni në realitet

Raste të suksesshme të një ore mësimore me platformën MësoVET



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



MINISTRIA E EKONOMISË,  
KULTURËS DHE INOVAÇIONIT

Zbatuar nga:

  
swisscontact

## Nga vizioni në realitet

Raste të suksesshme të një ore mësimore me platformën MËSOVET

Ky publikim është prodhuar nga projekti “Aftësi për Punë” (S4J) nën mbikëqyrjen e Menaxherit të Projektit, Fation Dragoshi. Publikimi u përgatit nga ekspertet e S4J Fjorela Pahumi dhe Dr. Edlira Kola. Botimi u finalizua pas konsultimit të përmbajtjes me mësuesit pjesëmarrës me mbështetjen e Belfiora Xhakolli.

### Rreth projektit “Aftësi për Punë” S4J

“Aftësi për Punë” S4J është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bash-këpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact. S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

Shënim: Pikëpamjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë publikim nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Qeverisë Zvicerane ose Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Autorësia e këtij publikimi i përket projektit “Aftësi për Punë” (S4J). Ndalohet riprodhimi dhe shpërndarja e publikimit pa miratim paraprak me shkrim nga S4J.

AFTËSI PËR PUNË S4J  
Rruga Skënderbej, Vila nr. 49  
Tirana, Albania, P.O. Box 2891  
+355 42 231 850  
al.info@swisscontact.org  
www.skillsforjobs.al



Hyrje .....	5
<b>Shkolla “Kolin Gjoka”, Lezhë .....</b>	<b>7</b>
Rasti i mirë 1 – Adriana Prenga .....	8
Rasti i mirë 2 –Jetmir Shtjefni .....	10
Rasti i mirë 3 – Dorina Gjergji .....	12
Rasti i mirë 4 – Dorina Dudi .....	14
<b>Shkolla “Gjergj Canco”, Tiranë .....</b>	<b>17</b>
Rasti i mirë 5 – Loreta Polaj.....	18
Rasti i mirë 6 – Ilda Shahu.....	20
Rasti i mirë 7 – Myzejen Menkulazi.....	22
Rasti i mirë 8 – Ornela Shehu .....	24
<b>Shkolla “Tregtare”, Vlorë .....</b>	<b>27</b>
Rasti i mirë 9 – Merita Koço.....	28
Rasti i mirë 10 – Nexhmije Gjondeda.....	30
Rasti i mirë 11 – Velide Llanaj .....	32
Rasti i mirë 12 – Edlira Brahimi.....	34
<b>Shkolla Teknike Ekonomike, Tiranë.....</b>	<b>37</b>
Rasti i mirë 13 – Elsa Vuksanaj .....	38
Rasti i mirë 14 – Violeta Hysnellari .....	40
Rasti i mirë 15 – Xhensila Peshkëpia.....	42
Rasti i mirë 16 – Alketa Avari.....	44
<b>Shkolla Profesionale Elbasan .....</b>	<b>47</b>
Rasti i mirë 17 – Alketa Kanani.....	48
Rasti i mirë 18 – Anila Hoxha.....	50
Rasti i mirë 19 – Viron Greco .....	52
Rasti i mirë 20 – Urani Sota .....	54
<b>Shkolla “Hamdi Bushati”, Shkodër .....</b>	<b>57</b>
Rasti i mirë 21 – Florian Çoku.....	58
Rasti i mirë 22 – Albjona Selimi .....	60
Rasti i mirë 23 – Dorina Dedgjonaj .....	62
Rasti i mirë 24 – Silvana Bushi .....	64
<b>Shkolla “Kristo Isak”, Berat.....</b>	<b>67</b>
Rasti i mirë 25 – Elda Polovina .....	68
Rasti i mirë 26 – Nertila Dundo .....	70
Rasti i mirë 27 – Gentiana Hazinedari .....	72
Rasti i mirë 28 – Resmi Tallas .....	74
Rasti i mirë 29 – Silvana Durra .....	76
<b>Shkolla Profesionale Elbasan.....</b>	<b>78</b>
Rasti i mirë 30 – Mirela Sarja.....	80
Rasti i mirë 31 – Julian Kasapi.....	82
Rasti i mirë 32 – Fabiola Grykshi .....	84
Në vend të mbylljes.....	86

## HYRJE

---

Realizimi i orës mësimore me bazë përmbajtjen digjitale dhe me pjesëmarrjen aktive të nxënësve, është një ndër prirjet kryesore të kohëve të fundit në fushën e edukimit, si një vlerë e shtuar në procesin e mësimdhënies dhe të nxënësve. Këtë qasje të re, projekti “Aftësi për Punë” (S4J) e ka mbështetur vazhdimisht ndër vite, si në aspektin e sigurimit të infrastrukturës digjitale dhe zhvillimit të përmbajtjes digjitale kurrikulare, ashtu edhe nëpërmjet aftësimin të mësuesve, drejtuesve dhe nxënësve. Edhe pse rëndësia e digjitalizimit të procesit mësimor është gjithnjë e më e pranuar, vihet re se disa mësues ende hasin sfida në përshtatjen me këtë orientim, qoftë për shkak të barrierave që përdorimi i teknologjisë mund të ngrëjë, qoftë për shkak të pasigurisë për suksesin e modaliteteve të reja të realizimit të mësimin.

Me synim kryesor intensifikimin e përdorimit të teknologjive digjitale dhe materialeve mësimore digjitale gjatë orës së mësimin, në vitin shkollor 2022-2023, S4J ndërmori nismën e organizimit të një maratone orësh të hapura mësimore të bazuaranë përdorimin e platformës digjitale MësoVET. Të konceptuara si të hapura, orët u ndoqën edhe nga kolegë të tjerë, për të ndarë me ta eksperiencën dhe për t'i nxitur e frymëzuar në përdorimin e platformës. Nën optikën e aplikimit të mësimin të kombinuar, kjo nismë u konsiderua si një promovim i shndërrimit të platformës digjitale MësoVET në pjesë integrale të përditshmërisë së procesit mësimor, si dhe si një mundësi për të çmitizuar idenë se mësimi i kombinuar dhe përdorimi i teknologjive digjitale mund të kryhet me sukses vetëm në kushte të përsosura infrastrukturore dhe vetëm nëse mësuesit kanë aftësi të spikatura digjitale. Përkëtë arsye, përzgjedhja e mësuesve u realizua duke synuar përfshirjen e tipologjive të ndryshme të tyre:

- si mësuesit që integrojnë vazhdimisht teknologjinë në procesin mësimor, ashtu edhe ata më pak të prirur ndaj saj;
- si mësuesit e lëndëve profesionale, ashtu edhe ato të lëndëve të përgjithshme;
- si mësuesit që mbulojnë lëndë për të cilat disponohen materiale mësimore digjitale në MësoVET, ashtu edhe mësuesit e lëndëve që nuk kanë materiale, për të cilët u shtuan veprimtari në platformë në përputhje me temën e trajtuar;
- si mësuesit më të familjarizuar dhe të aftësuar në aplikimin e mësimin të kombinuar, ashtu edhe ata më pak të ekspozuar me këtë modalitet;
- si mësuesit e rinj në profesion, ashtu edhe ata me përvojë më të gjatë.

Nismës iu bashkuan 32 mësues nga shkollat partnere të S4J:

- Shkolla “Kolin Gjoka” Lezhë: Adriana Prenga, Jetmir Shtjefni, Dorina Dudi, Dorina Gjergji
- Shkolla “Hamdi Bushati” Shkodër: Dorina Dedgjonaj, Albjona Selimi, Silvana Bushi, Florian Çoku
- Shkolla “Tregtare” Vlorë: Merita Koço, Velide Llanaj, Nexhmije Gjondeda, Edlira Brahimi
- Shkolla “Kristo Isak” Berat: Gentjana Hazinedari, Nertila Dundo, Silvana Durra, Elda Polovina, Resmi Tallas
- Shkolla Profesionale Elbasan: Viron Greco, Urani Sota, Alketa Kanani, Anila Hoxha, Julian Kasapi, Mirela Sarja, Fabiola Grykshi
- Shkolla Teknike Ekonomike Tiranë: Xhensila Peshkëpia, Alketa Avari, Elsa Vuksanaj, Violeta Hysenllari
- Shkolla “Gjergj Canco” Tiranë: Myzejen Menkulazi, Ornela Shehu, Ilda Shahu, Loreta Polaj

Procesi u organizua në këtë mënyrë. Me të gjithë mësuesit u zhvilluan takime të përbashkëta dhe individuale mbi realizimin e orës së hapurmësimore. Mësuesit u mbështetën nga ekipi i ekspertëve pedagogjikë, me të cilët u realizuan takime për planifikimin e orës, me në fokus identifikimin e veprimtarive mësimore, si dhe përzgjedhjen e modalitetit optimal të zhvillimit të tyre. Mësuesit bashkëpunuan ngushtë edhe me ekspertët e digjitalizimit, duke kryer përshtatjet e nevojshme të materialeve mësimore ekzistuese në platformë, apo duke shtuar aktivitete në rastin e zhvillimit të orëve të hapura në lëndë të cilat ende nuk disponojnë materiale në platformën MësoVET. Pas shkëmbimeve dhe dakordësive mbi planin e orës së hapur mësimore, nisi zhvillimi i tyre, me praninë e kolegëve të shkollës (mësues, drejtues, si dhe personat kyç të digjitalizimit), ekspertëve që mbështetën punën përgatitore dhe koordinatorëve rajonalë .

Me qëllim shtrirjen më tej të impaktit të orëve të hapura mësimore, si dhe mundësimin e replikimit të tyre nga mësues të tjerë të shkollave profesionale partnere dhe jo vetëm, nisma u finalizua me këtë publikim të përvojës së të gjitha orëve të zhvilluara.



# Rastet e mira

Shkolla "Kolin Gjoka", Lezhë

Mësuese:  
**Adriana Prenga**

Drejtimi:  
**Ekonomi-biznes**

Lënda:  
**Estetikë dhe marketing XII**


Tema/çështja:  
**Elementet e marketingut miks**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënit:**

1. Identifikon elementët miks të marketingut.
2. Shpjegon funksionet e elementëve të marketingut miks në ndërmarrjet hoteliere.
3. Bën dallimin midis shitjes dhe marketingut.
4. Argumenton rolin e marketingut në sektorin e mikpritjes.

**Metoda e aplikuar:**

PNP (Parashikim – Ndërtim njohurish – Përforcim)



## Planifikimi i orës mësimore

Faza e orës së mësimimit	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
Parashikimi	Parashikimi	Tradicional	—	3 min	Pyetje-përgjigje për të aktivizuar njohuritë
Parashikimi	“Reja” e fjalëve	Online, me pjesëmarrjen e nxënësve në platformë	Monitor; kompjuter (mësuesi); aparate celulare (nxënësit); platforma digjitale Mentimeter	5 min	Vendosje në aktivitetin e krijuar në mentimeter.com e fjalëve kyçe të lidhura me termin “PROCES”; sintetizim përgjigjesh
Ndërtimi i njohurive	Shpjegim / lojë me role	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës + tradicional	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	20 min	Referim në materialin digjital në platformë; konkretizim me shembuj; lojë me role
Përforcimi	Rrjet diskutimi	Tradicional	—	10 min	Diskutohet mbi njohuritë e sapomarra mbi marketingun
Përforcimi	Kuic	Online, me pjesëmarrjen e nxënësve në platformë	Monitor; kompjuter (mësuesi); aparate celulare (nxënësit); platforma digjitale MësoVET	5 min	Udhëzim mbi zhvillimin e kuicit; feedback mbi përgjigjet
	Caktim i detyrave të shtëpisë	Tradicional	—	2 min	Udhëzime për të punuar në grup

Efikasiteti i realizimit të veprimtarive mësimore shumëfishohet kur një pjesë e tyre zhvillohet me mbështetjen në materiale mësimore digjitale të vendosura në një platformë mësimore, veçanërisht kur kjo e fundit përdoret drejtpërdrejt nga nxënësit, me anë të pajisjeve digjitale të disponuara. Një efekt i tillë u konstatua edhe në orën mësimore të zhvilluar nga mësuesja Adriana Prenga, në kuadër të nismës së orëve të hapura. Në fillim të orës, mësuesja u kërkoi nxënësve të rikujtojnë se çfarë kanë mësuar mbi rolin e marketingut në orët e mëparshme, duke iu referuar edhe njohurive individuale të fituara nga burime dhe kontekste të tjera. Ora vazhdoi me prezantimin e temës së re, si dhe të objektivave për t'u arritur gjatë veprimtarive mësimore.

Një element interesant i orës ishte përdorimi i platformës Mentimeter (mentimeter.com), një mjet digjital me interaktivitet të lartë, në të cilën mësuesja kishte përzgjedhur paraprakisht një nga opsionet e ofruara nga kjo platformë, konkretisht “reja” e fjalëve – wordcloud. Me anë të këtij opsioni, nxënësit do të vendosnin në hapësirën përkatëse togfjalësha që lidhen me termin “PROCES”. Gjatë plotësimit të “resë” së fjalëve, mësuesja evidentonte vazhdimisht fjalët më të rëndësishme të lidhura me njohuritë. Për realizimin e veprimtarisë, nxënësit aksesuan në Mentimeter nga aparatet e tyre celulare. Gjatë gjithë kohës, mësuesja u tregua e gatshme për t'i asistuar teknikisht nxënësit në këtë veprimtari, e cila, edhe pse mori disa minuta më shumë nga ç'ishte planifikuar, ngjalli mjaft interes te nxënësit dhe krijoi efekt pozitiv në angazhim.

Në vazhdim, mësuesja kaloi në shpjegimin e temës së re, nëpërmjet platformës digjitale MësoVET, ku organizimii mirë i materialit digjital mbi termin “marketing” dhe ilustrimi i mirë i çështjeve e ndihmoi mësuesen në ruajtjen e një strukture logjike dhe konsistente gjatë shpjegimit sipas koncepteve. Për ta bërë më të kuptueshëm funksionin e marketingut dhe për t'i dhënë orës një dimension më praktik, duke iu mundësuar vetë nxënësve të ndërtojnë njohuritë gjatë orës mësimore dhe jo vetëm t'i presin pasivisht ato, mësuesja kishte planifikuar edhe zhvillimin e një loje me role. Loja ishte konceptuar në tri raunde, me qëllim nxjerrjen në pah të karakteristikave të ndryshme të marketingut. Përdorimi i mjeteve të tilla si: karriget, shishet, tabelat me mesazhe promovionale etj., e bëri lojën mjaft efikase në lidhje me përthithjen e njohurive, si dhe u ofroi nxënësve mundësinë për të nxënë në mënyrë argëtuese. Pas përfundimit të lojës me role, mësuesja i ftoi nxënësit të merrnin pjesë në një rrjet diskutimi mbi njohuritë që fituan në lidhje me marketingun, shoqëruar me ritheksim të koncepteve të tjera relevante, si dhe me komente të vazhdueshme saktësuese dhe përmbledhëse.

Krahas diskutimit, për të vlerësuar realizimin e kuptimit të informacionit të transmetuar, nxënësit zhvilluan edhe një kuic, duke përdorur sërish platformën MësoVET. Secili nxënës/e punoi në mënyrë individuale nga pajisjet celulare për të aksesuar në platformë. Në përfundim të orës, mësuesja caktoi edhe detyrën e shtëpisë, për t'u realizuar si punë në grup, shoqëruar edhe me instruksionet përkatëse.

### **Pikat e forta të orës mësimore**

- Përdorimi i burimeve dhe veprimtarive të larmishme për organizimin e orës së mësimit.
- Aktualizimi i konceptit me shembuj konkretë, të cilët ndihmuan në përvetësimin më efikas të njohurive nga ana e nxënësve.
- Integrimi i lojës me role, si një formë e përshtatshme për praktikimin e njohurive të temës së ditës dhe për demonstrimin konkret të konceptit të ri.

### **Këshilla për replikimin e orës**

- Përdorimi i platformës digjitale MësoVET edhe në zhvillimin e veprimtarisë për të cilën u përdor platforma Mentimeter, duke e zëvendësuar, për shembull, me një forum, për të mos rrezikuar shpërqendrim të nxënësve gjatë kalimit nga një platformë në tjetrën dhe për të qenë më të sigurt në nivelin e zotërimit të platformës.
- Shoqërimi i zhvillimit të kuicit me paraqitjen në monitor të rezultateve, për të evidentuar lehtësitë që krijon platforma nëpërmjet gjenerimit automatik të tyre dhe mesazhin e shpejtë që përcillet te mësuesi mbi pikat e forta dhe dobësitë e nxënësve.

Mësues:  
**Jetmir Shtjefni**

Drejtimi:  
**TIK**

Lënda:  
**Programet aplikative X**

Tema/çështja:  
**Funksionet e gatshme statistikore në Excel**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënit:**

1. Shpjegon funksionet e gatshme në Excel
2. Gjen mesataren përmes formulave të gatshme në Excel
3. Përdor funksionet e gatshme për gjetjen e Min dhe Max në Excel.

**Metoda e aplikuar:**

PNP (Parashikim – Ndërtim njohurish – Përforcim)



### Planifikimi i orës mësimore

Faza e orës së mëimit	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
Parashikimi	Brainstorming (stuhi mendimesh)	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Monitor; kompjuter (mësuesi); aparate celulare (nxënësit); platforma digjitale MësoVET	5 min	Logim në platformë; skanim i kodit QR
Parashikimi	Rifreskim njohurish	Tradicional	—	5 min	Strukturim i koncepteve të mëparshme; lidhje me temën e re
Ndërtimi i njohurive	Njohje me konceptet e reja / ilustrim /pyetje-përgjigje	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës + tradicional	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	15 min	Shfaqje e përmbajtjes së platformës në monitor; shpjegim i koncepteve; ndërveprim me pyetje-përgjigje; ilustrim me shembuj nëpërmjet platformës; demonstrim ushtrimesh në platformë nga monitori; lidhje ndërlëndore
Përforcimi	Detyrë klase	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Monitor; kompjuter (mësuesi); komputera (nxënësit); Google Drive	13 min	Punë në grupe; dhënie udhëzimesh nëpërmjet monitorit; dhënie vlerësimesh
Përforcimi	Kuic	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Monitor; kompjuter (mësuesi); komputera (nxënësit); platforma digjitale MësoVET	5 min	Dhënie udhëzimesh mbi realizimin e kuicit
Caktim i detyrave të shtëpisë		Duke shfaqur përmbajtjen e platformës + online (nga shtëpia)	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	2 min	Dhënie udhëzimesh për realizimin e detyrës dhe ngarkimin në platformë



Në temat mësimore në lëndët e TIK, kompetencat që nxënësit duhet të fitojnë lidhen kryesisht me aftësimin në aplikimin e programeve të ndryshme kompjuterike. Megjithatë, zhvillimi i orës duke iu referuar edhe një platforme digjitale mësimore si MësoVET, ku gjenden materiale mësimore dhe veprimtari që lehtësojnë dhe orientojnë punën e mësuesit dhe të nxënësit gjatë mësimin, është një vlerë e shtuar. I tillë është rasti i orës mësimore të zhvilluar nga mësuesi Jetmir Shtjefni, i cili arriti të shfrytëzojë lehtësitë e krijuara nga platforma në të mirë rifreskimit të njohurive të mëparshme, fitimit të atyre të reja, si dhe matjes së nivelit të kuptueshmërisë nga audienca.

Nxënësit ishin ulur në grupe dhe tavolinat ishin të pozicionuara në mënyrë të tillë që të mbështetnin punën në grup me anë të pajisjeve digjitale, një modalitet i aplikuar shpesh në mësimin e kombinuar. Mësuesi u kërkoi nxënësve të logohen nëpërmjet aparatit celular në platformën digjitale MësoVET dhe vendosi një timer (5 minuta) që të zhvillonin një stuhi mendimesh mbi temën e kaluar nëpërmjet skanimit të një kodi QR. Më pas, realizoi një strukturim të koncepteve që rezultuan nga veprimtaria dhe gradualisht bëri kalimin në temën e re mësimore. Gjatë shpjegimit të temës së re, theksi u vendos në përkufizimin e termit “formulë” dhe në shpjegimin e llojeve të formulave/funksioneve.

Gjithashtu, nëpërmjet punës në platformë, mësuesi realizoi ilustrim me shembuj konkretë, duke punuar ushtrime drejtpërdrejt në platformë, teksa nxënësit ndiqnin nëpërmjet monitorit. Ilustrimet u shoqëruan me pyetje nga mësuesi, duke i ftuar nxënësit në diskutim. Po ashtu, mësuesi krijoi edhe lidhjen ndërlëndore nëpërmjet njohurive të marra mbi funksionin nga kontekste të tjera lëndore, duke nxitur më pas nxënësit të krahasonin edhe mënyrat e ndryshme të përdorimit të funksioneve në programin Excel. Pas një pune ndërvepruese gjatë shpjegimit, nxënësit u ndanë në grupe dhe, duke iu referuar ilustrimit në monitor, nisën të punonin me detyrën e caktuar nga mësuesi. Detyra u punua në Google Drive, me asistimin dhe orientimet e vazhdueshme të mësuesit.

Të gjithë nxënësit u angazhuan në mënyre aktive në zhvillimin e detyrës dhe të gjitha grupet e kryen me sukses detyrën brenda afatit kohor të planifikuar. Në përfundim, mësuesi bëri vlerësimin e arritjes së objektivave të orës mësimore nëpërmjet një kuici të gjendur në platformë, ku nxënësit aksesuan nga pajisjet individuale. Zhvillimi i kuicit u pasua nga shfaqja dhe interpretimi i rezultateve në monitor, së bashku me saktësimet e nevojshme. Më pas, nxënësit u udhëzuan mbi kryerjen dhe ngarkimin e detyrës së shtëpisë në platformën MësoVET. Angazhimi i nxënësve ishte i lartë gjatë gjithë orës mësimore. Koordinimi dhe kalimi nëpërmjet fazave të ndryshme të orës mësimore ishte i natyrshëm. Menaxhimi i mirë kohës krijoi kushtet që nxënësit të punonin në një mjedis të relaksuar.

### **Pikat e forta të orës mësimore**

- Ndërthurja mes demonstrimit nëpërmjet platformës digjitale MësoVET dhe shpjegimit të konceptit.
- Transmetimi i informacionit të ri në mënyrë të thjeshtuar, duke krijuar lehtësi për nxënësit për t'u asimiluar.
- Qartësia dhe lehtësia e aplikimit të metodave të ndërveprimit të nxënësve në platformën MësoVET.

### **Këshilla për replikimin e orës**

- Ruajtja e linkut të Google Drive edhe në platformën MësoVET, duke përqendruar në një burim të vetëm të gjithë materialin digjital mësimor dhe veprimtaritë e zhvilluara.
- Kujdesi i vazhdueshëm për realizimin e veprimtarive online për shkak të përdorimit të platformave të ndryshme, duke asistuar dhe lehtësuar punën e nxënësve në to.

Mësuese:  
**Dorina Gjergji**

Drejtimi:  
**Ekonomi-biznes**

Lënda:  
**Kontabiliteti i ndërmarrjeve  
tregtare XII**


Tema/çështja:  
**Kontabilizimi i veprimtarive në  
ndërmarrjet tregtare / Shitjet dhe  
kontabilizimet e tyre**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënit:**

1. Përkufizon shitjet në ndërmarrjet tregtare.
2. Shpjegon funksionimin e llogarisë së të ardhurave nga shitja.
3. Regjistron shitjet në ndërmarrje.

**Metoda e aplikuar:**

PNP (*Parashikim – Ndërtim njohurish – Përforcim*)



### Planifikimi i orës mësimore

Faza e orës së mësimimit	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
Prezantimi i temës dhe i objektivave mësimorë		Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	2 min	–
Parashikimi	Parashikim me tema paraprakë	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Monitor; kompjuter (mësuesi); kompjuter/aparate celulare (nxënësit); platforma Padlet	13 min	Udhëzoi nxënësit që, duke përdorur njohuritë paraprake, me fjalët kyce të hartojnë një tekst/paragraf të shkurtër, duke krijuar fjalë që kanë lidhje logjike me fjalët e përdorura. Pasi iu lë kohën e nevojshme, prezantoi përgjigjet në platformë.
Ndërtimi i njohurive	INSERT	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës + tradicional	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	20 min	Duke shfrytëzuar përmbajtjen e platformës, nxënësit mbajnë shënime në fletore duke përdorur shenjat e teknikës INSERT. Pasi u lihet koha e nevojshme, diskutohet mbi informacionin që iu rezultoi në kundërshtim me atë që kanë ditur më parë, që njohin apo që kanë paqartësi. Jepen shpjegimet përkatëse për paqartësitë dhe informacionin e identifikuar si i ri
Përforcimi	Kuic (3 pyetje me alternativa)	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Monitor; kompjuter (mësuesi); kompjuter/aparate celulare (nxënësit); platforma digjitale MësoVET	5 min	Dhënie e udhëzimeve mbi kuicin; dhënie e feedback-ut të shpjegjet nga mësuesi pas përfundimit
Caktim i detyrave të shtëpisë		Duke shfaqur përmbajtjen e platformës + online (nga shtëpia)	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	5 min	Dhënie udhëzimesh për realizimin e detyrës dhe ngarkimin në platformë

Aktivizimi i nxënësve në platformën mësimore digjitale të përdorur rrit dukshëm efektivitetin e përvetësimit të njohurive. Këtë e vërtetoi edhe ora e hapur e zhvilluar nga mësuese Dorina Gjergji. Mësuesja e nisi orën mësimore me një prezantim të shkurtër të temës së ditës, si dhe të objektivave mësimore që ora synon të arrijë. Paraqitja e objektivave në monitor, falë shfrytëzimit të përmbajtjes së platformës MësoVET, i bëri nxënësit të përqendroheshin më lehtësisht dhe të kuptonin më mirë logjikën e veprimtarive vijuese.

U vazhdua më pas me fazën e parashikimit, e cila u realizua sërish nëpërmjet teknologjisë digjitale, por tashmë nëpërmjet një tjetër mjeti digjital, konkretisht me anë të platformës Padlet, ku nxënësit aksesuan për të hartuar një paragraf të shkurtër bazuar në fjalë kyçe të përvetësuar nga njohuritë e fituara më parë. Mësuesja ndoqi aktivitetin dhe postimet e nxënësve nëpërmjet shfaqjes së tabelës Padlet në monitor, duke prezantuar përgjigjet dhe duke realizuar edhe komente mbi disa prej tyre. Faza e ndërtimit të njohurive u mbështet në teknikën INSERT, sërish me përdorimin e platformës MësoVET.

Bazuar në përmbajtjen e platformës, që qëndronte e shfaqur në monitor, nxënësit u udhëzuan nga mësuesja për të mbajtur shënime në fletoret e tyre, sipas INSERT. Në vazhdim të veprimtarisë, nxënësit ndërvepruan me mësuesen dhe me njëri-tjetrin, duke identifikuar tri kategori informacioni: informacionin që iu rezultoi jo në linjë me atë që dinin, informacionin që ishte i njohur edhe më parë prej tyre, si dhe informacionin mbi të cilin kishin paqartësi apo vështirësi në të kuptuar. Mësuesja dha shpjegimet përkatëse sipas diskutimit të nxënësve dhe natyrës së informacionit të identifikuar.

Gradualisht, ora e mësimin shkoi drejt fazës së përfundimit të njohurive të sapofituara. Përfundimi u realizua nëpërmjet një kuici me tri pyetje me alternativa në platformën digjitale MësoVET, ku nxënësit morën pjesë drejtpërdrejt nga pajisjet individuale për zgjidhjen e tij. Në fund të kuicit, mësuesja dha feedback-un mbi saktësinë e përgjigjeve të nxënësve, duke theksuar njohuritë ku nxënësve do t'iu duhej të fokusoheshin më shumë për t'i konsoliduar. Në përfundim të orës së mësimin, mësuesja caktoi edhe detyrat e shtëpisë, duke dhënë udhëzimet përkatëse, si për realizimin e saj, ashtu edhe për mënyrën e ngarkimit në platformën MësoVET.

### **Pikat e forta të orës mësimore**

- Larmia e burimeve dhe mjeteve të përdorura në kuadër të veprimtarive tradicionale dhe online gjatë orës së mësimin.
- Shfrytëzimi optimal i kohës në dispozicion të orës mësimore, veçanërisht gjatë veprimtarive online, të cilat janë edhe më sfiduese për t'u menaxhuar në mënyrë eficiente.
- Integrimi i INSERT, si një teknikë efektive në fazën e ndërtimit të njohurive nga ana e nxënësve.

### **Këshilla për replikimin e orës**

- Kujdesi i shtuar në asistimin e nxënësve gjatë aktivizimit të drejtpërdrejtë në platformë, sidomos i atyre me aftësi digjitale jo aq solide, duke mundësuar përfshirjen dhe angazhimin e të gjithë nxënësve në veprimtaritë e zhvilluara.
- Paraqitja e rezultateve të aktiviteteve në platformë në kohë reale, duke shfrytëzuar nga kjo mundësi që ofron platforma për të evidentuar më mirë nivelin e njohurive të nxënësve dhe mungesën e informacionit, si dhe për të lënë gjurmë në aktivitete të tilla që mund të përdoren në vazhdimësi në kuadër të vlerësimit.

Mësuese:  
**Dorina Dudi**

Drejtimi:  
**Shërbim social dhe  
shëndetësor**

Lënda:  
**Bazat e sipërmarrjes XII**

Tema; çështja:  
**Konteksti i sipërmarrjeve, tregjet,  
klientela, konkurrenca; Konteksti  
për start-up/hapjen e  
sipërmarrjeve**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënit:**

1. Liston përfitimet social-ekonomike që sjell sipërmarrja.
2. Argumenton ndikimin e mjedisit në sipërmarrje duke mbajtur qëndrime.
3. Shpjegon hapat që ndiqen për të krijuar një start-up.

**Metoda e aplikuar:**

PNP (*Parashikim – Ndërtim njohurish – Përforcim*)



### Planifikimi i orës mësimore

Faza e orës së mësimit	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
	Prezantimi i temës dhe i objektivave mësimore	Me anë të teknologjisë (prezantim në PPT)	Monitor; kompjuter (mësuesi); programi PPT	2 min	Shfaqen në monitor çështja mësimore dhe objektivat
Parashikimi	Punë individuale: nxitja e mendimit	Me anë të teknologjisë (prezantim në PPT)	Monitor; kompjuter (mësuesi); programi PPT	3 min	Pajisje e nxënësve me një fletë me fotografinë e një torte (shfaqje edhe në monitor); ndarje e tortës në 8 pjesë të barabarta me tri lëvizje
Ndërtimi i njohurive	Shpjegim / forum	Duke shfaqur Mësovet + online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	15 min	Prezantim i koncepteve të reja; pyetje-përgjigje të shpejta; pjesëmarrje në forum
Ndërtimi i njohurive	Punë në grup	Tradicional + online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Flipchart; letra me numra për ndarjen e grupeve; lapustila; monitor; kompjuter (mësuesi); laptopë (nxënësit);	15 min	Ndarje e klasës në grupe pune; propozim idesh për krijim start-up ndërveprim mes nxënësve mbipunën e secilit grup; postim nëplatformë mbi eksperiencën e secilit grup gjatë veprimtarisë
Përforcimi	Kuic	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Monitor; kompjuter (mësuesi); laptopë (nxënësit); platforma MësoVET	15 min	Kuic me 3 pyetje; dhënie e udhëzimeve; dhënie e feedback-ut pas përfundimit
Përforcimi	Feedback	Tradicional	Foto	3 min	Nxënësit përzgjedhin nga një foto dhe e interpretojnë
	Caktim i detyrave të shtëpisë	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës + online (nga shtëpia)	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	2 min	Udhëzime mbi realizimin e detyrës (ndërtim i strat-up sipas hapave) dhe ngarkimin në platformë



## Realizimi i orës mësimore

---

Sa më i pasur të jetë një material mësimor digjital në platformën mësimore të përdorur, aq më e larmishme dhe tërheqëse bëhet edhe ora e mësimi. Kjo u dëshmuar më së miri edhe në rastin e orës së hapur të zhvilluar nga mësuese Dorina Dudi. Në fillim të orës, në kuadër të fazës së parashikimit, mësuesja rimori njohuritë e transmetuara në temën e mëparshme, në mënyrë verbale dhe nëpërmjet shfaqjes së përmbajtjes së platformës MësoVET në monitor, me synim për të bërë një lidhje graduale e të natyrshme me njohuritë e reja. Më pas, u vijua me një aktivitet individual në formë loje, tashmë në formatin tradicional, ku nxënësit u nxitën të mendonin në mënyrë kreative se si të ndanin një tortë në foto sipas kushteve të përcaktuara.

Loja krijoi një atmosferë dinamike dhe nxënësit u angazhuan plotësisht. Ora vazhdoi me fazën e ndërtimit të njohurive, bazuar në prezantimin e përgatitur për çështjen e ditës. Ilustrimet dhe referimi ndaj shembujve konkretë iu erdhën në ndihmë nxënësve për të përvetësuar njohuritë në mënyrë më efektive. Me shkathtësi, u realizua kalimi në një tjetër veprimtari, kësaj radhe të konceptuar në trajtë forumi, me aktivizimin e nxënësve në platformën MësoVET. Pas logimit, nxënësit bënë postimet e tyre individuale, duke iu përgjigjur pyetjes së shtruar në forum.

Mësuesja ndihmonte gjatë gjithë kohës nxënësit për t'u loguar në platformë, si dhe i orientonte ata në aspektin teknik për të marrë pjesë në aktivitet. Pas përgjigjeve të nxënësve dhe diskutimit të tyre në grup, u vazhdua me shpjegimin e koncepteve, duke i thjeshtuar dhe konkretizuar ato me shembuj të ndryshëm. Më pas, mësuesja organizoi tri grupe nxënësish dhe secili prej tyre krijoi një ide startup-i, që u prezantua para klasës nga liderët e grupeve, teksa pjesëtarët e tjerë diskutonin dhe plotësonin nga vendi. Pas përfundimit të prezantimit të punës në grupe, mësuesja i ftoi nxënësit t'i drejtoheshin sërish pajisjeve të tyre për të aksesuar në platformën MësoVET, kësaj radhe për të dhënë një vlerësim mbi eksperiencën e punës në grup.

Platforma vazhdoi të shoqërojë veprimtaritë e orës mësimore nëpërmjet zhvillimit të një kuici në materialin mësimor digjital, bazuar në tri pyetje mbi temën mësimore. Në përfundim, nxënësit u njohën edhe me rezultatet e përgjigjeve nëpërmjet gjenerimit automatik të informacionit nga platforma. Pas realizimit të kuicit, mësuesja e pasuroi orën mësimore me një tjetër aktivitet. Nxënësve iu kërkua të zgjedhin një foto menjë imazh të caktuar dhe të shpjegojnë se si simbolika e imazhit lidhet më temën dhe orën mësimore.

Në fazën përfundimtare, mësuesja prezantoi një lojë, pjesë e materialit mësimor digjital në platformën MësoVET, e cila iu caktua nxënësve si detyrë shtëpie. Me marrjen e udhëzimeve përkatëse mbi zhvillimin e detyrës, ngarkimin e saj në platformë, si dhe me përcaktimin e afatit të realizimit të saj, u përmyll edhe ora mësimore.

### **Pikat e forta të orës mësimore**

- Larmia e materialeve mësimore të përdorura, që rezultoi në një orë mësimore të pasur në veprimtari dhe mjaft tërheqëse për nxënësit.
- Përfshirja e punës në grup gjatë veprimtarive të planifikuara, duke krijuar një efekt më angazhues të nxënësve dhe duke i mobilizuar më shumë ata në ndërtimin dhe përfundimin e njohurive.
- Ndëraktiviteti i vazhdueshëm mes mësueses dhe nxënësve, si dhe të nxënësve me njëri-tjetrin.

### **Këshilla për replikimin e orës**

- Për kolegët që dëshirojnë të risjellin këtë model ore mësimore në klasat e tyre, ekspertët sugjerojnë vëmendje në asistimin e nxënësve gjatë aktivizimit në veprimtaritë përmes platformës, si në rastin e forumit, për të mundësuar pjesëmarrjen e të gjithëve dhe për të menaxhuar më së miri kohën në dispozicion.
- Gjithashtu, duke qenë se ora përfshin një sërë veprimtarish mësimore, ekspertët sugjerojnë një planifikim të mirë të kohës në dispozicion të secilit aktivitet.

SHKOLLA  
**TEKNIKE**  
**GJERGJ CANCO**

**Rastet e mira**

Shkolla "Gjergj Canco", Tiranë

Mësuese:  
**Loreta Polaj**

Drejtimi:  
**TIK**

Lënda:  
**Bazat e programimit 11**


Tema/çështja:  
**Elementët bazë të programimit në gjuhën C++ / Llojet e operatorëve**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënit:**

1. Liston llojet e operatorëve.
2. Përshkruan funksionin e operatorëve.
3. Ndërton ushtrime me operatorët në c++.

**Metoda e aplikuar:**

PNP (Parashikim – Ndërtim njohurish – Përforcim)



### Planifikimi i orës mësimore

Faza e orës së mëimit	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
Evokimi	Bashkëbisedim: (Përshkrimi i rregullave të variablove dhe deklarimi i tyre / Ndërtimi i kodit në dev c++ për afishimin e vlerave të variablove)	Nëpërmjet programeve kompjuterike të fushës	Smart TV; kompjuter (mësuesi); programi Dev c++	7 min	Diskutim mbi rregullat e variablit; implementimi dhe ekzekutimi i kodeve ne program
Prezantimi i temës dhe i objektivave mësimorë		Tradicional	–	5 min	Njohje e nxënësve me temën e ditës dhe objektivat për t'u arritur
Realizimi i kuptimit	Mësimdhënie në bashkëpunim / diskutim	Nëpërmjet programeve kompjuterike të fushës	Smart TV; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	25 min	Diskutim mbi operatorët e ndryshëm të për kryer veprime aritmetike, logjike, për krahasuar vlerat, etj . Operatorët në c++: Arithmetic operators, Assignment operators, Comparison operators, Logical operators
Reflektimi	Kuic (4 pyetje me alternativa)	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Smart TV; kompjuter (mësuesi); kompjuter (nxënësi); platforma digjitale MësoVET	6 min	Dhënie e udhëzimeve mbi kuicin; zhvillim individual i kuicit; dhënie e feedback nga mësuesi pas përfundimit
Caktim i detyrave të shtëpisë	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës + online (nga shtëpia)		Smart TV; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	2 min	Dhënie udhëzimesh mbi realizimin e detyrës dhe vendosjen në platformë

Zhvillimi i një ore mësimore me bazë platformat digjitale i shton vlerë procesit mësimor edhe kur bëhet fjalë për nxënës të drejtimit TIK. Ora e hapur e mësuese Loreta Polaj e dëshmoi mjaft mirë këtë gjë. Mësuesja e nisi orën e mësimimit me rimarrjen e koncepteve kryesore nga ora e kaluar. Kjo u arrit nëpërmjet ndërveprimit ballë për ballë me nxënësin, duke evidentuar konceptet bazë: variablet dhe tiparet e tyre, rregullat e variablit dhe deklarimi i tyre, si dhe mënyrat e përcaktimit të variableve.

Kështu, veprimtaria e parë e mësimdhënësit ishte evokimi, në formën e bashkëbisedimit dhe pyetjeve të herëpashershme, ndërthurur me ndërtimin e kodit në Dev ++ për afishimin e vlerave të variableve. Më pas, mësuesja nisi diskutimin me nxënësit rreth detyrës së orës së mëparshme. Nxënësit u aktivizuan me dëshirë për të ekzekutuar veprimet kryesore në Dev ++, kunxënësit e tjerë ndanë njohuritë e tyre, mbështetur në ilustrimet e demonstruara në Smart TV. Nxënësi aktivizuar ekzekutonte kodet në ekran para nxënësve të tjerë. Mësuesja ndërkohë hidhte hipoteza të ndryshme, me pohime të sakta apo të gabuara, duke nxitur diskutimin mes nxënësve. Pas ekzekutimit të veprimtarisë, mësuesja pyeti të gjithë nxënësit për aspekte të paqarta mbi ushtrimin.

Në vazhdim, i njohu nxënësit me temën e re të mësimimit, duke rikujtuar informacionet që ata patën marrë nga ora e parë e temës aktuale. Gjatë kësaj kohe, mësuesja u prezantoi nxënësve edhe objektivat e orës mësimore. Veprimtaria e radhës ishte thëllimi në njohuritë e reja nëpërmjet një videoje ilustruese, duke përdorur Smart TV, me qëllimin për të inkurajuar diskutimet me nxënësit. Gjatë kësaj kohe, mësuesja evidentoi informacionin e ri, duke e shkruar në tabelë, për të ndihmuar nxënësit në përforsimin e njohurive të synuara për t'u fituar. Kështu, ilustrimi i videos me pauza të herëpashershme, si dhe shkrimi i shënimeve në tabelë, nxitur edhe nga diskutimi i nxënësve, u zhvilluan në mënyrë paralele. Pas mbarimit të videos, mësuesja diskutoi me nxënësit rreth pyetjeve që lidhen me temën e re mësimore.

Faza e radhës e orës mësimore lidhej me përdorimin e metodologjisë “Mësimdhënie në bashkëpunim”. Mësuesja i ndau nxënësit në grupe, ku i dha të drejtën njërit prej nxënësve për t'u vetëpërcaktuar si lider i grupit. Secilit grup iu dhanë detyrat përkatëse, së bashku me udhëzimet, për një hark kohor prej 10 minutash në dispozicion. Mësuesja u siguroi që çdo nxënës të përfshihej në grupet e punës, si dhe theksoi gatishmërinë për të adresuar çdo paqartësi gjatë procesit. Mëtej, vijoi me monitorimin e punës së secilit grup, për t'u siguruar që gjithçka ishte kuptuar qartë. Qarkullimi i mësueses në grupe të ndryshme i ndihmoi nxënësit të ndiheshin më të sigurt kur ishin në dilemë për përgjigjen e saktë. Nxënësit shkëmbyen punën në grupe dhe krahasuan punën e secilit prej tyre, duke dhënë feedback-un sipas mendimit individual, si dhe duke evidentuar ndryshimet mes grupeve. Procesi u ndoq nga lideri i secilit grup, i cili prezantoi detyrën e realizuar nga grupi.

Veprimtaria e radhës ishte realizimi i kuicit nëpërmjet platformës MësoVET, me pjesëmarrjen e çdo nxënësi në platformë, ndihmuar nga mësuesja në rast vështirësie për t'u loguar. Në qetësi, nxënësit plotësuan kuicin dhe e dorëzuan automatikisht. Mësuesja injohu nxënësit me afatin dhe të drejtën e plotësimin të kuicit edhe jashtë orës mësimore. Më pas, me anë të SmartTV, i udhëzoi nxënësit për detyrën e shtëpisë, e cila do të realizohej në platformën MësoVET. Në fund, mësuesi evidentoi dy nxënësit më aktivë gjatë orës mësimore, si dhe bëri vlerësimet përkatëse.

### **Pikat e forta të orës mësimore**

- Menaxhimi i suksesshëm i kohës në dispozicion të orës së mësimimit, duke garantuar efikasitetin e secilës veprimtari mësimore dhe instrument vlerësimi.
- Ndërthurje dhe zhvendosje e natyrshme mes veprimtarie, pa cenuar efikasitetin e tyre dhe pa krijuar shpërqendrim të nxënësit.

### **Këshilla për replikimin e orës**

- Dhënia e feedback-ut mbi përgjigjet e kuicit të dhëna nga nxënësit, duke u siguruar për njohjen e opsioneve të sakta nga ana e të gjithë nxënësve dhe duke i argumentuar ato.
- Përdorimi i platformës me pjesëmarrjen aktive të nxënësve në të jo vetëm për realizimin e kuicit, por edhe për ndonjë tjetër veprimtari, si p.sh. forumi, për të rritur më shumë angazhimin gjatë orës së mësimimit.



Mësuese:  
**Ilda Shahu**

Drejtimi:  
**Elektroteknikë**

Lënda:  
**Letërsi X**


Tema/çështja:  
**Hamleti (koment)**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënit:**

1. Zbërthen tekstin për koment.
2. Identifikon motivin dhe mesazhin e përcjellë në tekst.
3. Evidenton tiparet kryesore të personazheve të veprës.

**Metoda e aplikuar:**

PNP (Parashikim – Ndërtim njohurish – Përforcim)



### Planifikimi i orës mësimore

Faza e orës së mëimit	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
Prezantimi i temës dhe i rezultateve të të nxënit		Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Smart TV; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	2 min	Njohje e nxënësve me rezultatet e të nxënit për t'i orientuar më mirë në veprimtari
Parashikimi	Pyetje-përgjigje nga vendi	Tradicional	–	5 min	Nxënësve iu drejtohen pyetje të shkurtra për rifreskim njohurish
Ndërtimi i njohurive	Shfaqje e një videoje/pyetje-përgjigje	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Smart TV; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET;	10 min	Ndjekje dhe komentim i videos nga nxënësit; pyetje të shpeshta mbi përmbajtjen e videos
Ndërtimi i njohurive	Lojë me role/pyetje-përgjigje	Tradicional	Teksti mësimor	12 min	Caktim i roleve për leximin e tekstit; pyetje për evidentim elementesh kyçe
Përforcimi	Ushtrime në tekst	Tradicional	Teksti mësimor	8 min	Punë në grup sipas ushtrimeve; dhënie feedback-u mbi përgjigjet e nxënësve
Përforcimi	Kuic (pyetje me alternativa)	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Smart Tv; kompjuter (mësuesi); laptopë (nxënësit); platforma digjitale MësoVET	5 min	Dhënie e udhëzimeve mbi kuicin; zhvillim i kuicit dhe saktësim përgjigjesh
Caktim i detyrave të shtëpisë	Forum	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës + online (nga shtëpia)	Smart TV; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	3 min	Dhënie udhëzimesh për realizimin e detyrës dhe ngarkimin në platformë; diskutim i forumit në orën e ardhshme

## Realizimi i orës mësimore

---

Mundësitë për të përdorur teknologjitë digjitale në orët mësimore nuk kufizohen nga natyra e lëndës. I tillë është edhe rasti i lëndës së Letërsisë, zhvilluar nga mësuese Ilda Shahu. Ora mësimore e hapur nisi me rimarrjen e njohurive të mëparshme, duke evidentuar pikat kyçe të veprës së studiuar, me qëllim për të evidentuar mesazhin e përcjellë, tiparet e personazheve, si dhe sjelljet e tyre. Gjatë kësaj kohe, mësuesja i njohu nxënësit me rezultatet e të nxënësve që synohen të arrihen deri në fund të orës mësimore. Nëpërmjet platformës digjitale MësoVET, mësuesja shfaqti një video ku u transmetua edhe mesazhi i pjesës. Ndërkohë, mësuesja ndërpriste herë pas here videon për t'i drejtuar pyetje nxënësve, duke u dhënë hapësirë për diskutim. Mësuesja qarkullonte vazhdimisht në klasë për të qenë më pranë nxënësve dhe për t'i nxitur edhe ata në shtrimin e pyetjeve në rast paqartësish.

Në vazhdimësi, mësuesja i orientoi nxënësit të lexonin tekstin, duke i ndarë në role, teksa drejtonte edhe pyetje me qëllim evidentimin e disa tipareve të veçanta të shfaqura, duke e lidhur edhe me përmbajtjen e videos së ndjekur. Nxënësit u aktivizuan me dëshirë për t'u përgjigjur pyetjeve të mësueses, e cila solli edhe shembuj nga jeta e përditshme, për të qenë më e kuptueshme nga të gjithë. Referimi në shembuj të tillë i ndihmoi veçanërisht nxënësit në evidentimin e figurave letrare.

Pas kësaj veprimtarie, mësuesja u kërkoi nxënësve të realizojnë ushtrimet në fund të tekstit, me qëllim për të kontrolluar në ç'nivel ishin fituar njohuritë. Nxënësit u ndanë në grupe dhe punuan sipas ushtrimeve në tekst. Gjatë zgjidhjes së ushtrimeve, pas një kohe të vënë në dispozicion, mësuesja realizoi një përmbledhje të përgjigjeve të sakta, për të qartësuar më mirë konceptet, duke pyetur edhe nxënësit mbi vështirësitë e ndeshura apo aspekte që kërkonin më shumë shtjellim.

Në vazhdim, mësuesja i orientoi nxënësit të aksesojnë platformën dhe të realizojnë kuicin, duke evidentuar mundësinë e zhvillimit të tij edhe pas orës së mësim, në një moment të përshtatshëm për ta. Fleksibiliteti në raport me punën në platformë u rikthehua edhe duke iu sugjeruar nxënësve të rindiqnin në një moment të dytë videon e shfaqur gjatë orës së mësim. Më pas, mësuesja dha një feedback të përgjithshëm mbi punën e realizuar në klasë, si dhe përmbledhi mesazhet kryesore të ditës. Në fund të orës, nxënësit morën udhëzimet për detyrën e shtëpisë, nëpërmjet postimit në një forum në platformë, përgjigjet e të cilit do të diskutoheshin orën e ardhshme.

### **Pikat e forta të orës mësimore**

- Angazhimi i mësueses për ta qartësuar sa mirë tematikën e re, duke zbatuar një larmi teknikash dhe qasjesh, në mënyrë tradicionale dhe virtuale, me synimin për të aftësuar maksimalisht nxënësit në komentine pjesës letrare.
- Asistimi i mësueses në çdo veprimtari të nxënësve, duke i mbështetur me udhëzime për logimin në platformë dhe gjatë kryerjes së veprimtarive online.
- Mobilizimi i vazhdueshëm i nxënësve nëpërmjet drejtimit të pyetjeve nga mësuesja, duke mundësuar përqendrim dhe aktivizim të lartë të nxënësve gjatë orës së mësim.

### **Këshilla për replikimin e orës**

- Orientimi i nxënësve për ndjekjen e videos para ardhjes në orën mësimore, duke aplikuar modalitetin e klasës së përmbysur, me qëllim shfrytëzimin optimal të kohës gjatë orës së mësim, si dhe dhënien e komenteve më të mirë menduara nga ana e nxënësve.
- Përdorimi i platformës me pjesëmarrjen e nxënësve edhe në ndonjë veprimtari tjetër, si p.sh. integrimi i një forumi diskutimi gjatë orës së mësim, për t'u dhënë mundësi të gjithë nxënësve të angazhohen.

Mësuese:  
**Myzejen Menkulazi**

Drejtimi:  
**Elektroteknikë**

Lënda:  
**Praktikë profesionale XI**

Tema/çështja:  
**Riparimi i motorëve asinkronë njëfazorë të pajisjeve elektroshtëpiake**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënit:**

1. Evidenton shenjat konvencionale të pajisjeve të ndryshme të komutimit
2. Realizon skemën duke përdorur manualët përkatëse.
3. Përzgjedh pajisjet e komutimit.
4. Monton pajisjet e komutimit.
5. Kontrollon saktësinë e montimit.
6. Zbaton RST në punë dhe të mbrojtjes mjedisit.

**Metoda e aplikuar:**

PNP (Parashikim – Ndërtim njohurish – Përforcim)



**Planifikimi i orës mësimore**

Faza e orës së mëimit	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
Prezantimi i temës së modulit dhe i rezultatit mësimor		Tradicional	–	3 min	Nxënësit njihen me temën e modulit dhe rezultatit mësimor
Parashikimi	Pyetje-përgjigje	Tradicional	–	7 min	Nxënësve iu drejtohen pyetje mbi njohuritë e fituara më parë, referuar edhe shembujve të përditshmërisë
Ndërtimi i njohurive	Demonstrim (video)	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Smart TV; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET;	10 min	Nxënësit ndjekin një video ilustruese, si shembull për realizimin e veprimtarisë praktike vijuese
Ndërtimi i njohurive	Praktikim / pyetje-përgjigje	Komplete veglash (pincë, kaçavidë, indikator etj.); pajisje komutuese për komandimin e motorëve asinkronë njëfazorë (rele diferenciale, automat magnetotermik, buton komandimi, kontaktor dhe rele rryme); motorë asinkronë njëfazorë; fletë A4.	Teksti mësimor	20 min	Nxënësit ndahen në grupe sipas dëshirës dhe udhëzohen për të punuar për lidhjen e skemës së komandimit të motorit asinkron njëfazor ose për vizatimin e skemës; grupet asistohen sipas nevojës
Përforcimi	Ushtrime në tekst	Tradicional	Teksti mësimor	8 min	Punë në grup sipas ushtrimeve; dhënie feedback-u mbi përgjigjet enxënësve
Përforcimi	Kuic (3 pyetje me alternativa)	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Smart TV; kompjuter (mësuesi); kompjuter (nxënësi); platforma digjitale MësoVET	5 min	Dhënie udhëzimesh dhe feedback-u pas përfundimit

Tipari kryesor i orës mësimore të hapur, zhvilluar nga mësuese Myzejen Menkulazi, ishte ndërthurja e ekuilibruar mes njohurive teorike dhe praktikimit të tyre. Ora nisi me fazën e parashikimit, gjatë së cilës mësuesja rimori njohuritë e mëparshme, jo vetëm të orës paraardhëse, por edhe të fituara gjatë zhvillimit të modulit në tërësi. Pyetjet iu referoheshin vazhdimisht edhe situatave dhe shembujve të përditshmërisë, në shërbim të konkretizimit të njohurive. Të gjithë nxënësit ishin aktivë në dhënien e përgjigjeve dhe plotësimin e ndërhyrjeve të shokëve.

Në vazhdimësi, mësuesja qartësoi se çfarë do të realizohej dhe do të përvetësohej gjatë orës së mësimin, ndërkohë që në tabelë kishte skicuar modelet e ndryshme të motorrit, me qëllim shpjegimin e elementeve të reja, me ndërthurje të diskutimeve në klasë. U vijua me veprimtari demonstruese, duke hyrë gradualisht në fazën e dytë të orës mësimore, atë të ndërtimit të njohurive.

Më pas, u shpjegua mënyra se si nxënësit do të punonin gjatë praktikës, duke propozuar organizimin në tri grupe, sipas shkallëve të ndryshme të vështirësisë (skema e thjeshtë, skema mesatare, dhe skema e komplikuar). Nxënësit u instruktuan se si do të shpërndaheshin në grupe të ndryshme me dëshirën e tyre, në varësi të kompleksitetit të punës që do të realizonin. Për t'u siguruar që informacioni për mënyrën se si do të punohej në grup ishte marrë saktë, mësuesja realizoi edhe pyetje – përgjigje të shpejta me nxënësit.

Më pas, me anë të platformës digjitale MësoVET, mësuesja shfaqti një video ilustruese, ku evidentohej një skemë mbi mënyrën e lidhjes së elementeve të motorit. Pas përfundimit të videos, disa nxënës nisin të realizojnë lidhjen nga skemat reale të ndërtuara nga mësuesi, ndërkohë që pjesa tjetër vizatoi skemën në fletë A4/ fletore, bazuar në materialet që mësuesja kishte parapërgatitur për orën mësimore.

Mësuesja kontrollonte herë pas here grupet që punonin me lidhjen reale të skemave, si dhe monitoronte njëkohësisht nxënësit e tjerë të angazhuar në vizatimin e skemës. Gjatë kësaj kohe, mësuesja shpjegonte çdo element të paqartë të nxënësve dhe kontrollonte funksionimin e motorit, për secilin grup. Pas përfundimit të punës së nxënësve që ishin aktivizuar në punën praktike, mësuesja nxiti edhe aktivizimin e nxënësve të tjerë që vizatuan në fletore. Minutazhi i realizimit të punës praktike dhe skicimeve u shoqërua me dhënien e feedback-ut të herëpashershëm të mësueses për secilin grup.

Në fund të orës mësimore, nxënësit zhvilluan një kuic me tri pyetje me alternativa, kësaj radhe duke e aksesuar në platformën MësoVET, bazuar në orientimet e mësueses mbi logimin dhe zhvillimin e kuicit. Pas saktësimin të përgjigjeve të kuicit, mësuesja rimori pikat kyçe të punës së nxënësve dhe i përgëzoipër performancën. Ora rezultoi e pasur me aktivitete dhe e përqendruar në ndërtimin e njohurive me bazë praktikën, në përputhje me pritshmëritë e modulit.

### **Pikat e forta të orës mësimore**

- Aktivizimi i të gjithë nxënësve përgjatë gjithë orës mësimore, ndihmuar edhe nga organizimi i tyre në punë në grupe.
- Ndërthurja e përmbajtjes dhe e veprimtarive në platformë me praktikën e zhvilluar gjatë orës së mësimin, duke rezultuar në një kombinim optimal mes njohurive teorike të fituara dhe vënies së tyre në praktikë.
- Përkushtimi i mësueses ndaj çdo veprimtarie dhe paqartësisë të nxënësve, duke qëndruar në dispozicion veçanërisht për nxënësit që ndeshën njëfarë vështirësie në ndjekjen e ritmit të orës mësimore

### **Këshilla për replikimin e orës**

- Ndjekja paraprake e videos ilustruese, në formatin e klasës së përmbysur, në mënyrë që nxënësit të ishin të familjarizuar me përmbajtjen e saj para nisjes së veprimtarisë praktike në klasë.
- Planifikimi i kujdesshëm kohor i veprimtarive për t'u realizuar gjatë orës së mësimin, për të shfrytëzuar sa më mirë minutat në dispozicion të secilës veprimtari



Mësuese:  
**Ornela Shehu**

Drejtimi:  
**TIK**

Lënda:  
**Praktikë profesionale XI**

Tema/çështja:  
**Ndërtimi dhe menaxhimi i multimedia  
/ Prezantimi i faqes web me  
HTML dhe CSS**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënit:**

1. Përgatit vendin e punës.
2. Prezanton faqen web të krijuar me sintaksat e programimit HTML dhe CSS.
3. Prezanton komponentët kryesorë të sintaksës së programimit të faqes web: paragraf, tekst, lista, imazhe, buton, linqe, lidhje me rrjetet sociale etj.

**Metoda e aplikuar:**

PNP (Parashikim – Ndërtim njohurish – Përforcim)



### Planifikimi i orës mësimore

Faza e orës së mëimit	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
Parashikimi	Diskutim	Me anë të teknologjisë (prezantim në PPT)	Videoprojektor; kompjuter (mësuesi); programi PPT	7 min	Diskutim për krijimin e strukturës së faqes web duke përdorur sintaksen HTML me taget specifike, për stilizimin e saj përdoret sintaksa CSS dhe mënyrat e lidhjes me HTML.
Prezantimi i temës së modulit dhe i rezultatit mësimor		Tradicional	–	5 min	Njohja e nxënësve me temën e modulit dhe rezultatit mësimor
Ndërtimi i njohurive	Prezantim detyrash	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Videoprojektor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	25 min	Prezantimi i faqeve web të krijuara duke përfshirë përdorimin e sintakseve HTML dhe CSS me elementët përkatës, si: head, body, style, paragraph, tekst dhe formatimi i tij, lista, imazhe, buton, link, tabelë, përdorimi i ngjyrave, lidhja me rrjetet sociale etj. diskutim mbi detyrën / nxitje e vlerësimit nxënës-nxënës; identifikim i detyrës më të mirë
Përforcimi	Kuic (7 pyetje me alternativa)	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Videoprojektor; kompjuter (mësuesi); kompjuter (nxënësi); platforma digjitale MësoVET	8 min	Dhënie udhëzimesh mbi logimin individual në platformë; zhvillim i kuicit; feedback mbi përgjigjet e dhëna

## Realizimi i orës mësimore

---

Tashmë është provuar se integrimi i platformave digjitale në procesin mësimor i jep orës së mësimimit një dimension të ri angazhues për nxënësit, veçanërisht kur bëhet fjalë për orë të bazuara në praktikë, si ajo e zhvilluar në kuadër të nismës së orëve të hapura nga mësuesja Ornela Shehu. Veprimtaria e parë që mësuesja realizoi ishte aktivizimi i njohurive ekzistuese, duke nxitur diskutimin me nxënësit nëpërmjet pyetjeve mbi njohuritë kryesore të marra nga ora e mëparshme.

Në këtë fazë parashikimi, nëpërmjet videoprojektorit, mësuesja shfaq një material në Power Point me informacionin e përcjellë më parë. Nëpërmjet pyetjeve të shtuara nga mësuesja, nxënësit u aktivizuan në diskutim dhe ndërvepruan duke plotësuar njëri-tjetrin. Gradualisht, mësuesja nisi t'u prezantojë nxënësve se çfarë do të trajtojnë në këtë orë mësimi. Diskutimet u përqendruan në krijimin e strukturës së faqes web, duke përdorur sintaksën HTML.

Më pas, në kuadër të fazës së ndërtimit të njohurive, mësuesja shfaqti detyrat e nxënësve, të cilat ishin ngarkuar prej tyre në platformën digjitale MësoVET. Nëpërmjet vizualizimit të përmbajtjes së platformës me anë të videoprojektorit, disa nxënës prezantuan me radhë punët e tyre individuale. Detyra konsistonte në krijimin e një faqeje web, me tematikë të lirë, dhe kishin si qëllim zbatimin e njohurive të marrë rreth HTML dhe CSS. Linku i faqes së web-it gjendej në detyrën e krijuar nga mësuesja në platformë.

Nxënësit u nxitën nga mësuesja për të mos qëndruar pasivë gjatë prezantimit të detyrave, duke u ftuar vazhdimisht të shfaqin vlerësimet e tyre mbi cilësinë e detyrës, elementet që mund të përmirësoheshin apo aspekte që mund të ishin trajtuar ndryshe. Një qasje e tillë i dha impulse zhvillimit të mendimit kritik të nxënësit dhe krijoi një atmosferë të gjallë dhe ndërvepruese në klasë, por pa cenuar menaxhimin e saj. Paralelisht me diskutimet dhe kritikën konstruktive të nxënësve, prezantimet e detyrave u shoqëruan edhe me dhënien e feedback-ut nga ana e mësueses.

Veprimtaria e prezantimit të detyrës, duke e vizualizuar nëpërmjet platformës MësoVET, mundësoi edhe evidentimin e vështirësive që nxënësit kishin hasur gjatë realizimit të saj, veçanërisht gjatë kohës së kërkuar për ekzekutimin e sintaksës së CSS. Njohja e vështirësive shërbeu si pikë referimi për mësuesen për të bërë shpjegimet dhe qartësimet eneojshe. Pas prezantimit të disa detyrave, nxënësit nisën të diskutonin për të identifikuar detyrën e realizuar më mire, duke i dhënë orë mësimore trajtën e një konkursi. Mësuesja u kërkoi të gjithë nxënësve të votonin dhe nxiti argumentimin e preferencave të tyre mbi detyrat.

Në vazhdim, mësuesja i udhëzoi nxënësit për realizimin e një kuici me alternativa në platformën MësoVET. Gjatë procesit të logimit dhe gjatë zhvillimit të kuicit, ajo qëndroi e gatshme për të asistuar nga afër çdo nxënës në vështirësi, duke u pozicionuar në një rollehtësues gjatë kësaj veprimtarie online. Ora u përmbyll me dhënien e vlerësimeve nga mësuesja, me theks në përkushtimin dhe seriozitetin e treguar nga nxënësit në kryerjen e detyrës dhe në performancën gjatë prezantimit.

### **Pikat e forta të orës mësimore**

- Një shembull shumë i mirë për t'u replikuar edhe në orë të tjera mësimore të praktikës profesionale.
- Menaxhimi shumë i mirë i klasës, pavarësisht diversitetit të veprimtarive dhe modalitetit të zhvillimit të tyre.
- Kalimi me lehtësi nga njëra veprimtari e orës mësimore në tjetrën, falë shkathtësisë në përdorimin e platformës mësimore dhe ndërthurjes efikase mes veprimtarive të zhvilluara online dhe atyre tradicionale.

### **Këshilla për replikimin e orës**

- Hapja e një forumi në kuadër të detyrës së dhënë për t'u ngarkuar në platformë, për të mundësuar dhënien e feedback-ut individual mbi secilën detyrë nga ana e mësueses, duke e shtrirë kështu kombinimin e veprimtarive edhe në një proces kyç si përcjellja e feedback-ut.
- Në raste të replikimit të kësaj ore mësimore nga kolegë të tjerë, të kihet parasysh roli lehtësues i mësuesit.



# Rastet e mira

Shkolla "Tregtare", Vlorë

Mësuese:  
**Merita Koço**

Drejtimi:  
**Hoteleri-Turizëm**

Lënda:  
**Ushqim dhe pije X**


Tema/çështja:  
**Salcat bazë në kuzhinë**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënit:**

1. Identifikon llojet e salcave të ftohta dhe të nxehta.
2. Shpjegon dallimin në përgatitjen e salcave të ftohta nga salcat e nxehta.
3. Analizon proceset teknologjike në përgatitjen e salcave.

**Metoda e aplikuar:**

ERR (Evokim – Realizim i kuptimit – Reflektim)



### Planifikimi i orës mësimore

Faza e orës së mëimit	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
Prezantimi i temës dhe i objektivave mësimorë		Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	2 min	Nxënësve u prezantohet tema dhe objektivat mësimorë që synohen të arrihen
Evokimi	Aktivizim i njohurive të mëparshme	Tradicional	–	5 min	Pyetje-përgjigje të shpejta
Evokimi	Ndjekje videosh	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET; flipchart	7 min	Ndarje e nxënësve në dy grupe; diskutim mbi videot e ndjekura nga shtëpia; kalim gradual nga njohuritë e mëparshme tek ato të reja në përmbajtjen e videove; listim në dy flipcharte i koncepteve të reja të identifikuara
Realizimi i kuptimit	Përcjellje e njohurive të reja / plotësim i një harte mendore	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET; flipchart	20 min	Prezantohet materiali i ri i vendosur në platformë, duke iu referuar edhe shembujve nga përditshmëria; nxënësit aktivizohen në plotësimin e një harte mendore në flipchart mbi temën e re.
Reflektimi	Ushtrim (flashcards)	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Monitor; kompjuter (mësuesi); laptopë (nxënësit); platforma digjitale MësoVET	8 min	Dhënie udhëzimesh mbi punën në platformë; asistim i nxënësve që hasin vështirësi; diskutim i përgjigjeve dhe dhënie feedbacku dhe vlerësimi nga mësuesja.
Caktim i detyrave të shtëpisë	Forum	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës + online (nga shtëpia)	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	3 min	Dhënie udhëzimesh për realizimin e detyrës në platformë



## Realizimi i orës mësimore

Mënyra e konceptimit të orës mësimore nga ana e mësueses Merita Koço vendosi theksin mbi angazhimin e vazhdueshëm i nxënësve gjatë gjithë orës së mësimimit dhe mbi përdorimin konstant të përmbajtjes digjitale të platformës, për të shfrytëzuar sa më mirë kohën në dispozicion dhe për të lehtësuar procesin e aktivizimit të njohurive ekzistuese, si dhe atë të ndërtimit të njohurive të reja. Ora u mbështet pjesërisht në modelin e klasës së përmbysur, ku nxënësit ishin udhëzuar paraprakisht për të ndjekur dy video mësimore nëpërmjet platformës digjitale MësoVET dhe për të reflektuar mbi to para ardhjes në klasë.

Fillimisht, u prezantua tema e ditës dhe objektivat e orës së mësimimit. Më pas, ora u fokusua në rinfreskimin e njohurive të fituara më parë, teksa nxënësit, të vendosur plotësisht në qendër të procesit, përgjigjeshin, diskutonin dhe plotësonin lirshëm njëri-tjetrin. Të organizuar në dy grupe, nxënësit vijuan diskutimin mbi videot e ndjekura më parë në platformën MësoVET, të cilat u rishfaqën edhe gjatë orës së mësimimit, në mënyrë që secili grup të njihet me përmbajtjen.

Shfaqja e përmbajtjes së platformës në monitor ndikoi pozitivisht në ruajtjen e fokusimit të nxënësve dhe në vizualizimin e proceseve që u shpjeguan. Me ndihmën e mësueses, nxënësit evidentuan nga përmbajtja digjitale koncepte tashmë të njohura për ta, si dhe ndërtuan hap pas hapi njohuritë e reja të shfaqura në video. Të ndarë në grupe, nxënësit mundën të mësojnë edhe nga puna e realizuar nga grupi tjetër. Duke iu referuar edhe shembujve të përditshmërisë së nxënësve, u kalua natyrshëm nga faza e evokimit të njohurive drejt fazës së realizimit të kuptimit, gjatë së cilës mësuesja lehtësoi procesin e identifikimit të koncepteve të reja. Ndërtimi i njohurive të reja u përforcua edhe me plotësimin e fletëve të punës, të cilat mësuesja ua shpërndau grupeve të nxënësve për listuar elemente mbi bazën e një pyetjeje të shtruar.

Me shkathtësi të spikatur, mësuesja vizualizoi inputin e nxënësve në fletët e punës me anë të skematizimeve të shpejta në flipchart, në trajtë hartash mendore. Për të matur shkallën e kuptueshmërisë së informacionit të ri, u kalua më tej në fazën e reflektimit, nëpërmjet pjesëmarrjes individuale të nxënësve në njëushtim me flashcards në platformë. Me udhëzimin dhe asistimin e vazhdueshëm të mësueses, nxënësit interpretuan në platformën MësoVET imazhe të ndryshme, bazuar në njohuritë e fituara mbi temën e re.

Secili nxënës punoi sipas ritmit individual, duke tentuar disa herë dhënien e përgjigjeve, deri në marrjen e atyre të sakta. Drejt fundit të orës së mësimimit, mësuesja udhëzoi nxënësit mbi realizimin e detyrës së shtëpisë. Si detyrë, ishte planifikuar postimi në forumin e përfshirë në materialin mësimorë digjital, të disponueshëm në platformë, si një risi në konceptimin e detyrës së shtëpisë. Ora u finalizua me sintetizimin e njohurive të reja nga ana e mësueses, si dhe me shpërndarjen e disa fletëve të vogla me emoji, duke vlerësuar dhe motivuar nxënësit më aktivë gjatë orës së mësimimit.

### Pikat e forta të orës mësimore

- Shfrytëzimi optimal i mundësive që krijon platforma, duke ndërthurur modelin e klasës së përmbysur me atë të rotacionit sipas stacioneve, si dhe duke kombinuar një larmi veprimtarish mësimore dhe të vlerësimit.
- Integrimi i platformës digjitale përgjatë gjithë procesit të të nxënësve: para ardhjes në klasë (ndjekja e videove nga shtëpia), gjatë qëndrimit në klasë (veprimtaritë e zhvilluara online me pjesëmarrjen aktive të nxënësve) dhe pas orës së mësimimit (zhvillimi i detyrës së shtëpisë nëpërmjet platformës)
- Dhënia e kontrollit nga ana e nxënësve në disa aspekte të zhvillimit të veprimtarive online, si p.sh. puna sipas ritmit individual gjatë zhvillimit të ushtrimit me flashcards në platformë, duke mundësuar kryerjen e disa tentativave deri në dhënien e përgjigjes së saktë..

### Këshilla për replikimin e orës

- Marrja në konsideratë e aftësive digjitale të mësuesit/-es dhe të nxënësve, duke qenë se një model i tillë i orës mësimore karakterizohet nga një kalim i shpeshtë nga njëra veprimtari në tjetrën.
- Vëmendja e veçantë në sigurimin dhe mirëfunksionimin e mjeteve të punës dhe infrastrukturës fizike dhe digjitale, si rrjedhojë e mbështetjes së gjerë të veprimtarive mësimore në to.

Mësuese:  
**Nexhmije Gjondeda**

Drejtimi:  
**Hoteleri-Turizëm**

Lënda:  
**Llogari dhe kontabilitet Xlt**


Tema/çështja:  
**Regjistrimet kontabël në fushën e personelit**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënit:**

1. Evidenton listëpagesën e pagave dhe regjistron elementet e saj.
2. Shpjegon përmbajtjen, formën dhe domosdoshmërinë e listëpagesës së sigurimeve shoqërore.
3. Vlerëson, regjistron dhe kontabilizon në mënyrë të pavarur listëpagesën e sigurimeve shoqërore në një artikull të vetëm.

**Metoda e aplikuar:**

ERR (*Evokim – Realizim i kuptimit – Reflektim*)



### Planifikimi i orës mësimore

Faza e orës së mëimit	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
Prezantimi i temës dhe i objektivave mësimore		Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	2 min	Nxënësve u prezantohet tema dhe objektivat mësimorë që synohen të arrihen
Evokimi	Ndjekje videoje	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	5 min	Nxënësit identifikojnë konceptet e reja në përmbajtjen e videos
Evokimi	Kuic	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	5 min	Dhënie e përgjigjeve me gojë nga nxënësit; plotësim i kuicit nga mësuesja ndërkohë që shfaqet platforma në monitor
Realizimi i kuptimit	Përcjellje e njohurive të reja	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	15 min	Transmetim i koncepteve të reja, ndërthurur me shembuj konkretë dhe me pyetje-përgjigje të shpejta
Reflektimi	Lojë	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Monitor; kompjuter (mësuesi); laptopë/kompjuterat (nxënësit); platforma digjitale MësoVET	5 min	Lojë për identifikimin e koncepteve të reja në rrjetin e shkronjave (ëord search)
Reflektimi	Test kontrolli	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Monitor; kompjuter (mësuesi); laptopë/kompjuterat (nxënësit); platforma digjitale MësoVET	10 min	Dhënie udhëzimesh për zhvillimin e një testi për matjen e njohurive të fituara; asistim i vazhdueshëm i nxënësve sipas nevojës
Caktim i detyrave të shtëpisë	Ushtrim	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës + online (nga shtëpia)	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	3 min	Dhënie udhëzimesh për realizimin e detyrës dhe ngarkimin e saj në platformë

## Realizimi i orës mësimore

---

Ora mësimore e hapur e mësueses Nexhmije Gjondeda ishte një orë interesante, e bazuar gjerësisht në përmbajtjen e platformës, e cila ndihmoi në përqendrimin e nxënësve dhe në aktivizimin e vazhdueshëm të tyre. Ora nisi me prezantimin e temës dhe të objektivave mësimorë, duke orientuar nxënësit mbi pritshmëritë dhe synimet që ata duhet të kenë. Faza e evokimit u zhvillua nëpërmjet shfaqjes së një videoje në monitor nga platforma MësoVET, ku nxënësit u udhëzuan të tregojnë vëmendje ndaj termave kyç dhe t'i identifikojnë ata. Termat e evidentuar u komentuan edhe me ndihmën e mësueses.

Më pas, ora vijoi me një kuic në platformë, ku nxënësit u aktivizuan me gojë për dhënien e përgjigjeve, ndërsa mësuesja plotësonte fjalët në platformë sipas sugjerimeve të nxënësve, duke dhënë edhe feedback përkatës. U kalua gradualisht drejt temës së ditës, përmbajtja e së cilës u ndoq nga nxënësit nëpërmjet platformës së shfaqur në monitor. Fokusimi në tabelat dhe grafikët në platformë i ndihmoi nxënësit në kuptueshmërinë më të mirë të materialit dhe në ndërtimin e koncepteve të reja, me këmbënguljen e vazhdueshme të mësueses për të formuluar përkufizime dhe për t'i analizuar këto koncepte.

Përgjatë gjithë orës së mësimi, mësuesja theksoi vazhdimisht lehtësinë që krijon platforma në veprimtaritë mësimore, duke synuar edhe familjarizimin e nxënësve me të dhe ndërgjegjësimin e tyre mbi benefitet e përdorimit të saj gjatë orës mësimore. E gjithë fazatë realizimit të kuptimit u shoqërua me përdorimin e platformës, si dhe me disa pyetje-përgjigje të shpeshta, ku u aktivizua pjesa më e madhe e nxënësve. Veprimtaritë u pasuan nga zhvillimi i një loje për të rritur angazhimin e nxënësve. Duke punuar secili në platformë, nëpërmjet kompjuterave desktop ose laptopëve, nxënësit morën pjesë në lojën e përzgjedhur nga mësuesi, duke gjetur konceptet e reja në rrjetin e shkronjave (word search).

Me mbarimin e aktivitetit nga të gjithë nxënësit, njëri prej tyre e zhvilloi lojën nëpërmjet kompjuterit të mësueses, ndërkohë që pjesa tjetër e nxënësve ndoqi plotësimin nëpërmjet monitorit, duke verifikuar përgjigjet me ato të dhëna individualisht. Ora vazhdoi me realizimin e një testi kontrolli, sërish me pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve në platformë, me suportin dhe udhëzimet e nevojshme nga mësuesja.

Pas plotësimit të testit, teksa mësuesja asistonte nxënësit që kanë vështirësi, monitoronte dhe komentonte mbi përgjigjet, nëpërmjet tabelave përmbledhëse të rezultateve. Mësuesja arriti kështu të nxjerrë në pah shkallën e kuptueshmërisë dhe të përvetësimit të njohurive nga ana e nxënësve, si dhe, nëpërmjet dokumentimit dhe rishikimit më pas të rezultateve, të merre informacionin e nevojshëm orientues për të përshtatur sa më mirë metodat dhe teknikat e përdorura në orë në vijim. Në fund të orës së mësimi, mësuesja caktoi edhe detyrat shtëpisë, për t'u realizuar nga nxënësit në platformë.

### Pikat e forta të orës mësimore

- Përdorimi i platformës në funksion të të gjitha fazave të orës së mësimi, nga aktivizimi i njohurive ekzistuese deri në matjen e shkallës së fitimit të njohurive të reja.
- Integrimi i konceptit të lojës përgjatë orës së mësimi, ndihmuar nga veprimtaritë në platformë (word search).
- Shpjegimi i vazhdueshëm për nxënësit i mënyrës së konceptimit të temës në platformë dhe i veprimtarive të përfshira, në funksion të familjarizimit të tyre me përmbajtjen dhe logjikën e konceptimit dhe të përdorimit të platformës.

### Këshilla për replikimin e orës

- Qëndrimi fleksibël i mësuesit në raport me veprimtaritë mësimore, mënyrën e zhvillimit të tyre dhe minutazhin e parashikuar, për të menaxhuar në mënyrë optimale kohën në dispozicion të orës mësimore, në kushtet e një numri të konsiderueshëm veprimtarish, sidomos nëpërmjet platformës digjitale.
- Njohje e nxënësve me përmbajtjen e videos para ardhjes në orën mësimore (ndjekje nga shtëpia), për të mundësuar shfrytëzim më të mirë të kohës.
- Realizim i kuicit (faza e evokimit) me aktivizimin e vetë nxënësve në platformë, teksa mësuesi/-ja ndjek përgjigjet në monitor.

Mësuese:  
**Velide Llanaj**

Drejtimi:  
**Hoteleri-Turizëm**

Lënda:  
**Trashëgimi kulturore dhe  
historike XI**

Tema/çështja:  
**Krijimtaria popullore shpirtërore /  
Folklori muzikor instrumental dhe  
veglat muzikore popullore**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënit:**

1. Evidenton folklorin muzikor instrumental.
2. Klasifikon veglat muzikore popullore.
3. Analizon dhe vlerëson veglat muzikore më të rëndësishme.

**Metoda e aplikuar:**

PNP (*Parashikim – Ndërtim njohurish – Përforcim*)

### Planifikimi i orës mësimore

Faza e orës së mëimit	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
Parashikimi	Ndjekje videoje (rikujtesë: pyetje-përgjigje)	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	5 min	Ndërveprim me nxënësit: komente të shkurtra mbi përgjigjet
	Prezantimi i temës dhe i objektivave mësimorë	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	2 min	Njohje e nxënësve me temën e re dhe objektivat për t'u përmbushur
Parashikimi	Ndjekje videoje (lidhja me temën e ditës)	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	3 min	Ndërveprim me nxënësit: komente të shkurtra mbi përgjigjet
Parashikimi	Diskutim në forum	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	5 min	Udhëzim i nxënësve mbi vendndodhjen dhe zhvillimin e veprimtarisë në platformë; mësuesi ndjek përgjigjet nga platforma dhe komenton
Ndërtimi i njohurive	Video; pyetje/përgjigje të shpejta; rast studimor	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	20 min	Prezantohen konceptet e reja, duke iu referuar edhe një rasti studimor
Përforcimi	Kuic (pyetje me alternativa)	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Monitor; kompjuter (mësuesi); laptopë (nxënësit); platforma digjitale MësoVET	5 min	Dhënie e udhëzimeve mbi kuicin; dhënie e feedback-ut të shpejtë nga mësuesi pas përfundimit
Caktim i detyrave të shtëpisë		Duke shfaqur përmbajtjen e platformës + online (nga shtëpia)	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	5 min	Dhënie udhëzimesh për realizimin e detyrës dhe ngarkimin në platformë





## Realizimi i orës mësimore

---

Përdorimi i materialeve mësimore digjitale në lëndë që lidhen me elemente audio-vizuale, rrit ndjeshëm efikasitetin e përcjelljes dhe përvetësimit të njohurive të reja te nxënësit, duke i bërë ato edhe më të qëndrueshme në kohë. Në realizimin e orës mësimore nga mësuesja Velide Llanaj, mbi tematikën e folklorit muzikor instrumental dhe veglave muzikore popullore, përdorimi i platformës MësoVET rezultoi të ishte një vlerë e shtuar, si për mësuesen, edhe për nxënësit.

Në fazën e planifikimit të orës së mësimimit, mësuesja parashikoi integrimin e platformës përgjatë gjithë minutazhit në dispozicion, duke ndërthurur shfaqjen e përmbajtjes së saj në ekran me veprimtaritë online me pjesëmarrjen e nxënësve. Ora nisi me ndjekjen e një videoje në platformë, me qëllim rifreskimin e njohurive të fituara nga tema e mëparshme, shoqëruar me disa pyetje-përgjigje me gojë. Prurja e një elementi të tillë që në fillim të orës së mësimimit ndikoi pozitivisht në ngjalljen e kuriozitetit të nxënësve dhe në krijimin e pritshmërisë mbi mënyrën e organizimit të orës së mësimimit.

U vijua më tej me prezantimin e temës së re dhe të objektivave të orës mësimore, sërish duke i shfaqur në platformë. Faza e parashikimit u ndoq nga shfaqja e një videoje të dytë, e cila shërbeu për të lidhur njohuritë e fituara më parë me ato të reja. Vizualizimi i koncepteve nëpërmjet videos nxiti përqendrimin dhe ndërveprimin mes mësueses dhe nxënësve. Ora mësimore mori një tjetër dinamikë kur nxënësit u përfshinë drejtpërdrejt në një veprimtari në platformë, me anë të pajisjeve digjitale të vendosura në dispozicion. Sipas udhëzimeve të mësueses për aksesin në platformë dhe për mënyrën e realizimit të veprimtarisë, nxënësit morën pjesë në një diskutim, duke postuar përgjigjet e tyre në forumin e gjendur në materialin mësimor në platformë. Falë ndjekjes në monitor të ecurisë së postimit të përgjigjeve, mësuesja dhadisa komente mbi një pjesë të tyre.

Minutat në vazhdim iu kushtuan ndërtimit të njohurive të reja, ku u integrua ndjekja e një tjetër videoje me konceptet kyçe, shoqëruar me pyetje-përgjigje të shpejta nga vendi, si dhe metrajtimin e një rasti studimor në funksion të konkretizimit të njohurive. Në kuadër të fazës së përfundimit, mësuesja kishte planifikuar zhvillimin e një kuici me 9 pyetje me alternativa, ku secili nxënës mori pjesë nëpërmjet platformës, pasuar nga një feedback i shpejtë i mësueses mbi përgjigjet e dhëna. Ora u përfundoi me caktimin e detyrave të shtëpisë, që do të dorëzoheshin nëpërmjet platformës. Duke shfaqur detyrën në monitor, mësuesja dha edhe udhëzimet e nevojshme për realizimin e saj. Pavarësisht sfidave të menaxhimit të klasës, të cilat janë gjithnjë të pranishme në një proces mësimor të mbështetur në teknologji digjitale, ora u finalizua me sukses dhe përdorimi i platformës ndikoi pozitivisht si në përcjelljen e njohurive, ashtu edhe në angazhimin e nxënësve.

### Pikat e forta të orës mësimore

- Përfshirja e të gjithë nxënësve në veprimtaritë e orës së mësimimit, si gjatë atyre të realizuara me ndihmën e platformës (nëpërmjet monitorit apo nëpërmjet pjesëmarrjes së nxënësve në aktivitetet në platformë), ashtu edhe në veprimtaritë tradicionale në formën e seancave të shkurtra të pyetje-përgjigjeve.
- Efekti motivues dhe argëtues që pati realizimi i kuicit nëpërmjet platformës.
- Shkathtësia e mësueses në kalimin nga veprimtaritë tradicionale në ato online dhe e anasjellta, pavarësisht numrit të lartë të veprimtarive mësimore dhe formave të aplikuar të vlerësimit

### Këshilla për replikimin e orës

- Reduktimi i mundshëm i numrit të veprimtarive të zhvilluara nëpërmjet platformës, për të evituar shpërqendrimin të nxënësve, sidomos nëse mësuesi është në hapat e parë të aplikimit të këtyre modaliteteve të reja të mësimdhënies dhe të të nxënësve.
- Menaxhimi sa më eficient i kohës gjatë orës së mësimimit, duke i udhëzuar nxënësit për ta realizuar paraprakisht veprimtarinë e parë, atë të ndjekjes së videos për rifreskimin e njohurive të fituara nga tema e mëparshme, në kushtet e shtëpisë, para ardhjes në orën e mësimimit: një përmbyse e tillë e aktiviteteve do të krijonte më shumë frymëmarrje gjatë orës së mësimimit dhe ritëm më të përshtatshëm të kalimit nga një veprimtari në tjetrën, të cilin jo çdo nxënës arrin ta ndjekë.



Mësuese:  
**Edlira Brahim**

Drejtimi:  
**Hoteleri-Turizëm**

Lënda:  
**Komunikimi efektiv në  
shërbimet hoteliere XII**

Tema/çështja:  
**Përdorimi i mesazheve të gjuhës  
së trupit**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënët:**

1. Evidenton përdorimin e gjuhës së trupit për transmetimin e mesazheve.
2. Projekton se si gjuha e trupit mund të thotë shumë për personalitetin dhe ndjenjat.
3. Analizon veprimet me gjuhën e trupit që ndikojnë pozitivisht dhe negativisht në imazhin e një profesionisti.

**Metoda e aplikuar:**

PNP (*Parashikim – Ndërtim njohurish – Përforcim*)



### Planifikimi i orës mësimore

Faza e orës së mëimit	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
Shpjegimi i fazave të punës	Fillimi i veprimtarisë parapërgatitore	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET; tabelë/ flipchart	2 min	Njohje e nxënësve me hapat e punës; pajisje me fletë me ngjyra dhe lapustila
Parashikimi	Pyetje-përgjigje	Tradicional	–	3 min	Pyetje të shpejta drejtuar nxënësve për përsëritjen e njohurive të mëparshme
Parashikimi	Kuic	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Monitor; kompjuter (mësuesi); kompjuter/laptopë (nxënësit); platforma digjitale MësoVET	5 min	Rifreskim i njohurive të mëparshme; dhënie udhëzimesh për realizimin e kuicit në platformë; feedback mbi përgjigjet
Ndërtimi i njohurive (Demonstrim)	Njohja me konceptet e reja	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	20 min	Prezantohen konceptet e reja, duke iu referuar edhe shembujve nga përditshmëria
Përforcimi (Praktikim)	Rast studimi (diskutim në forum)	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Monitor; kompjuter (mësuesi); kompjuter/laptopë (nxënësit); platforma digjitale MësoVET	12 min	Punë në grupe; dhënie udhëzimesh; dhënie feedback-u nga mësuesja
Caktim i detyrave të shtëpisë	Detyrë - miniprojekt	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës+ online (nga shtëpia)	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	3 min	Dhënie udhëzimesh për realizimin e detyrës dhe ngarkimin në në platformë

Ora e hapur e zhvilluar nga mësuese Edlira Brahimi u bazua në metodën Parashikim-Ndërtim njohurish-Përforsim, si një metodë e gjykuar e përshtatshme nga mësuesja për natyrën e temës së ditës dhe objektivat e vendosur. Ora nisi me shpjegimin e hapave të punës që nxënësit do të realizonin gjatë orës së mësim, me fokus të veçantë në vënien në praktikë të njohurive të reja. Nxënësit u pajisën që në fillim me mjetet e punës (fleta me ngjyra dhe lapustila), për t'i përdorur në veprimtaritë vijuese, si dhe u orientuan nga mësuesja mbi modalitetin e zhvillimit të orës së mësim, bazuar në përdorimin e platformës digjitale MësoVET në një pjesë të veprimtarive.

Me qëllim rifreskimit të njohurive të fituara më parë, mësuesja realizoi fillimisht një seancë të shkurtër pyetje-përgjigjesh në format tradicional. Ndonëse që gjatë kësaj veprimtarie ndërveprimi në klasë ishte i lartë, angazhimi i nxënësve u rrit edhe më shumë me zhvillimin e kuicit nëpërmjet platformës MësoVET, ku secili punoi në mënyrë individuale në pajisjen digjitale të disponuar. Realizimi i kuicit nëpërmjet platformës e bëri orën më të këndshme, nxiti motivimin e nxënësve në përpjekje të vazhdueshme për të gjetur përgjigjen e saktë, si dhe mundësoi evidentimin e menjëhershëm të progresit të tyre nga ana e mësueses.

Faza e ndërtimit të njohurive të reja u bazua në teknikën e demonstrimit, mjaft e përshtatshme për t'u aplikuar në modulet praktike, duke transferuar efektivisht të nxënësit konceptet e reja. Kjo fazë e orës së mësim u zhvillua me përdorimin e platformës MësoVET, duke shfaqur vazhdimisht përmbajtjen e saj në monitor. Ndjekja e platformës në monitor rezultoi efektive në përqendrimin e nxënësve dhe në mbajtjen gjallëtë interesit të tyre mbi njohuritë e reja. Me interes të veçantë ishte përdorimi i platformës për realizimin e fazës së përforsimit, bazuar në praktikimin e njohurive të fituara. Mësuesja kishte përzgjedhur rastin e studimit si qasjen më të përshtatshme për këtë fazë. Bazuar në punën në grupe, nxënësit u udhëzuan për të reflektuar mbi rastin e studimit dhe për të dhënë përgjigjet e tyre në platformë, nëpërmjet forumit të posaçëm për këtë aktivitet. Vetë lënda dhe tema e orës së mësim, e cila fokusohet në komunikimin efektiv nëpërmjet mesazheve të përcjella me anë të gjuhës së trupit, i kushton vëmendje të veçantë aftësive të buta që profesionistët e ardhshëm duhet të zhvillojnë.

### **Pikat e forta të orës mësimore**

- Përzgjedhja e duhur e veprimtarive për t'u zhvilluar online dhe atyre në mënyrë tradicionale, duke patur si synim aktivizimin dhe motivimin e vazhdueshëm të nxënësve.
- Përdorimi efikas i platformës përgjatë gjithë orës së mësim, herë nëpërmjet shfaqjes me anë të monitorit, herë me pjesëmarrjen aktive të nxënësve në veprimtaritë e pranishme në platformë.
- Ndërveprimi i lartë mësues-nxënës, si dhe angazhimi i lartë i nxënësve, veçanërisht gjatë veprimtarive të realizuara në platformë.

### **Këshilla për replikimin e orës**

- Fleksibilitet në mënyrën e përzgjedhjes së modalitetit të zhvillimit të veprimtarive, ku secili mësues të mund ta integrojë platformën sipas aftësive dhe shprehive të fituara, pa rrezikuar të krijojë konfuzion dhe situata të papritura gjatë orës së mësim.
- Marrje e masave paraprake nga mësuesi/-ja para orës së mësim (kontroll i aktiviteteve në platformë, sigurim i aksesit të të gjithë nxënësve) për të menaxhuar më së miri kohën gjatë orës, në kushtet e përdorimit intensiv të platformës dhe aktivizimit të shpeshtë të nxënësve në të.

Gjatë orës së mësim, mësuesja e nxiti konsolidimin e këtyre aftësive nëpërmjet praktikimit të nxënësve në lidhje me tematikën, duke evidentuar në pin board aftësitë kryesore. Në minutat e fundit të orës së mësim, mësuesja realizoi vlerësimet e nxënësve. Nxënësit më aktivë motivuan duke marrë medalje dhe pikë. Në fund të orës, mësuesja dha instruksione të qarta mbi realizimin e detyrave të shtëpisë, në formën e një miniprojekti, të cilin nxënësit do ta dorëzonin nëpërmjet platformës MësoVET.



**Shkolla  
Teknike  
Ekonomike  
Tiranë**

**Rastet e mira**

Shkolla Teknike Ekonomike, Tiranë

Mësuese:  
**Elsa Vuksanaj**

Drejtimi:  
**Ekonomi-biznes**

Lënda:  
**Llogari dhe kontabilitet XI**

Tema/çështja:  
**Kontabiliteti i shoqërive të personave/ Shtimi i kapitalit nëpërmjet pranimit të një ortaku të ri**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënit:**

1. Evidenton format e shtimit të kapitalit.
2. Shpjegon saktë hapat që ndiqen në pranimin e ortakut të ri në shoqëri.
3. Llogarit saktë shtimin e kapitalit pas pranimit të ortakut të ri.

**Metoda e aplikuar:**

ERR (*Evokim – Realizim i kuptimit – Reflektim*)



### Planifikimi i orës mësimore

Faza e orës së mësimit	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
Prezantimi i temës dhe i objektivave mësimore		Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	3 min	Njohje e nxënësve me temën e ditës dhe objektivat mësimore për të cilët do të punohet
Evokimi	Kuic	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	5 min	Shtirim i pyetjes dhe ngritje duarsh sipas dëshirës; nxitje e nxënësve për tu përgjigjur
Realizimi i kuptimit	Njohje me konceptet e reja (prezantim) + pyetje/ përgjigje të shpejta	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	20 min	Shfaqje e prezantimit në platformë, pjesë e materialit mësimor digjital; ndërthurje e shpjegimit të koncepteve me pyetje të herëpashershme
Reflektimi	Ushtrim	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës + tradicional	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET; tekst mësimor, fletore	15 min	Dhënie udhëzimesh për realizimin e ushtrimeve; kombinim mes transmetimit të njohurive dhe kryerjes së ushtrimeve
Caktim i detyrave të shtëpisë		Tradicional	Tekst mësimor, fletore	2 min	Dhënie udhëzimesh për realizimin e detyrës

Një orë me fokus vendosjen e nxënësve në qendër të procesit mësimorë dhe angazhimin e vazhdueshëm të nxënësve, është një orë që premtos sukses, sidomos nëse angazhimi ndodh jo vetëm në formë tradicionale, por edhe me integrimin e teknologjive digjitale. E tillë ishte ora e hapur e mësuese Elsa Vuksanaj. Duke u mbështetur në qasjen metodike ERR, mësuesja e nisi ndërveprimin me nxënësit duke iu komunikuar fillimisht temën e ditës dhe objektivat rreth të cilëve ndërtohej ora mësimore. U vijua më pas me evokimin, për të cilin mësuesja kishte përzgjedhur si mjet një kuic të krijuar në platformën MësoVET, bazuar në disa pyetje me pohime të vërteta e të gabuara. Mënyra e realizimit të kuicit u bë duke shfaqur pyetjet e tij në monitor, teksa nxënësit aktivizoheshin me gojë, në përpjekje për të dhënë përgjigjet e sakta. Një nxënës ishte caktuar paraprakisht nga mësuesja për të klikuar përgjigjet në platformë, si dhe për të vijuar me pas lundrimin në të gjatë prezantimit të pjesës tjetër të përmbajtjes digjitale dhe të veprimtarive që do të realizoheshin. Realizimi i kuicit u shoqërua me dhënien e feedback-ut nga ana e mësueses, me qëllim theksimin e njohurive që nevojiteshin të konsolidoheshin më tej nga nxënësit.

Pas përfundimit të evokimit të njohurive të mëparshme, ora u pasua nga faza e realizimit të kuptimit, e bazuar në ndjekjen në ekran të një prezantimi në Power Point, pjesë e materialit mësimor digjital të vendosur në platformë. Efekti i vizualizimit të prezantimit ishte imenjëhershëm te nxënësit, të cilët u përqëndruan më shumë dhe treguan interes të shtuar ndaj ndjekjes së tij. Në këtë mënyrë, nga njohuritë e evokuara më parë, u kalua hap pas hapi në informacionin e ri të temës së ditës. Edhe pse vijoi me shpjegimin e njohurive të reja, mësuesja nuk e neglizhoi aktivizimin e nxënësve, duke i mbajtur të mobilizuar dhe të përqëndruar me anë të pyetjeve të shpejta, shoqëruar me komente mbi përgjigjet e dhëna dhe qartësim nocionesh komplekse. Për të marrë sinjalet e duhura mbi shkallën e kuptueshmërisë së informacionit të ri të përcjellë nëpërmjet prezantimit, mësuesja e ndërthuri këtë fazë me ushtrime, njëri prej të cilëve u shfaq nëpërmjet platformës, ndërsa tjetri u konsultua nga nxënësit në tekstin mësimor.

Mes ushtrimeve, mësuesja vijoi të transmetojë njohuritë e reja, duke i ndërthurur me pyetje dhe duke marrë vazhdimisht konfirmimin e nxënësve mbi qartësinë e njohurive të reja dhe mbi ndjekjen e ritmit të veprimtarive. Informacioni i ri u bë më konkret për nxënësit edhe falë referimit në shembuj e situata të njohurapër ta, duke u plotësuar edhe me ndërhyrje dhe sugjerime nga ana e nxënësve. Klasa u menaxhua mjaft mirë nga mësuesja, edhe pse kalimi i shpeshtë dhe i shpejtë nga njëra veprimtari në tjetrën ishte jo pak sfidues. Në fund të orës së mësimin, mësuesja caktoi detyrat e shtëpisë, të cilat do të realizoheshin me shkrim, bazuar në një ushtrim në tekstin mësimor.

### **Pikat e forta të orës mësimore**

- Përdorimi i materialit digjital në platformë përgjatë gjithë orës së mësimin, në secilën fazë të saj.
- Menaxhimi i klasës dhe i kohës së zhvillimit të veprimtarive, pavarësisht modalitetit tërësisht tradicional të realizimit të tyre apo integrimin në to të teknologjive digjitale.
- Aktivizimi i lartë i nxënësve, në të gjitha fazat dhe veprimtaritë e orës mësimore, ndonëse pa marrë pjesë në mënyrë ndërvepruese në platformë.

### **Këshilla për replikimin e orës**

- Përdorimi i platformës jo vetëm për të prezantuar nëpërmjet monitorit materialin mësimor digjital, por edhe për të realizuar ndonjërin prej veprimtarive, duke ndërtuar në këtë mënyrë një orë mësimore më interaktive dhe tërheqëse për nxënësit.
- Realizimi i detyrës së shtëpisë nëpërmjet platformës MësoVET (zhvillim i drejtpërdrejtë në platformë ose ngarkim i file-it), për një dokumentim më efikas të produkteve dhe progresit të nxënësve, si dhe për të mundësuar edhe dhënien e feedback-ut online mbi detyrat.



Mësuese:  
**Violeta Hysenllari**

Drejtimi:  
**Ekonomi-biznes**

Lënda:  
**Llogari dhe kontabilitet**

Tema/çështja:  
**Regjistrimet kontabël në fushën e personelit / Ndalesat për tatime dhe sigurime shoqërore, llogaritja dhe dokumentimi i tyre**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënët:**

1. Evidenton qartë llojet e ndalesave nga shpërblimi bruto.
2. Shpjegon mënyrën e llogaritjes së ndalesave për tatime dhe sigurimet shoqërore
3. Llogarit në mënyrë të pavarur ndalesat për tatimet dhe sigurimet shoqërore.

**Metoda e aplikuar:**

ERR (Evokim – Realizim i kuptimit – Reflektim)

### Planifikimi i orës mësimore

Faza e orës së mëimit	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
Prezantimi i temës dhe i objektivave mësimorë		Tradicional	Tabela e bardhë	2 min	Njohje e nxënësve me temën e ditës dhe objektivat mësimore të synuar
Evokimi	Akullthyes (interpretim shprehjeje)	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	3 min	Shfaqje e shprehjes në platformë; interpretim nga nxënësit
Evokimi	Ushtrim (problemë me alternativa)	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	5 min	Propozim i përgjigjes së saktë nga nxënësit; plotësim duke shfaqur platformën në monitor
Realizimi i kuptimit	Njohje me konceptet e reja (prezantim) + pyetje/ përgjigje	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	20 min	Shfaqje e prezantimit në platformë, pjesë e materialit mësimor digjital; evidentim i koncepteve kyçe në tabelën e bardhë; ndërthurje e shpjegimit të koncepteve me pyetje të herëpashershme
Reflektimi	Kuic	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	5 min	Dhënie udhëzimesh për realizimin e ushtrimeve; caktim ushtrimesh sipas grupeve; zgjidhje e ushtrimeve në tabelë
Reflektimi	Ushtrim	Tradicional	Tabelë e bardhë; fletore	8 min	Dhënie udhëzimesh për realizimin e ushtrimeve; caktim ushtrimesh sipas grupeve; zgjidhje e ushtrimeve në tabelë
Caktim i detyrave të shtëpisë		Duke shfaqur përmbajtjen e platformës + online (nga shtëpia)	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	2 min	Dhënie udhëzimesh për realizimin e detyrës dhe ngarkimin në platformë



Ora mësimore e hapur e mësueses Violeta Hysenllari u karakterizua nga përdorimi i gjerë i platformës MësoVET për të lehtësuar procesin e përvetësimit të njohurive. Ora nisi me shpjegimin e objektivave që synohen të përmbushen gjatë saj, të cilët mësuesja i kishte shënuar paraprakisht në tabelën e bardhë. Në vazhdim, mësuesja zhvilloi një veprimtari hyrëse, në trajtë akullthyesi, duke shfaqur nëpërmjet platformës MësoVET një shprehje të njohur, e cila u interpretua nga nxënësit me gojë. Akullthyesi pati menjëherë efekt, pasi nxënësit u mobilizuan dhe u aktivizuan me dëshirë. Kjo veprimtari krijoi edhe një klimë më të këndshme në klasë dhe pruri më pranë mësuesen me nxënësit.

U kalua më pas në fazën e evokimit, nëpërmjet një probleme të vendosur në platformë, përmbajtja e së cilës u shfaq në monitor, teksa nxënësit përpiqeshin të evidentonin përgjigjen e saktë mes opsioneve të dhëna. Edhe pse ndërveprimi në platformë u realizua nga vetë mësuesi, pra pa aktivizimin e drejtpërdrejtë të nxënësve në platformë, veprimtaria ndikoi pozitivisht në krijimin e një efekti ndryshe nga një ushtrim i zhvilluar në fletore apo në tabelë. Ora mësimore vazhdoi me prezantimin e ngarkuar në platformë, i cili u shfaq në monitor për nxënësit. Përcjellja e njohurive nëpërmjet prezantimit në platformë dhe shtjellimeve të mësueses, u ndërthur mjaft mirë edhe me testimin e kuptueshmërisë së informacionit të ri, nëpërmjet ushtrimeve të tjera në trajtë kuici në platformë (kuic me alternativa dhe me plotësim të vendeve bosh), sërish duke e shfaqur përmbajtjen e tyre në monitor.

Të fokusuar te platforma në ekran, nxënësit u aktivizuan vazhdimisht duke dhënë përgjigjet me gojë dhe duke shtruar pyetje apo komente në rast paqartësie, ndërkohë që mësuesja ndërvepronte me platformën, bazuar në përgjigjet e sugjeruara nga nxënësit, si dhe rimerrte verbalisht nocionet që kishin nevojë të riartikuloeshin. Gjatë fazës së realizimit të kuptimit, krahas vizualizimit nëpërmjet platformës, mësuesja përdori edhe tabelën e bardhë për të evidentuar konceptet më kryesore dhe për të realizuar harta mendore në funksion të kuptueshmërisë së materialit mësimor.

Në vijim, mësuesja i ndau nxënësit në grupe dhe secilit prej tyre iu caktoi nga një ushtrim për ta zgjidhur në fletore. Për secilin grup, një nxënës zgjidhi ushtrimin në tabelën e bardhë, shoqëruar me plotësimet dhe feedback-un e mësueses. Drejt minutave të fundit të orës së mësimimit, mësuesja realizoi edhe një përmbledhje të njohurive kryesore të përçuara, duke aktivizuar edhe një pjesë të nxënësve. Në përfundim të orës, kreu disa vlerësime të përgjithshme, si dhe u caktoi nxënësve detyrën e shtëpisë, e cila do të ngarkohej në platformë.

### **Pikat e forta të orës mësimore**

- Ndërthurja e ushtrimeve dhe e shembujve gjatë fazës së realizimit të kuptimit, duke lehtësuar dhe konkretizuar procesin e përthithjes së informacionit të ri nga ana e nxënësve.
- Përdorimi i materialit digjital në platformë përgjatë gjithë orës së mësimimit, në secilën fazë të saj, ndonëse jo me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të nxënësve në veprimtaritë në platformë.
- Përdorimi i platformës për realizimin e detyrave të shtëpisë, si një vlerë e shtuar në procesin e monitorimit, dokumentimit dhe të dhënies online të vlerësimit nga ana e mësueses.

### **Këshilla për replikimin e orës**

- Përdorimi i platformës jo vetëm për të prezantuar nëpërmjet monitorit materialin mësimor digjital, por edhe për të realizuar ndonjërin prej veprimtarive, duke ndërtuar në këtë mënyrë një orë mësimore edhe më interaktive dhe tërheqëse për nxënësit.
- Nxitja e mëtejshme e përdorimit të platformës nga shtëpia, në pamundësi për ta përdorur atë drejtpërdrejt nga nxënësit në klasë, duke spostuar, për shembull, komentën mbi shprehjen e njohur si një forum diskutimi për t'u realizuar nga nxënësit nga pajisjet personale digjitale pas orës së mësimimit.

Mësuese:  
**Xhensila Peshkëpia**

Drejtimi:  
**Tekstil-konfeksion**

Lënda:  
**Bazat e prerjes XI**

Tema:  
**Fundi i thjeshtë**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënit:**

1. Evidenton masat bazë për ndërtimin e fundit.
2. Shpjegon saktë hapat që ndiqen për ndërtimin e fundit të thjeshtë (shpinë, përparëse, qemer).
3. Llogarit saktë masat për ndërtimin e fundit në masën industriale 38 dhe ndërton fundin e thjeshtë në këtë masë.

**Metoda e aplikuar:**

ERR (Evokim – Realizim i kuptimit – Reflektim)



### Planifikimi i orës mësimore

Faza e orës së mëimit	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
Prezantimi i temës dhe i objektivave mësimorë		Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	2 min	Njohje e nxënësve me temën e ditës dhe objektivat mësimorë të synuar
Evokimi	Pyetje-përgjigje të shpejta	Tradicional	–	3 min	Set pyetje-përgjigjesh për të aktivizuar njohuritë ekzistuese
Realizimi i kuptimit	Njohje me konceptet e reja (prezantim) + pyetje/ përgjigje	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	12 min	Shfaqje e prezantimit në platformë; evidentim i koncepteve kyçe; interpretim skicash; ndërveprim me nxënësit me anë të pyetje-përgjigjeve
Realizimi i kuptimit	Demonstrim	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës + tradicional	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET; tabela e bardhë	8 min	Shfaqje dhe interpretim i skicave në platformë; demonstrim i ushtrim praktik për t'u realizuar nga nxënësit; dhënie udhëzimesh
Reflektimi	Ushtrim praktik	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës + tradicional	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET; tabelë e bardhë ; pasqyra ndihmëse me specifikime; fletë të bardha të mëdha; vizore	20 min	Punë praktike individuale; dhënie udhëzimesh të vazhdueshme; feedback gjatë dhe në fund të procesit

Përdorimi i platformave digjitale është i dobishëm edhe në orë ku në qendër të të nxënës është vënia në praktikë e njohurive të fituara në një fushë si ajo e tekstil-konfeksionit. Për të orientuar nxënësit gjatë zhvillimit të veprimtarive të planifikuara, ora e hapur e mësueses Xhensila Peshkëpia nisi me njohjen e nxënësve me objektivat sipas temës së ditës, duke përdorur menjëherë platformën digjitale MësoVET për shfaqjen e tyre.

Në vijim, u kalua në fazën e evokimit të njohurive, e cila u mbështet në një set pyetjesh të përgatitura nga mësuesja, të ndërthurura edhe me pyetje që lindin në varësi të përgjigjeve dhe komenteve të nxënësve, si dhe të konstatimeve të mësueses mbi nevojën për të rifreskuar dhe ritheksuar disa koncepte kryesore. Ndonëse jo të shumtë në numër, nxënësit i dhanë gjallëri klasës dhe orës së mësimi falë aktivizimit të vazhdueshëm për t'iu përgjigjur pyetjeve, si dhe nëpërmjet plotësimeve ndaj përgjigjeve të njëri-tjetrit. Më tej, ora u përqendrua në fazën e realizimit të kuptimit, për të cilën sërish u përdor platforma MësoVET. Mësuesja realizoi një prezantim të përmbledhur nëpërmjet shfaqjes në monitor të materialit digjital të përgatitur mbi informacionin e ri, i cili përmbante edhe udhëzime mbi aspekte praktike dhe skema orientuese për nxënësit. Konkretizimi i hapave të punës nëpërmjet imazheve të ndryshme ndikoi pozitivisht edhe në lehtësimin e punës praktike që vetë nxënësit do të realizonin në vijim.

Përcjellja e njohurive u plotësua me demonstrimin e realizuar nga mësuesja, si pikë referimi për ushtrimin praktik që do të pasonte. Mësuesja iu referua gjatë gjithë kohës materialit në platformë, si dhe realizoi skica të shpejta shpjeguese në tabelën e bardhë. Në fazën e reflektimit, nxënësit nisën të punojnë në praktikë, duke realizuar ushtrimin e planifikuar përprerjen e një fundi të thjeshtë, sipas instruksioneve të vazhdueshme dhe ndihmës nga afër që mësuesja ofronte.

Teksa nxënësit punonin individualisht, mësuesja u tërhoqte vëmendjen për të rifreskuar edhe udhëzimet, duke shqyrtuar përmbajtjen e materialit në platformë, të shfaqur në ekran. Hap pas hapi, me ndihmën e mësueses dhe të skicave të vendosura në platformë, nxënësit realizuan me sukses punën praktike që iu ishte caktuar, duke përmbushur kështu objektivat e orës mësimore.

Gjatë gjithë veprimtarisë praktike, mësuesja dha feedback mbi realizimin e punës, rendin e proceseve, mënyrën e përdorimit të mjeteve, si dhëndihmoi nxënësit që hasën njëfarë vështirësie në realizimin e ushtrimit. Në fund të orës mësimore, u dhanë edhe vlerësimet përkatëse mbi aftësitë e demonstruara nga nxënësit.

### **Pikat e forta të orës mësimore**

- Shfrytëzimi optimal i orës së mësimi për konkretizuar njohuritë e fituara, falë demonstrimit dhe realizimit të ushtrimeve praktike me mjetet e përdorura të punës.
- Përdorimi i materialit digjital në platformë përgjatë gjithë orës së mësimi, në secilën fazë të saj, duke lehtësuar dhe orientuar më mirë nxënësit edhe në procesin e realizimit të punëve praktike.
- Facilitimi i veprimtarive praktike nga ana e mësueses, nëpërmjet udhëzimeve të vazhdueshme, asistimit të nxënësve sipas nevojës dhe demonstrimit të proceseve të punës, si dhe dhënia e feedback-ut të vazhdueshëm mbi punën individuale, duke theksuar pikat e forta dhe aspektet që kanë nevojë për përmirësim.

### **Këshilla për replikimin e orës**

- Përdorimi i platformës jo vetëm për të prezantuar materialin mësimor nëpërmjet monitorit, por edhe për të angazhuar nxënësit në zhvillimin e drejtpërdrejtë të veprimtarive në të, si një vlerë e shtuar në ndërtimin e një ore interaktive dhe motivuese.
- Shtrirje e përdorimit të platformës përtej orës mësimore, për të nxitur ndërveprimin e drejtpërdrejtë nxënës-platformë në kushtet e disponimit/mundësisë së përdorimit nga shtëpia të një pajisjeje digjitale.

Mësuese:  
**Alketa Avari**

Drejtimi:  
**Ekonomi-biznes**

Lënda:  
**Qytetari X**

Tema/çështja:  
**Veprimtari praktike 6-7 / Sinjalistika rrugore dhe sjellja në rrugë, pasojat e moszbatimit të rregullave të qarkullimit rrugor**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënit:**

1. Identifikon sinjalet rrugore.
2. Shpjegon qartë normat e sjelljes së drejtuesve të mjeteve në kryqëzim.
3. Argumenton rëndësinë e sinjaleve.

**Metoda e aplikuar:**

PNP (*Parashikim – Ndërtim njohurish – Përforcim*)



### Planifikimi i orës mësimore

Faza e orës së mëimit	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
Parashikimi	Parashikim me terma paraprakë (diskutim)	Tradicional	–	8 min	Diskutim mbi njohuritë e mëparshme, duke evidentuar ato më kryesore
Prezantimi i temës dhe i rezultateve të të nxënit		Tradicional	–	2 min	Njohja e nxënësve me temën mësimore dhe me rezultatet e të nxënit që kërkohen të përmbushen
Ndërtimi i njohurive	Konkurs	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET; fleta të bardha	20 min	Pjesa I: Ndarje e nxënësve në 3 grupe sipas roleve: grupi që jep përgjigjet, grupi që vlerëson dhe grupi që mbikqyr; ndërveprim mes grupeve; dhënie feedback-u nga mësuesja. Pjesa II: Ndarje e nxënësve në grupe sipas kategorive të sinjalistikës rrugore; vizatim i simboleve në fleta të bardha; shkëmbim fletash mes grupesh për identifikim simbolesh; shpallje e grupit fitues
Prezantimi i detyrave të shtëpisë		Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	5 min	Prezantim i fletëpalosjeve të realizuara nga nxënësit; dhënie vlerësimi mbi punimet e nxënësve
Përforcimi	Diskutim	Tradicional	–	10 min	Diskutim i lirë mbi njohuritë e fituara; rimarrje e koncepteve kyçe; hapësirë për komente dhe ide nga nxënësit mbi njohuritë e fituara



Në lëndë dhe tematika të caktuara, konkretizimi përmes imazheve është kyç në përcjelljen efikase të njohurive dhe në qëndrueshmërinë e tyre. Me fokus në sinjalistikën rrugore, mësuese Alketa Avari iu ofroi nxënësve të saj një orë mësimore të mbështetur në informacion lehtësisht të perceptueshëm falë vizualizimit nëpërmjet platformës digjitale MësoVET. E konceptuar mbi bazën e metodës PNP, ora e mësueses Alketa Avari nisi me fazën e parashikimit, gjatë së cilës mësuesja iu drejtoi disa pyetje të strukturuar nxënësve, duke i ftuar të diskutonin dhe të argumentonin mbi përgjigjet e tyre.

Në qendër të kësaj faze ishte evidentimi i koncepteve kyçe, të cilat shërbyen edhe për lidhjen e njohurive me situata nga jeta e përditshme. Ora vijoi me prezantimin e rezultateve të të nxënësve, të synuara për t'u përmbushur gjatë orës mësimore. Qartësimi i rezultateve të të nxënësve ndikoi pozitivisht te nxënësit për të formësuar pritshmëritë e tyre dhe për t'i parapërgatitur për veprimtaritë pasuese.

Më tej, mësuesja i njohu nxënësit me veprimtarinë e radhës, e cila do të organizohej në formën e një konkursi, të ndihmuar edhe nga një material i vendosur në platformë. Nxënësit u ndanë në tri grupe, ku secili luante një rol të caktuar. Në këtë mënyrë, u konfiguruan: grupi që do të jepte përgjigje mbi pyetjet e shtruara, grupi që do të merrej me vlerësimin e përgjigjeve, si dhe grupi që do të mbikqyrte dhe komentonte punën e dy grupeve të para. Një një veprimtari të tillë në ekip, nxënësit bashkëpunuan kënaqshëm, të motivuar për të performuar sa më mirë. Teksa secili grup vijonte aktivizimin në rolet përkatëse, mësuesja ndërhynte dhe strukturonte përgjigjet dhe komentet sipas nevojës.

Konkursi vijoi me një fazë të dytë, ku secili prej tri grupeve u identifikua me një kategori të simboleve të sinjalistikës rrugore. Pas dhënies së udhëzimeve përkatëse nga mësuesja, grupet nisën të vizatonin simbolet e kategorisë përkatëse në fletë të bardha të mëdha, të cilat më pas do t'i pasoheshin grupit tjetër që do të shpjegonte kuptimin e secilit simbol. Nëpërmjet aplikimit të një sistemi pikëzimi, u shpall edhe grupi fitues i konkursit, ndërkohë që për secilin grup pati evidentim të pikave të forta dhe të dobëta, duke nxjerrë në pah paqartësitë dhe mangësitë në njohuritë e fituara.


Ora u pasua nga një tjetër veprimtari angazhuese, ku nxënësit u ftuan të prezantonin detyrat e shtëpisë nëpërmjet platformës digjitale MësoVET. Detyra e dhënë në orën emëparshme lidhej me përgatitjen në kompjuter të një fletëpalosjeje sensibilizuese mbi rëndësinë e njohjes së sinjalistikës rrugore dhe zbatimit të rregullave të qarkullimit. Pas prezantimit dhe dhënies së feedback-ut si nga mësuesja edhe nga nxënësit, u shpall edhe detyra më e mirë, bazuar po ashtu në një sistem të grumbullimit të pikëve. Ora u përmbyll me rimarrjen e pikave kyçe të trajtuara gjatë orës së mësimin, duke vënë theksin në vlerën praktike të këtyre njohurive. Nxënësit patën mundësi të komentonin dhe të shprehnin lirshëm idetë dhe qëndrimet e tyre në lidhje me këto njohuri.

### **Pikat e forta të orës mësimore**

- Integrimi i platformës MësoVET në orën mësimore, përpos mungesës së materialeve mësimore digjitale në këtë lëndë.
- Realizimi i një konkursi gjatë orës së mësimin, i cili rezultoi në motivimin e nxënësve dhe në rritjen e angazhimit të tyre gjatë orës së mësimin.
- Aktivizimi i lartë i nxënësve, përgjatë të gjitha veprimtarive të zhvilluara gjatë orës mësimore.

### **Këshilla për replikimin e orës**

- Përdorimi i platformës jo vetëm duke shfaqur materialin mësimor digjital në monitor, por edhe duke parashikuar ndërveprimin e nxënësve me platformën në një apo disa veprimtari, si p.sh. krijimi paraprak i një forumi ku nxënësit të mund të vlerësonin online në klasë detyrat e prezantuara, apo i një sondazhi (Choice) ku nxënësit të mund të votonin për detyrën e preferuar.
- Vëmendje e veçantë në menaxhimin e klasës për shkak të shpërndarimit të mundshëm nga larmia e aktiviteteve.



**SHKOLLA E MESME  
PROFESIONALE  
ALI MYFTIU**

**Rastet e mira**

Shkolla "Ali Myftiu", Elbasan

Mësuese:  
**Alketa Kanani**

Drejtimi:  
**Elektroteknikë**

Lënda:  
**Matematikë XII**

Tema/çështja:  
**Gjeometria në plane /  
Syprina e trekëndëshit**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënit:**

1. Njehson syprinën e trekëndëshit duke përdor formulën.
2. Përcakton elementë të trekëndëshit me ndihmën e syprinës.
3. Zgjidh situata problemore duke përdorur formulën e syprinës së trekëndëshit.

**Metoda e aplikuar:**

PNP (*Parashikim – Ndërtim njohurish – Përforcim*)



### Planifikimi i orës mësimore

Faza e orës së mëimit	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
Prezantim i temës dhe i objektivave mësimorë		Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Video-projektor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	2 min	Nxënësve u prezantohet tema dhe objektivat mësimorë që synohen të arrihen
Parashikimi	Pyetje nga vendi	Tradicional	–	3 min	Pyetje të shpejta për aktivizimin e njohurive ekzistuese
Ndërtimi i njohurive	Njohje me konceptet e reja + pyetje/ përgjigje të shpejta	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës + tradicional	Video-projektor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET; tabelë e bardhë	15 min	Përdorimi i materialit mësimor digjital për të shpjeguar konceptet e reja dhe i tabelës së bardhë për të zbrëthyer formulat dhe figurat
Ndërtimi i njohurive	Video	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Video-projektor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	5 min	Nxënësit ftohen të shohin në video-projektor videon dhe bëhen me dije se informacioni në video do të ndihmojë në zgjidhjen e ushtrimeve
Përforcimi	Ushtrime	Tradicional + online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Video-projektor; kompjuter (mësuesi); aparate celulare (nxënësit); aplikacioni- kamera M; tabelë e bardhë; fletore	15 min	Ushtrimet ndodhen në librin në format pdf të ngarkuar në platformë. Disa nxënës zgjidhin ushtrimet në fletore, disa të tjerë ftohen të përdorin aplikacionin. Krahasohen rezultatet. Disa nxënës shkruajnë zgjidhjen në tabelën e bardhë
Prezantimi i detyrave të shtëpisë		Online (nga shtëpia)	Video-projektor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	5 min	Dhënie udhëzimesh për realizimin e detyrës dhe ngarkimin në platformë

## Realizimi i orës mësimore

Nga eksperiencia e saj disavjeçare, mësuese Alketa kishte kuptuar se disa nxënës ndjenin vështirësi me metodat tradicionale të zgjidhjes së problemeve me laps dhe letër, gjë që çonte në largim interesi dhe motivim më të ulët. Për të adresuar këtë sfidë, mësuese Alketa ka vendosur të përfshijë përdorimin e platformës MësoVET dhe aplikacioneve të ndryshme për zgjidhjen e problemeve në metodën e saj mësimore.

Ora mësimore nisi me udhëzime dhe orientimin e nxënësve në përmbajtjen digjitale në platformën MësoVET. Klasa ishte e pajisur me kompjuter dhe video-projektor, të cilat ndihmuan në shfaqjen e materialit mësimor digjital në klasë, si dhe nxënësit u ftuan të aksesonin platformën edhe nga aparati i tyre celular. Të pasqyruara në video-projektor, mësuesja riformuloi objektivat e dhëna sipas kuptueshmërisë së nxënësve. Gjithashtu, drejtoi disa pyetje për të rifreskuar njohuritë. Për ndërtimin e njohurive të reja, mësuesja mësuesja prezantoi informacionin e ardhur në formë digjitale në platformën MësoVET. Paralelisht, përdori tabelën e bardhë dhe lapustila me ngjyra për të vizatuar dhe identifikuar elementë të ndryshëm.

Më pas, mësuesja shfaq një video të cilën e ka ngarkuar edhe në platformë. Këtë video ajo e përdor për të përcjellë njohuritë e reja mbi syprinën e trekëndëshit. Evidentohet që nxënësit duhet të jenë të vëmendshëm, pasi informacioni i sjellë do të përdoret prej tyre në veprimtarinë e radhës. Përdorimi i multimedias në shpjegimin e një koncepti të ri tërhoqi vëmendjen e të gjithë nxënësve. Për të përforcuar përthithjen e njohurive të reja në varësi të tipologjisë së nxënësit, mësuesja fton nxënësit të zgjidhin ushtrimet në klasë në formën e dëshiruar – në fletore ose online nëpërmjet një aplikacioni.

Personalizimi i të nxënësve motivoi nxënësit dhe i vendosi të gjithë në pozita pune. Në fund, u bë krahasimi i rezultateve të dala duke përdorur formën tradicionale të zgjidhjes së problemit me atë online. Disa prej nxënësve dolën me dëshirë të shkruajnë zgjidhjen në tabelën e bardhë. Duke përfshirë përmbajtjen digjitale në platformën MësoVET dhe aplikacionet për zgjidhjen e problemeve, mësuese Alketa transformoi me sukses orën e matematikës në një mjedis mësimor gjithëpërfshirës dhe bashkëpunues. Duke shfrytëzuar teknologjinë, ajo u ofroi nxënësve fleksibilitet në aksesueshmërinë e materialeve të lëndës, duke promovuar të nxënësve në orën, vendin dhe ritmin e dëshiruar, mundësi interaktive për zgjidhjen e problemeve dhe rezultate të menjëhershme. Kjo rezultoi në rritjen e angazhimit nga ana e nxënësve, në përmirësimin e aftësive të zgjidhjes së problemeve dhe në krijimin e një fryme pozitive në klasë.

### Pikat e forta të orës mësimore

- Përdorimi i aplikacioneve dhe shfaqja e videos ishte një nga pikat më të forta të orës së mësimin, ku mësuesi e përdori për të mbërthyer vëmendjen e nxënësve.
- Integrimi i platformës MësoVET dhe aplikacioneve për zgjidhjen e problemeve rriti në mënyrë domethënëse angazhimin e nxënësve në orën e matematikës. Nxënësit vlerësuan fleksibilitetin e qasjes në materialet e kursit online dhe natyrën interaktive të aplikacioneve për zgjidhjen e problemeve.
- Rezultatet e menjëhershme të ofruara nga aplikacionet për zgjidhjen e problemeve, së bashku me udhëzimet e mësueses ndihmuan nxënësit të zhvillojnë aftësitë e tyre për zgjidhjen e problemeve. Vizualizimet në aplikacion dhe paralelisht zgjidhjet hap pas hapi në tabelën e bardhë nga vetë nxënësit përmirësuan kuptimin e tyre mbi konceptet matematikore dhe përmirësuan aftësinë e tyre për të zgjidhur probleme të ndërlikuara.

### Këshilla për replikimin e orës

- Sigurohuni që të planifikoni kohën e replikimit të veprimtarive përpara se të filloni mësimin. Identifikoni aktivitetet që do të trajtoni dhe përcaktoni kohën e nevojshme për secilën prej tyre, duke marrë në konsideratë aftësitë digjitale të nxënësve dhe tuajat.
- Nëse dëshironi të replikoni këtë orë, ku një pjesë e mirë bazohet në materialin digjital ekzistues në platformë, këshillohet të rishikoni përmbajtjen për t'u siguruar që trajtohen të gjithë elementët dhe për ta përditësuar atë në rast nevojë me video, shembuj praktikë, kuice, ushtrime, etj.
- Krijoni një ambient mbështetës, bashkëpunues dhe pozitiv gjatë replikimit të orës. Inkurajoni pjesëmarrjen aktive të nxënësve, ofroni shpjegime shtesë dhe mbështetje gjatë përdorimit të teknologjisë kur është e nevojshme dhe jepni vlerësim pozitiv për përpjekjet e nxënësve.

Mësuese:  
**Anila Hoxha**

Drejtimi:  
**Shërbime Mjetesh Transporti**

Lënda:  
**Matematikë XI**

Tema/çështja:  
**Bashkësitë Numerike**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënit:**

1. Gjen numrin e elementeve të një bashkësie.
2. Përcakton prerjen dhe bashkimin e bashkësive me anë të diagramit të Venit.
3. Evidenton elemente të ndryshme të bashkësive numerike  $N, Z, Q, R, I$ .
4. Përcakton elementet e prodhimit kartezian kur jepen bashkësitë dhe anasjelltas.

**Metoda e aplikuar:**

PNP (*Parashikim – Ndërtim njohurish – Përforcim*)



### Planifikimi i orës mësimore

Faza e orës së mëimit	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
Prezantim i temës dhe i rezultateve të të nxënit		Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor, kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	2 min	Nxënësve u prezantohet tema dhe rezultatet e të nxënit që synohen të arrihen
Parashikimi	Kërkim online dhe përgjigje në forum	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (nxënësit); platforma digjitale MësoVET Monitor/video-projektor	15 min	Shfaqje e përmbajtjes së platformës në monitor; nxitje e nxënësve për të postuar përgjigjet në platformë; diskutim duke parë përgjigjet ne projektor
Ndërtimi i njohurive	Njohje me konceptet e reja + pyetje/ përgjigje të shpejta	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës (prezantimi)	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	15 min	Prezantohen konceptet e reja, duke iu referuar prezantimit ne platformë
Përforcimi	Kuic	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Monitor; kompjuter (mësuesi); aparate celulare (nxënësit) platforma digjitale MësoVET	8 min	Dhënie e udhëzimeve mbi kuicin; dhënie e feedback-ut të shpejtë nga mësuesi pas përfundimit
Prezantimi i detyrave të shtëpisë	Ushtrim	Online (nga shtëpia)	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	5 min	Dhënie udhëzimesh për realizimin e detyrës



## Realizimi i orës mësimore

Të mbash nxënësit aktivë gjatë orës së matematikës është një ndër sfidat kryesore me të cilën mësuesit e kësaj lënde ndeshen. Kjo lëndë perceptohet si e vështirë nga ana e nxënësve dhe besimi i tyre në aftësinë për të nxënë është i ulët. Si rrjedhojë, edhe angazhimi është i kufizuar. Një orë tradicionale, ku të gjitha veprimtaritë drejtohen nga mësuesi dhe nxënësi qëndron pasiv, nuk krijon hapësirë për ta bërë lëndën e matematikës tërheqëse dhe nuk arrin të nxitë imagjinatën e tyre.

Për këtë arsye, për të trajtuar temën 'Bashkësitë', mësuese Anila ishte munduar të integrojë elemente të ndryshëm angazhues dhe ndërveprues për t'i pozicionuar nxënësit e saj në zemër të procesit mësimor. Në këtë orë mësuesja kishte përzgjedhur të aplikojë modelin e mëimit të kombinuar me rotacion sipas stacioneve, duke planifikuar orën në formë të tillë që nxënësit të zhvendoseshin të gjithë së bashku nga një veprimtari (stacion) në tjetrën, duke alternuar modalitetin ballë për ballë me atë online.

Ora mësimore nisi me prezantimin e temës dhe rezultateve të të nxënësve me ndihmën e një prezantimi PowerPoint të ngarkuar në platformën MësoVET, i cili shfaqej në monitor. Më pas mësuesja vijoi me dhënien e udhëzimeve për veprimtarinë e radhës, e cila konsistoi në realizimin e një hulumtimi simultan online mbi konceptet e reja. Në këtë stacion të dytë, mësuesja i prezantoi nxënësit me konceptet kyçe të temës së re dhe i ftoi ata të kërkonin dhe të përzgjidhnin online nga një përkufizim për secilin koncept dhe t'i postonin ato në forum. Pas angazhimit të nxënësve online, u kalua në realizimin e një diskutimi ballë për ballë mes mësueses dhe nxënësve, si pjesë e procesit të konsolidimit të njohurive të reja. Të vendosur në qendër të veprimtarisë, nxënësit prezantuan përmbledhtazi produktin e punës kërkimore – përkufizimet e gjetura mbi konceptet thelbësore – dhe diskutuan me njëri-tjetrin, duke plotësuar përgjigjet. Mësuesja përdori materialin digjital të disponueshëm në platformë për të plotësuar dhe saktësuar përkufizimet e nxënësve, si dhe për të bërë lidhjen me aplikimin e tyre me drejtimin e tyre profesional.

Në stacionin e fundit të orës së mëimit, mësuesja përdori një test online për matjen e nivelit të përthithjes së njohurive të reja. Testi, ishte i përbërë nga pyetje me alternativa. Të gjithë nxënësit morën pjesë njëkohësisht në test nëpërmjet platformës. Mësuesja njoftoi nxënësit se ata do të njiheshin me rezultatet online dhe dha një feedback të shpejtë pas përfundimit të kuicit nga të gjithë nxënësit.

### Pikat e forta të orës mësimore

- Modeli i rotacionit sipas stacioneve i aplikuar në klasë ndihmoi në menaxhimin e mirë të kohës dhe rriti efikasitetin e orës së mëimit, duke mundësuar zhvillimin e veprimtarive të larmishme.
- Kombinimi i veprimtarive tradicionale ballë-për-ballë me ato online kontribuoi në zhvillimin e aftësive digjitale të nxënësve dhe i shtyu ata drejt punës kërkimore në kuadër të ndërtimit të njohurive. Nxitja e përdorimit të platformave të ndryshme digjitale dhe burimeve të ndryshme të informacionit ishte pozitive në këtë aspekt.
- Aplikimi i diskutimeve online dhe atyre ballë-për-ballë për të angazhuar nxënësit e bënë orën shumë interaktive. Për më tepër, nxënësit u inkurajuan për të bërë pyetje, shprehur mendimin e tyre dhe replikuar.

### Këshilla për replikimin e orës

- Për të garantuar efikasitetin e aplikimit të mëimit të kombinuar, kur bazohet në ndërthurje të metodave dhe veprimtarive, nevojitet një planifikim i kujdesshëm dhe i detajuar i veprimtarive mësimore, duke gjykuar se cili modalitet do të ishte më i përshtatshëm për secilën veprimtari.
- Dizenjimi për herë të parë i orës me anë të rotacionit sipas stacioneve kërkon kohë dhe angazhim të konsiderueshëm në planifikimin e veprimtarive dhe në hartimin e materialeve mbështetëse. Procesi lehtësohet nëse puna nis me një numër më të reduktuar veprimtarish, për t'u dhënë mundësi nxënësve dhe mësuesve të përshtaten gradualisht me këtë qasje të re.
- Aplikimi i mëimit të kombinuar me rotacion sipas stacioneve kërkon informim paraprak të nxënësve për t'u familjarizuar me një mënyrë të re të ndërtimit të orës së mëimit dhe të menaxhimit të kohës.

Mësues:  
**Viron Greco**

Drejtimi:  
**Mekanikë**

Lënda:  
**Mekanika e zbatuar X**

Tema/çështja:  
**Forca motore, forca rezistente,  
elementet e forcës dhe paraqitja  
grafike e tyre**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënit:**

1. Përkufizon forcën motore & forcën rezistente.
2. Liston elementët e forcës.
3. Paraqet grafikisht elementët e forcës.

**Metoda e aplikuar:**

PNP (*Parashikim – Ndërtim njohurish – Përforcim*)



### Planifikimi i orës mësimore

Faza e orës së mëimit	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
Prezantim i temës dhe i objektivave mësimorë		Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Video-projektor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	2 min	Nxënësve u prezantohet tema dhe objektivat mësimorë që synohen të arrihen
Parashikimi	Akyllthyes: Forum	Online, me ndërveprimin e nxënësve	Video-projektor; kompjuter (nxënës dhe mësues); platforma digjitale MësoVET	10 min	Nxitje e nxënësve për të postuar përgjigjet në platformë; shfaqje e përmbajtjes së forumit në video-projektor; diskutim mbi përgjigjet e dhëna
Ndërtimi i njohurive	Njohje me konceptet e reja + pyetje/ përgjigje të shpejta	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës (prezantimi)	Video-projektor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET; tabelë e bardhë	15 min	Prezantohen konceptet e reja, duke iu referuar edhe shembujve nga përditshmëria
Përforcimi	Ushtrime	Tradicional	Fletore dhe tabelë e bardhë	10 min	Disa nxënës shkruajnë zgjidhjen e ushtrimeve në tabelën e bardhë
Përforcimi	Kuic (3 pyetje me alternativa)	Online, me ndërveprimin e nxënësve	Video-projektor; kompjuter (mësuesi); aparate celulare (nxënësit) platforma digjitale MësoVET	5 min	Dhënie e udhëzimeve mbi kuicin; feedback automatik
Prezantimi i detyrave të shtëpisë	Ushtrim	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës + tradicional	Video-projektor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	3 min	Dhënie udhëzimesh për realizimin e detyrës

Përdorimi i platformave dhe instrumenteve të larmishme digjitale për mësimdhënie kërkon aftësi digjitale të mira, që jo të gjithë mësimdhënësit mund t'i zotërojnë. Kjo për arsye të ndryshme, si: mosha, mungesa e kapacitimit në institucione, etj. Gjithsesi, të mësuesit nuk mungon dëshira për të përqafuar sadopak përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie, fillimisht duke përdorur funksionalitete bazike dhe gradualisht duke kaluar në ato më komplekse, me rritjen e vetëbesimit dhe aftësive digjitale.

Një rast i mirë është ai i mësues Viron Grecos, i cili, në varësi të disponueshmërisë së materialeve mësimore digjitale, ka filluar të integrojë në mësimdhënie platformën MësoVET. Kur planifikon të realizojë një orë jo tradicionale, mësuesi lajmëron nxënësit paraprakisht që ora e ardhshme nuk do të zhvillohet në klasë, por në laboratorin e TIK. Sipas udhëzimeve të mësuesit, nxënësit ishin sistemuar në vendin e tyre të punës, të pajisur me një kompjuter personal dhe kishin aksesuar kursin 'Mekanika e zbatuar' në platformë. Për të nxitur pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve e për t'i motivuar ata, si veprimtari të parë mësuesi kishte parashikuar angazhimin e tyre online në një forum. Përgjigjet e tyre u postuan në kohë reale dhe u projektuan në klasë nëpërmjet video-projektorit.

Gjithsesi, në rast të problemeve teknike, mësuese kishte planifikuar Skenarin B – veprimtaria të realizohej ballë-për-ballë. Mësuesi lexoi disa prej përgjigjeve të nxënësve dhe vazhdoi diskutimin me to, duke orientuar bisedën drejt koncepteve të reja kyçe. Kalimi nga modaliteti online në atë ballë-për-ballë, si dhe nga njëra veprimtari në tjetrën, erdhi natyrshëm. Njohja e nxënësve me informacionin e ri u realizua duke përdorur materialin mësimor të ardhur në formë digjitale në platformë, i cili projektohej në monitor përgjatë gjithë kohës që mësuesi shpjegonte.

Hera-herës, për të thelluar njohuritë, mësuesi përdori tabelën e bardhë, ku ndërtoi dhe njëherë disa prej skicave dhe figurave të disponueshme online. Gjatë fazës së ndërtimit të njohurive të reja, nuk mungoi angazhimi i nxënësve nëpërmjet pyetjeve të drejtpërdrejta. Për të vlerësuar njohuritë e marra, mësuesi alternoi ushtrimet në klasë me një kuic të shpejtë online me 5 pyetje të mbyllura. Fakti që nxënësit kishin akses në materialin e shkruar dhe skicat online i ndihmoi ata në zgjidhjen e ushtrimeve. Disa prej nxënësve dolën në dërrasën e bardhë për të ndarë zgjidhjen e problemeve me pjesën tjetër të klasës. Përdorimi i lapustilave me ngjyra bëri të mundur identifikimin e elementëve të rëndësishëm në figura.

Pasi të gjithë u njohën me zgjidhjen e saktë të ushtrimeve, nxënësit u transferuar në modalitetin online për realizuar kuicin e disponueshëm në çështjen e ditës në platformën MësoVET. Në fund, mësuesi shpjegoi detyrën e shtëpisë, e cila është ngarkuar në platformë. Gjithsesi nxënësit do ta zgjidhnin atë në fletore dhe do ta diskutonin orën e ardhshme në klasë.

### **Pikat e forta të orës mësimore**

- Edhe pse mungonin aftësitë e nevojshme për të krijuar dhe menaxhuar një klasë të tijen virtuale në platformën MësoVET, mësuesi arriti të përdor materialin digjital ekzistues në avantazhin e tij, duke e projektuar atë në monitor gjatë orës së mësimin. Për rrjedhojë kohën që mund të kishte kaluar për të shkruar informacionin në dërrasën e zezë, mësuesi e shfrytëzoi duke angazhuar nxënësit në ndërtimin e njohurive të reja.
- Planifikimi i integritit të platformës MësoVET në aktivitete si diskutime online nëpërmjet forumit apo kuice të disponueshme në platformë kërkojnë aftësi digjitale bazë. Me kalimin e kohës dhe rritjen e vetëbesimit, mësuesi mund të eksplorojë funksionalitetet e tjera të platformës.
- Nxënësit ishin të hapur për të ndihmuar njëri-tjetrin në rast të ndonjë problemi teknik që mund të dilte gjatë realizimit të aktiviteteve online.

### **Këshilla për replikimin e orës**

- Për mësuesit me aftësi digjitale bazë të cilët dëshirojnë të përdorin elementë të mësimin online në orën e mësimin, këshillohet që kohëzgjatja e veprimtarive online të jetë e mjaftueshme, madje të lihen disa minuta shtesë në rast problematikash.
- Nëse për nxënësit është eksperiencia e parë e mësimnxënien online, është e rëndësishme që ato të njihen paraprakisht me llojin e aktiviteteve, si dhe t'u jepen udhëzimet e nevojshme para fillimit të orës.
- Është i këshillueshëm bashkëpunimi me mësues të cilët kanë aftësi të mira digjitale për t'ju mbështetur me aspektet teknike të përdorimit të platformës gjatë orës mësimore.

Mësuese:  
**Urani Sota**

Drejtimi:  
**Ndërtim**

Lënda:  
**Konstruksion ndërtimi XI**

Tema/çështja:  
**Betoni, rezistencat e normuara**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënët:**

1. Liston rezistencat e normuara të betonit.
2. Përkufizon rezistencat kubike, në përkulje, në prerje, në tërheqje dhe atë prizmatike, të betonit.
3. Njehson rezistencën kubike të betonit.

**Metoda e aplikuar:**

PNP (*Parashikim – Ndërtim njohurish – Përforcim*)



### Planifikimi i orës mësimore

Faza e orës së mësimt	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
Prezantim i temës dhe i objektivave mësimorë		Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	2 min	Nxënësve u prezantohet tema dhe objektivat mësimorë që synohen të arrihen
Parashikimi	Forum (Çfarë dini për betonin e armuar?)	Online, me ndërveprimin e nxënësve	Monitor; kompjutera (mësuesi dhe nxënësit); platforma digjitale MësoVET	5 min	Udhëzim i nxënësve mbi vendndodhjen dhe zhvillimin e veprimtarisë në platformë; mësuesi ndjek nga platforma përgjigjet
Ndërtimi i njohurive	Njohje me konceptet e reja + video + pyetje/ përgjigje të shpejta	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës (prezantimi)	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	20 min	Prezantohen konceptet e reja, duke iu referuar edhe shembujve
Përforcimi	Diagramë Veni (plotëso vendet bosh)	Online, me ndërveprimin e nxënësve	Monitor; kompjutera (mësuesi dhe nxënësit); platforma digjitale MësoVET	8 min	Ndërtim i diagramit të Venit duke përdorur një ndër opsionet e kuicit online; dhënie e feedback-ut të shpejtë nga mësuesi pas përfundimit
Prezantimi i detyrave të shtëpisë	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës + online (nga shtëpia)	–	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	5 min	Dhënie udhëzimesh për realizimin e detyrës dhe ngarkimin në në platformë

Nga eksperiencia shumëvjeçare, mësuesja kishte vënë re se shumë nxënës në vitet e para të shkollës gjenin vështirësi në kuptueshmërinë e plotë të koncepteve në fushën e drejtimit dhe aplikimin e tyre në praktikë. Metodatat mësimore tradicionale shpesh nuk arrinin të angazhonin këta nxënës në mënyrë efektive. Duke njohur nevojat për një qasje më dinamike dhe interaktive të orës së mësimin, mësuesja vendosi të përfitonte nga platforma MësoVET, ku kishte krijuar një hapësirë virtuale për të lehtësuar pjesëmarrjen aktive, bashkëpunimin dhe eksplorimin e koncepteve përtej kufijve të klasës tradicionale. Ora u zhvillua në një nga kabinetet TIK të shkollës, e pajisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për përdorimin e platformës në mësimdhënie. Për të ndihmuar përcjelljen e koncepteve, mësuesja paraprakisht kishte përzgjedhur dhe digjitalizuar në platformë materialin mësimor për temën e ditës.

Ora filloi me prezantimin e temës dhe njohjen me objektivat mësimorë. Objektivat u formuluan nga mësuesja jo në formë skolasitike, por që të ishin të kuptueshme nga nxënësit. Më pas, u realizua aktivizimi i njohurive ekzistuese nëpërmjet dy pyetjeve të hapura në forum. Të loguar në llogaritë e tyre personale, nxënësit kishin akses në materialin digjital dhe mundtë ndërvepronin online, duke dhënë përgjigjet e tyre në forum. Mësuesja pati mundësi të shihte ecurinë e plotësimin të forumit nëpërmjet monitorit dhe lexoi disa nga përgjigjet nga ekrani duke komentuar saktësinë e tyre dhe inkurajuar nxënësit që janë përgjigjur saktë apo që janë përpjekur. Kjo thyerje akulli i lejoi mësuesestë kalonte natyrshëm në dhënie e informacionit të ri, duke shfaqur materialin mësimor digjital në monitor.

Për të rritur kuptueshmërinë e koncepteve komplekse, mësuesja shfaqti një video të ngarkuar në platformë. Të gjithë nxënësit ndoqën videon dhe shpjegimin e mësuese Uranisë, duke evidentuar momentet kryesore dhe njohuritë më të rëndësishme që duhen mbajtur mend. Kjo video u mundësoi nxënësve të vizualizojnë konceptet teorike të shpjeguara dhe aplikimin e tyre në përditshmëri. Pas videos, mësuesja ftoi nxënësit të realizonin individualisht ushtrim online, në platformë, i cili konsiston në ndërtimin e një Diagrame Veni. Në përfundim të orës, mësuesja orienton nxënësit për realizimin e detyrës së shtëpisë. Implementimi i forumeve, videove mësimore dhe kuicive të ndryshme në orët e mësimin ka krijuar një përvojë të nxëni interaktive për të gjithë nxënësit, ku të gjithë ndihen të përfshirë. Nxënësit janë më bashkëpunues e të hapur për të bërë pyetje dhe për të kuptuar më thellësisht konceptet përmes demonstrimeve vizuale dhe vlerësimeve.


### Pikat e forta të orës mësimore

- Gjatë orës së mësimin u përdor një larmi mjeteve në shërbim të të nxënit, si materiali i përmbledhur mësimor në MësoVET, kuic, forum dhe video. Mjetet ishin përzgjedhur bazuar në logjikë pedagogjike dhe mësuesja kalonte me shkathtësi nga njëra veprimtari në tjetrën, duke e menaxhuar mirë klasën.
- Integrimi i forumeve, videove dhe kuicit rriti ndjeshëm angazhimin e nxënësve në orën e mësimin. Nxënësit morën pjesë në mënyrë aktive në diskutimin online, shikuan video mësimore dhe shijuan formatet interaktive të kuicit. Kombinimi i përmbajtjes vizuale, diskutimeve ndërvepruese dhe reagimeve të menjëhershme i motivoi studentët të përfshihen më shumë në procesin mësimor.
- Përdorimi i videove mësimore u mundësoi studentëve të vizualizojnë teknikat dhe procedurat e ndërtimit, duke rritur të kuptuarit e tyre konceptual. Nxënësit raportuan se shikimi i videove i ndihmoi ata të kuptonin më lehtë konceptet komplekse, duke çuar në përmirësimin e performancës, si në aspektet teorike, ashtu edhe në ato praktike.

### Këshilla për replikimin e orës

- Përdorimi i funksionaliteteve të ndryshme është tërheqës dhe angazhues për nxënësit. Gjithsesi përgatitja e klasës virtuale dhe aplikimi me sukses i formatit të përdorur, kërkon që mësimitdhënësi të ketë aftësi të kënaqshme digjitale. Njëkohësisht, edhe nxënësit duhet të jenë të aftë të punojnë në mënyrë të pavarur me platformën mësimore.
- Krahas kompetencave digjitale, zbatimi i këtij modeli të orës mësimore kërkon infrastrukturën e duhur digjitale për të mbështetur nxënësit gjatë punës së pavarur (pajisje të lidhura me internetin), si dhe gjatë kohës së shpenzuar gjatë shpjegimit në klasë.
- Larmishmëria e mjeteve dhe veprimtarive rrit efikasitetin e orës së mësimin dhe angazhimin e nxënësve. Sidoqoftë, në fokus të planifikimit të veprimtarive duhet të jetë realizimi i suksesshëm i tyre brenda harkut të caktuar kohor dhe jo rritja e sforcuar e numrit të tyre





**SHKOLLA PROFESIONALE  
HAMDI BUSHATI**

**Rastet e mira**

Shkolla "Hamdi Bushati", Shkodër

Mësues:  
**Florian Çoku**

Drejtimi:  
**Hoteleri - Turizëm**

Lënda:  
**Ushqim dhe pije X**

Tema/çështja:  
**Pijet, klasifikimi, rëndësia e tyre në ndërmarrjet gastronomike. Uji, llojet dhe rëndësia e ujit në gastronomi**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënit:**

1. Evidenton rëndësinë e pijeve në ndërmarrjen gastronomike.
2. Përcakton klasifikimin e pijeve.
3. Shpjegon, nëpërmjet elementeve përbërëse, secilin nga llojet e klasifikimit.

**Metoda e aplikuar:**

PNP (*Parashikim – Ndërtim njohurish – Përforcim*)



### Planifikimi i orës mësimore

Faza e orës së mësimt	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
	Prezantim i temës dhe i objektivave mësimorë	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Smart TV; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	2 min	Nxënësve u prezantohet tema dhe objektivat mësimorë që synohen të arrihen
Parashikimi	Stuhi mendimesh	Online, me ndërveprimin e nxënësve	Smart TV; kompjuter (mësuesi); aparate celulare (nxënësit); platforma digjitale MësoVET	7 min	Udhëzim i nxënësve nga mësuesi mbi aktivitetin në platformë.
Parashikimi	Prezantim i përmbajtjes mësimore digjitale	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Smart TV; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	5 min	Shfaqje e përmbajtjes së platformës në Smart TV; shtrim i pyetjes dhe diskutim me nxënësit; nxitje e nxënësve për përfshirje në diskutim.
Ndërtim i njohurive	Njohje me konceptet e reja (prezantimi) + pyetje/ përgjigje të shpejta	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Smart TV; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	20 min	Përcjellje e koncepteve të reja nëpërmjet prezantimit; shtrim pyetjesh
Përforcimi	Ushtrim	Online, me ndërveprimin e nxënësve	Smart TV; kompjuter (mësuesi); aparate celulare (nxënësit); platforma digjitale MësoVET	8 min	Ushtrim mbi objektivat e e orës mësimore; dhënie e udhëzimeve mbi ushtrimin; dhënie e feedback-ut pas përfundimit
	Prezantimi i detyrave të shtëpisë	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës + online (nga shtëpia)	Smart TV; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	3 min	Dhënie udhëzimesh për realizimin e detyrës dhe ngarkimin në platformë

## Realizimi i orës mësimore

---

Mësues Floriani shfrytëzoi më së miri platformën MësoVET për të krijuar një orë mësimore të qëndrueshme, e replikueshme nga mësues të tjerë. Si fillim, mësuesi nisi me prezantimin e çështjes dhe të objektivave mësimore. Mësuesi arriti të krijojë një parashikim të qartë për nxënësit, duke treguar se çfarë do të përftonin dhe cili do të ishte fokusi kryesor i orës mësimore. Kjo ndihmoi nxënësit të kenë një kuptim të qartë të qëllimeve të aktiviteteve që do të zhvillonin gjatë orës mësimore.

Më pas, mësuesi vijoi me një stuhi mendimesh, ku nxënësit iu përgjigjën një pyetje të thjeshtë në platformën MësoVET. Mësuesi shfaqti në Smart TV përgjigjet e tyre në klasë dhe së bashku me nxënësit nisën të diskutonin. Përveç pyetjes që kishte zhvilluar në platformë, mësuesi nisi të bënte pyetje të tjera në mënyrë spontane për të nxitur më tej diskutimin dhe për të kanalizuar informacionin që jepej drejt koncepteve të reja të temës së ditës.

Në fazat e ndërtimit të njohurive të reja, mësuesi përdori platformën MësoVET për të shfaqur përmbajtjen mësimore. Duke përdorur Smart TV ai prezantoi materiale të ndryshme në platformë, duke e sjellë dhe kuriozitetet të ndryshme gjatë kohës që shpjegonte përmbajtjen. Kjo bëri që nxënësit të mbërtheheshin pas informacionit të ri. Shfaqja e materialit digjital në televizor ndihmoi në rritjen e fokusit tek nxënësit. Materiali digjital vinte në forma të larmishme, herë me tekst, herë me imazhe e herë me skema. Ky vizualizim i përmbajtjes ndihmoi nxënësit të kuptonin dhe të lidheshin më mirë me tematika të ndryshme, duke i dhënë atyre një eksperiencë më të përfshirë dhe duke rritur angazhimin.

Më pas, mësuesi vijoi me një ushtrim në platformë për të vlerësuar njohuritë e marra nga nxënësit. Duke qenë se jo të gjithë nxënësit dispononin pajisjet e duhura për të aksesuar ushtrimin në platformën MësoVET, mësuesi vendosi ta përshtaste ushtrimin duke i ndarë nxënësit në grupe dyshe dhe duke i lënë 5 minuta kohë të bënin një përmbledhje të orës mësimore. Në fund të ushtrimit, nxënësit e secilit grup ndanë shënimet e tyre me klasën. Kjo shërbeu dhe si një përsëritje e asaj çfarë ishte shpjeguar, duke e bërë që çdo nxënës të jepte e të merrte diçka prej këtij ushtrimi.

Nëpërmjet këtyre aktiviteteve, mësuesi arriti të përdorte platformën duke krijuar një orë mësimore të realizueshme dhe tërheqëse për nxënësit. Platforma MësoVET u vlerësua si një mjet efektiv për prezantimin e përmbajtjes mësimore, përfshirjen e nxënësve dhe provokimin e mendimit të tyre. Me përdorimin e këtyre metodave, mësuesi arriti që të krijojë një ambient mësimor tërheqës dhe të ndihmojë nxënësit në fitimin e njohurive të reja.

### Pikat e forta të orës mësimore

- Ndarja e kurioziteteve dhe shfaqja e videos ishte një nga pikat më të forta të orës së mësimin, ku mësuesi e përdori për të mbërthyer vëmendjen e nxënësve. Këto materiale digjitale u shfaqën nëpërmjet platformës MësoVET.
- Mësuesi ishte i aftë të adaptonte menjëherë një nga aktivitetet e orës së mësimin dhe të gjejë alternativa të tjera për të ruajtur përfshirjen dhe angazhimin e nxënësve, duke shfrytëzuar burimet e disponueshme në mënyrë kreative. Kjo demonstroi fleksibilitetin dhe aftësinë e mësuesit për të menaxhuar situata të papritura dhe për të siguruar që nxënësit të përfitonin maksimumin nga ora e tyre mësimore.
- Fillimi i orës mësimore duke demonstruar materialet mësimore të ardhura në formë digjitale dhe se si nxënësit mund të navigojnë në to është një element shumë i rëndësishëm i një ore mësimore nëpërmjet platformës MësoVET.

### Këshilla për replikimin e orës

- Platforma MësoVET ofron funksionalitete të larmishme për përdorim gjatë orës mësimore, por koha në dispozicion është e limituar. Për këtë arsye, këshillohet përzgjedhja me kujdes e aktiviteteve që do të realizohen nëpërmjet platformës, si dhe planifikimi i minutazhit për secilën prej tyre.
- Sigurohuni që të gjithë nxënësit kanë një llogari dhe akses në materialet digjitale të një lëndë specifike. Kërkojuni nxënësve tuaj që të testojnë hyrjen në platformë para orës së mësimin.

Mësuese:  
**Albjona Selimi**

Drejtimi:  
**Ekonomi-Biznes**

Lënda:  
**Llogari dhe kontabilitet 10**

Tema/çështja:  
**Përsëritje: Hartimi, klasifikimi  
i bilancit**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënët:**

1. Të shpjegojë termin bilanc bazuar në përshkrimin e materialit mësimor.
2. Të shpjegojë elementet në anën e majtë të bilancit të një ndërmarrjeje.
3. Të shpjegojë elementet në anën e djathtë të bilancit të një ndërmarrjeje.
4. Të hartojë bilancin për një ndërmarrje bazuar në informacionet e dhëna.

**Metoda e aplikuar:**

PNP (*Parashikim – Ndërtim njohurish – Përforsim*)



### Planifikimi i orës mësimore

Faza e orës së mëimit	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
Prezantim i temës dhe i objektivave mësimore		Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Smart TV; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	3 min	Nxënësve u prezantohet tema dhe objektivat mësimore që synohen të arrihen
Parashikimi	Padlet (platforma MësoVET)	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Smart TV; kompjuter (mësuesi); aparate celulare/laptopë (nxënësit); platforma digjitale MësoVET	7 min	Shfaqet pyetja në SmartTV: Cilat janë konceptet dhe termat që ju kanë mbetur në mendje gjatë trajtimit të temës: Hartimi, klasifikimi i bilancit. Nxënësit mund të shkruajnë përgjigjet nga platforma
Parashikimi	Video dhe diskutim online (forum)	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Smart TV; kompjuter (mësuesi); aparate celulare/laptopë (nxënësit); platforma digjitale MësoVET	10 min	Shfaqje e videos në Smart TV; Udhëzim i nxënësve mbi forumin në platformë; Diskutim mbi videon dhe rëndësinë e bilancit për një sipërmarrje të suksesshme; mësuesi ndjek nga platforma përgjigjet dhe bën pyetje për sqarim të mëtejshëm të koncepteve.
Ndërtim i njohurive	Përsëritje e koncepteve kryesore	Duke shfaqur Mësovet	Smart TV; kompjuter (mësuesi)	15 min	Prezantohen dhe përsëriten konceptet dhe termat kryesore
Përforsimi	Kuic (3 pyetje me alternativa)	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Smart TV; kompjuter (mësuesi); aparate celulare/laptopë (nxënësit); platforma digjitale MësoVET	5 min	Dhënie e udhëzimeve mbi kuicin; dhënie e feedback-ut nga mësuesi pas përfundimit.
Përforsimi	Detyrë me shkrim	Online (nga shtëpia)	Smart TV; kompjuter (mësuesi); MësoVET	5 min	Dhënie udhëzimesh për realizimin e detyrës dhe ngarkimin në platformë.

Nëse teknologjia më parë shërbente vetëm si një urë lidhëse mes mësimdhënësit, nxënësit dhe materialit mësimor, tashmë ajo është një komponent thelbësor në procesin mësimor duke e integruar në veprimtari me qëllim personalizimin e mësimdhënies për një të nxënë më efektiv, rritjen e angazhimit të nxënësve, menaxhimin më të mirë të kohës, etj. Në orën e përsëritjes, mësuesja përdori me sukses platformën MësoVET, duke përdorur funksionalitete të ndryshëm dhe integruar mjete të tjerë digjital për të përmirësuar përvojën mësimore përmes materialeve digjitale.

Mësuesja filloi orën duke prezantuar qëllimin e orës mësimore të hapur dhe më pas u kërkon nxënësve të hynë në platformën MësoVET nëpërmjet telefonave dhe disa laptopëve (një në secilin grup). Klasa ishte e vendosur në pozicionin e mësimin të kombinuar dhe jo në formatin tradicional. Duke adoptuar një qasje të mësimin të kombinuar, mësuesja krijoi një mjedis tërheqës për nxënësit. Ora mësimore kishte të bënte me rishikimin e koncepteve të mësuar më parë në lidhje me hartimin dhe klasifikimin e bilancit. Përgjatë gjithë orës mësuesja shfrytëzoi materialin digjital të disponueshëm në platformë për të rifreskuar dhe konsoliduar një pjesë të konsiderueshme të informacionit të dhënë më parë.

Duke përdorur Padlet, mësuesja inkurajoi nxënësit të kontribuonin duke identifikuar fjalët kyçe dhe konceptet më të rëndësishme mbi temën që ata kishin trajtuar prej disa javësh, duke stimuluar kështu njohuritë ekzistuese të nxënësve dhe pjesëmarrjen e tyre. Për të pasuruar më tej procesin e mësimin, mësuesja shfaqti nëpërmjet platformës një video lidhur me temën, pasuar nga një diskutim në forum për të shqyrtuar elementet e përgatitjes së një bilanci si dhe rëndësinë e bilancit për një sipërmarrje të suksesshme.

Gjatë gjithë mësimin, mësuesja inkurajoi ndërveprimin e nxënësve duke përdorur flipchart dhe i ndihmoi nxënësit të angazhoheshin në diskutime produktive, herë në modalitetin tradicional e herë në atë online, ku ajo luajti rolin e moderatores. Mësuesja gjithashtu përfshiu në orën mësimore edhe një kuic online, për të matur nivelin e përfitimit të njohurive dhe ofruar mbështetje individuale kur ishte e nevojshme. Mësuesja përdori platformën MësoVET për të mbledhur dhe vlerësuar përgjigjet e nxënësve.

Në fazën e mbylljes, mësuesja caktoi një detyrë, duke dhënë udhëzime të qarta dhe duke orientuar nxënësit për të ngarkuar punën e tyre të përfunduar në platformë. Edhe pse disa nxënës patën vështirësi për të përfunduar dhe ngarkuar në kohë ushtrimin, mësuesja sugjeroi që ta plotësojnë detyrën në shtëpi. Ora e përsëritjes mund të konsiderohet fillimisht sfiduese për mësuesit e ardhur me kaq shumë larmishmëri aktivitete, por parë nga këndvështrimi i një nxënësi, ai nuk qëndron pasiv, përfshihet në aktivitete të ndryshme, si dhe zhvillon aftësinë e tij për të ndërvepruar dhe punuar online.

### **Pikat e forta të orës mësimore**

- Përdorimi efektiv i platformës MësoVET ofron një hapësirë të përbashkët për aksesimin e materialeve dixhitale, promovimin e bashkëpunimit dhe lehtësimin e aktiviteteve ndërvepruese, duke ndihmuar si nxënësit ashtu edhe mësuesen në menaxhimin e orës.
- Kombinimi i veprimtarive tradicional me ato online, si dhe i punës individuale me atë në grup, krijoi dinamika në klasë edhe gjatë orës së përsëritjes, shkalla e aktivizimit u rrit dhe nxënësit përfituan më shumë nga njëri-tjetri.
- Duke përfshirë në klasën virtuale burime dhe mjete të larmishme, si: Padlet, video, forume, flipchart, u krijua mundësia për një format më të personalizuar të orës së mësimin, duke iu përgjigjur nevojave dhe preferencave të ndryshme të nxënësve, si dhe duke e bërë orën e mësimin më tërheqëse.

### **Këshilla për replikimin e orës**

- Mësimi i kombinuar i aplikuar në klasë gjatë përsëritjes rrit efikasitetin e orës së mësimin duke mundësuar zhvillimin e veprimtarive të larmishme. Sidoqoftë, në fokus të planifikimit të veprimtarive duhet të jetë realizimi i suksesshëm i tyre brenda harkut të caktuar kohor dhe jo rritja e sforcuar e numrit të tyre.
- Koha e shpenzuar në planifikimin e kësaj ore kërkon angazhim të konsiderueshëm, por zbatimi do të jetë më i thjeshtë nëse i paraprihet me parashikimin e detajuar të veprimtarive, modalitetit dhe kohës kushtuar secilës.



Mësuese:  
**Dorina Dedgjonaj**

Drejtimi:  
**Ekonomi-Biznes**

Lënda:  
**Tregti XIII**

Tema/çështja:  
**Shitja - Dokumentet gjatë shitjes  
tsë mallit**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënit:**

1. Evidenton dokumentat gjatë shitjes së mallit.
2. Dallon elementët e dokumenteve nga njëri - tjetri.
3. Shpjegon rëndësinë e plotësimit të dokumenteve në kohën e duhur.

**Metoda e aplikuar:**

PNP (*Parashikim – Ndërtim njohurish – Përforcim*)



### Planifikimi i orës mësimore

Faza e orës së mëimit	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
	Prezantim i temës dhe i objektivave mësimorë	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor, kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	3 min	Nxënësve u prezantohet tema dhe objektivat mësimorë që synohen të arrihen
Parashikimi	Forum në Padlet (platforma MësoVET)	Online, me ndërveprimin e nxënësve në ndërfaqen Padlet në platformë	Smart TV; kompjuter (mësuesi); aparate celulare (nxënësit); platforma digjitale MësoVET	5 min	Shtirim i pyetjeve në forum: I mbani mend dokumentat që përdoren gjatë një procesi shitje? A mund ti evidentonin ato? Nxitje e nxënësve për të dhënë mendimin e tyre mbi pyetjet
Ndërtimi i njohurive	Njohje me konceptet e reja + pyetje/ përgjigje të shpejta	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës (prezantimi)	Smart TV; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	15 min	Prezantohen konceptet e reja, duke i referuar edhe shembujve nga përditshmëria
Ndërtim i njohurive	Ushtrim	Tradicional	Fletë A4, lapustila, tabelë e bardhë	12 min	Jepen udhëzimet për realizimin e detyrës dhe prezantimin e rezultateve.
Përforcimi	Kuic	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Smart TV; kompjuter (mësuesi); aparate celulare (nxënësit); platforma digjitale MësoVET	5 min	Dhënie e udhëzimeve mbi kuicin; dhënie e feedback i shpjegon nga mësuesi pas përfundimit
	Caktimi i detyrave të shtëpisë	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës + online (nga shtëpia)	Smart TV; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	5 min	Dhënie udhëzimesh për realizimin e detyrës dhe ngarkimin në platformë.

## Realizimi i orës mësimore

Në orën e hapur 'Shitja – Dokumentet gjatë shitjes së mallit,' mësuese Dorina synoi të krijojë një përvojë mësimore tërheqëse dhe interaktive për nxënësit e saj duke përdorur platformën MesoVET. Me ndërthurjen e teknologjisë dhe aktiviteteve të ndryshme, mësuesja u mundua të maksimizojë përfitimet e mjeteve digjitale në mësimdhënie. Ndërsa mësimi filloi, mësuesja udhëzoi nxënësit të hyjnë në platformën MesoVET me aparatet celulare ose tabletat e tyre. Disponueshmëria e këtyre pajisjeve brenda shkollës ofron një mundësi për të gjithë nxënësit për të marrë pjesë aktivisht në mësimdhënie duke përdorur teknologjinë. Mësuesja prezantoi objektivat e orës së mësimi, duke theksuar rëndësinë e materialeve të mësimi që gjenden në MesoVET. Për të nisur diskutimin, mësuesja përdori Padlet, një mjet digjital bashkëpunues, për të rikujtuar konceptet e mëparshme të lidhura me temën. Duke inkurajuar nxënësit të ndajnë mendimet dhe idetë e tyre, ajo krijon një mjedis mësimor bashkëpunues. Gjithashtu, ajo ndihmon nxënësit në përdorimin e platformave MesoVET dhe Padlet, duke siguruar që të gjithë të jenë në gjendje të japin kontributin e tyre. Pas diskutimit online, të shoqëruar me shkëmbime dhe komente ballë për ballë, mësuesja kaloi në fazën e ndërtimit të njohurive të reja.

Duke iu referuar materialeve mësimore të disponueshme në MesoVET, ajo shpjegon çështjen e shitjeve dhe dokumentet e nevojshme. Për të përmirësuar kuptimin, ajo lidh konceptet me skenarë të vërtetë dhe shembuj të përditshmërisë. Kjo mënyrë e shpjegimit lejon nxënësit të lidhin teorinë me aplikime praktike, duke e bërë përmbajtjen më të njohur dhe që mbahet mend lehtësisht. Për të përforcuar njohuritë e fituara, mësuesja ka përgatitur një ushtrim që nxënësit duhet ta zhvillojnë individualisht në letër. Ky aktivitet u lejoi nxënësve të aplikojnë atë që kanë mësuar dhe të vlerësojnë kuptueshmërinë nga ana e tyre. Në përfundim të kohës në dispozicion, mësuesja fton dy nxënës për të prezantuar zgjidhjet e tyre përpara klasës, duke krijuar mundësi për të konsoliduar kuptueshmërinë e koncepteve të reja mes njëri-tjetrit dhe vlerësuar njëri-tjetrin njëkohësisht. Pas përfundimit të ushtrimit, mësuesja drejtoi nxënësit në një kuic në platformën MesoVET. Përveç feedback-ut automatik, ofroi një feedback më të thelluar mbi përgjigjet, duke ofruar udhëzime dhe përmirësime për përgjigjet e sakta. Dhënia e feedback-ut ndihmoi nxënësit të identifikonin konceptet për të cilat ata kanë nevojë të thellohen gjatë të nxënësve në shtëpi. Në fazën e fundit, mësuesja udhëzoi nxënësit për detyrat e shtëpisë, të cilat do të punoheshin dhe ruheshin në platformën MesoVET. Duke përdorur teknologjinë për dorëzimin e detyrave, mësuesja siguron një proces të lehtë dhe efikas për të dhënë feedback sa më shpejt dhe të personalizuar. Duke alternuar përdorimin e platformës MesoVET, Padlet dhe aktivitete të tjera në klasë, mësuesja krijoi një përvojë mësimore tërheqëse dhe bashkëpunuese.

### Pikat e forta të orës mësimore

- Duke integruar platforma digjitale si MesoVET dhe Padlet, mësuesja u krijoi nxënësve kushtet e nevojshme për të marrë pjesë aktivisht në procesin e aktivizimit të njohurive ekzistuese. Kjo qasje promovon mendimin kritik, bashkëpunimin dhe konsolidimin e njohurive të mëparshme, duke krijuar bazën për thellimin në njohuritë e reja.
- Duke përdorur shembuj të jetës reale dhe krahasime, mësuesja e bëri mësimin më tërheqës dhe relevant. Kjo qasje ndihmon nxënësit të kuptojnë koncepte abstrakte, duke i lidhur ato me përvojat e tyre personale. Si rezultat, nxënësit zhvillojnë njohuri më të thella për temën dhe aplikimin e saj në praktikë.
- Vlerësimi i vazhdueshëm online dhe feedback-u i menjëhershëm u lejon nxënësve të vlerësojnë progresin e tyre dhe të adresojnë çdo koncept jo të saktë. Duke marrë feedback të personalizuar nga mësuesi, nxënësit fitojnë qartësi dhe mund të bëjnë korrigjime në qasjen e tyre të të nxënësve.

### Këshilla për replikimin e orës

- Merrni kohën tuaj për t'u njohur dhe për të eksploruar funksionalitetet e platformave digjitale, të tilla si MesoVET dhe Padlet. Kjo do t'ju mundësojë t'i integroni ato në mënyrë efektive në mësimdhënie dhe të maksimizoni kohën në dispozicion për angazhim dhe bashkëpunim gjatë orës së mësimi.
- Mësojini nxënësit se si të lundrojnë dhe përdorin platformat digjitale në mënyrë efektive. Jepni udhëzime për ngarkimin e detyrave, aksesin në materialet mësimore dhe përdorimin e mjeteve bashkëpunuese. Ndërtimi i aftësive digjitale të nxënësve i përgatit ata për tregun e punës dhe iu jep atyre potencialin për të përfaquar përdorimin e platformave të tjera shumë të kërkuara në profesionin e tyre.

Mësuese:  
**Silvana Bushi**

Drejtimi:  
**Hoteleri-Turizëm**

Lënda:  
**Komunikimi në Anglisht në  
Hoteleri Turizëm 1**

Tema/çështja:  
**Nxënësi komunikon në gjuhë  
angleze në hotel / Booking a hotel  
room by calling someone**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënit:**

1. Evidenton rëndësinë e komunikimit verbal dhe joverbal.
2. Shpjegon nëpërmjet elementeve përbërës secilën nga strategjitë për një komunikim efektiv.
3. Vlerëson komunikimin joverbal si një mundësi e mirë për ndikimin e dy palëve që flasin më njëri-tjetrin.

**Metoda e aplikuar:**

PNP (*Parashikim – Ndërtim njohurish – Përforsim*)

### Planifikimi i orës mësimore

Faza e orës së mëimit	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
	Prezantim i temës dhe i objektivave mësimorë	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Smart TV; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	2 min	Nxënësve u prezantohet tema dhe objektivat mësimorë që synohen të arrihen
Parashikimi	Akullthyes: Video në platformën MësoVET	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Smart TV, kompjuter (mësuesi); iPad-ë/laptopë (nxënësit); platforma digjitale MësoVET	15 min	Shfaqje e përmbajtjes së videos në monitor/ video-projektor; shtrim i pyetjes që do të diskutohet në forum dhe nxitje e nxënësve për të parë me vemendje videon.
Parashikimi	Forum: Interpretim i videos që nxënësit panë më parë	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Smart TV; kompjuter (mësuesi); iPad-ë/laptopë (nxënësit); platforma digjitale MësoVET	10 min	Udhëzim i nxënësve mbi zhvillimin e forumit në platformë; mësuesi ndjek nga platforma përgjigjet dhe realizon disa pyetje drejtpërdrejt.
Përforsimi	Kuic (3 pyetje me alternativa)	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Smart TV; kompjuter (mësuesi); aparate celulare (nxënësit); platforma digjitale MësoVET	7 min	Dhënie e udhëzimeve mbi kuicin; feedback automatik nëpërmjet platformës.
Përforsimi	Lojë me role	Tradicional	–	8 min	Në grupe 2-she disa nxënës vendosen në rolin e receptionistit dhe klientit dhe improvizojnë një situatë rezervimi nëpërmjet një telefonate
	Caktimi i detyrave të shtëpisë	Online (nga shtëpia)	Smart TV; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	3 min	Dhënie udhëzimesh për realizimin e detyrës dhe ngarkimin në platformë.



Mënyra e konceptimit të orës mësimore nga ana e mësuese Silvanës vendoste theksin tek angazhimi i vazhdueshëm i nxënësve gjatë gjithë orës mësimore, si dhe te përdorimi i vazhdueshëm i funksionaliteteve të ndryshme që ofron platforma MësoVET dhe përmbajtjes digjitale të disponueshme në të. Ora mësimore filloi me prezantimin e objektivave të përcaktuar më parë në platformën MësoVET, të cilat i dhanë nxënësve një parashikim të qartë për atë që do të përfitonin nga orës mësimore.

Më pas, mësuesja shfaqti një video në platformë lidhur me temën mësimore, duke e prezantuar atë në formën e një akullthyesi. Nxënësit, nëpërmjetkësaj videoje, rikujtuan disa koncepte të cilat i kishin njohur në tema të kaluara mësimore. Kështu mësuesja i hapi rrugë diskutimit online në padlet për aktivizimin e këtyre njohurive dhe përkufizimin me fjalët e tyre të koncepteve të reja kryesore, që do të përdornin gjatë orës së mësimi. Nxënësit shprehën mendimet e tyre, duke i argumentuar ato.

Mësuesja gjatë gjithë kohës bënte ndërhyrje nga ana e saj për t'u siguruar që nxënësit kishin kuptuar konceptet e paraqitura në video, duke i ndihmuar ata në ndërtimin gradual të njohurive të reja. Përmes një videoje që ilustroi një rast konkret të rezervimit në një hotel, nxënësit patën mundësinë të shihnin në praktikë si realizohet rezervimi, si komunikohet verbalisht dhe joverbalisht me klientët dhe si duhet të përdoret një qëndrim i përshtatshëm. Mësuesja ndalonte videon herë pas here për të evidentuar elementet kryesore dhe për të siguruar që nxënësit të kuptonin me qartësi.

Në fazën e reflektimit, nxënësit morën pjesë në një kuiz online në platformën MësoVET për të testuar veten dhe për të vlerësuar njohuritë që kishin fituar gjatë orës mësimore. Kuizi ishte i programuar për të dhënë feedback automatik, duke e bërë kështu vetëvlerësimin tërheqës për nxënësit. Për të nxitur pjesëmarrjen aktive të nxënësve të cilët treguan një nivel të ulët të angazhimit, mësuesja krijoi një aktivitet 'Lojë me role' në formë të improvizimit. Nxënësit që kishin marrë më pak pjesë gjatë orës mësimore, do të duhet të luanin rolin e një recepsionisti qëdo të telefonohej nga një klient për rezervimin e një dhome. Mësuesja nëpërmjet këtij aktiviteti u siguroi që asnjë nxënës nuk ngelej pas dhe të gjithë të mund të përfitonin njohuritë kryesore të temës.

Për të bërë një vlerësim të plotë të progresit të nxënësve dhe për të ruajtur nivelin e lartë të angazhimit, mësuesja dha udhëzime për një detyrë shtëpie që kërkonte pjesëmarrjen e secilit nxënës në platformë. Në përfundim të orës mësimore, mësuesja bëri një përmbledhje të njohurive të reja të fituara nga nxënësit dhe shpërndau fleta me emoji për të vlerësuar orën e saj mësimore.

### **Pikat e forta të orës mësimore**

- Mësuesja krijoi një mjedis interaktiv për brainstorming përmes diskutimeve online në padlet dhe kjo e shoqëroi orën e mësimi dhe aktivitetet e tjera. Nxënësit u përfshinë në mënyrë aktive në procesin mësimor dhe patën mundësinë të shprehin mendimet e tyre, të adresojnë pyetje dhe të marrin përgjigje.
- Shpjegimi i temës mësimore përmes platformës MësoVET bëri të mundur që ora e mësimi të vinte në formë të ndryshme, duke përdorur burime multimediale si video, foto etj., që ndihmojnë në përcjelljen e informacionit dhe në krijimin e një mjedisi mësimor tërheqës dhe stimulues për nxënësit.
- Mësuesja personalizoi orën e mësimi duke mos i qëndruar strikte planit të veprimtarive që kishte krijuar. Duke parë pasivitetin e disa prej nxënësve ajo shtoi veprimtarinë e 'Lojës me role' për të ndezur interesin e nxënësve dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen aktive.

### **Këshilla për replikimin e orës**

- Përzgjedhja me kujdes e ngarkesës së orës mësimore në kuadër të veprimtarive të planifikuara, duke qenë se një model i tillë i orës mësimore karakterizohet nga një kalim i shpeshtë nga njëra veprimtari në tjetrën duke mos u lënë nxënësve në dispozicion kohën e nevojshme për të reflektuar dhe për të përcaktuar informacionin e ri.
- Për të shfrytëzuar sa më mirë kohën në dispozicion në klasë, nxënësit mund të udhëzohen paraprakisht të shohin dhe të reflektojnë mbi videot para se të vijnë në klasë. Kjo është një mundësi e mirë për të aplikuar modelin e 'Klasës së përmbysur'.



**Rastet e mira**

Shkolla "Kristo Isak", Tiranë



Mësuese:  
**Elda Polovina**

Drejtimi:  
**Shërbimi Social dhe Shëndetësor**

Lënda:  
**Bazat e Sipërmarrjes XII**

Tema/çështja:  
**Etika e komunikimit dhe negocimit /  
Komunikimi dhe rëndësia e tij**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënit:**

1. Përkufizon konceptin "komunikim".
2. Dallon mënyrat e komunikimit.
3. Shpjegon rëndësinë e shmangies së barrierave në procesin e komunikimit.

**Metoda e aplikuar:**

PNP (*Parashikim – Ndërtim njohurish – Përforcim*)



### Planifikimi i orës mësimore

Faza e orës së mëimit	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
Prezantim i temës dhe i objektivave mësimorë		Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Smart TV; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	2 min	Nxënësve u prezantohet tema dhe objektivat mësimorë të synuar
Parashikimi	Rifreskim njohurish nëpërmjet detyrave të shtëpisë	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Smart TV, kompjuter (mësuesi); iPad-ë/laptopë (nxënësit); platforma digjitale MësoVET	10 min	Diskutohet mbi detyrat e shtëpisë, të ngarkuara në platformë, duke rimarrë njohuritë e mëparshme
Parashikimi	Akyullthyes: video dhe diskutim online (forum)	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Smart TV; kompjuter (mësuesi); iPad-ë/laptopë (nxënësit); platforma digjitale MësoVET	8 min	Nxënësit ndjekin videon dhe udhëzohen mbi postimin e komentit në forum; lexohen disa postime
Ndërtimi i njohurive	Njohje me konceptet e reja + pyetje/ përgjigje të shpejta	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës (prezantim+video përmbledhëse)	Smart TV; kompjuter (mësuesi); aparate celulare (nxënësit); platforma digjitale MësoVET	8 min	Prezantohen konceptet e reja, duke iu referuar edhe shembujve nga përditshmëria; jepen komente mbi videon
Përforcimi	Punë në grup	Tradicional	–	8 min	Prezantohen punimet e grupit në fund në flipchart
Përforcimi	Kuic (3 pyetje me alternativa)	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	–	8 min	Dhënie e udhëzimeve mbi kuicin; dhënie e feedback pas përfundimit
Caktimi i detyrave të shtëpisë		Duke shfaqur përmbajtjen e platformës + online (nga shtëpia)	Smart TV; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	3 min	Dhënie udhëzimesh për realizimin e detyrës dhe ngarkimin në platformë

Në orën mësimore ku flitet mbi komunikimin dhe rëndësinë e tij, mësuesja është siguruar të planifikojë aktivitete të larmishme ku komunikimi është i pranishëm në secilën prej tyre. Mësuesja vendosi theksin tek angazhimi i vazhdueshëm i nxënësve gjatë gjithë orës së mësimi dhe te përdorimi i vazhdueshëm i platformës MësoVET për të nxitur komunikimin me shkrim.

Ora nisi me leximin e detyrave të hedhura në platformë, duke rritur kështu njohuritë ekzistuese, dhe vijoi me prezantimin e temës së ditës dhe objektivave mësimorë. Si akullthyes mësuesja luan një video në monitor, material i cili ishte integruar në platformë, dhe i ftoi nxënësit që ndërkohë që shohin videon të japin mendimin e tyre rreth një pyetjeje të hapur online në forum. Nxënësve kishin kohën e nevojshme në dispozicion për të reflektuar dhe shkruar përgjigjet e tyre, disa prej të cilave u lexuan dhe u plotësuan nga mësuesja në klasë. Duke komentuar përgjigjet e nxënësve mësuesja kaloi shumë natyrshëm drejt koncepteve të reja me të cilat nxënësit do të njiheshin në temën e ditës.

Ndërkohë që mësuesja shpjegonte në klasë, nxënësit mund të ndiqnin nëpërmjet monitorit ose laptopit të tyre prezantimin e përgatitur prej saj, ku informacioni i ri në formë teksti të përmbledhur shoqërohet me fjalë kyçe dhe imazhe. Mësuesja nxiste nxënësit të shprehnin mendimin e tyre nëpërmjet pyetjeve, herë në lidhje me një imazh të shfaqur në platformë, herë në lidhje me përditshmërinë e tyre. Mësuesja u kujdes që nxënësit të aktivizohen vazhdimisht dhe të mos krijohet monotoni gjatë orës mësimore. Për këtë arsye, pas dhënies së informacionit të ri ajo shfaqti në monitor një video të animuar ku përmbledhej informacioni kryesor. Për të konsoliduar dhe vlerësuar marrjen e njohurive të reja, si dhe për të nxitur komunikimin mes nxënësve, mësuesja kishte planifikuar një punë me grupe. Të ndarë në grupe nxënësit diskutojnë dhe plotësojnë njëri-tjetrin për të plotësuar në flipchart përgjigjet e pyetjes e cila lidhej ngushtë me konceptet e reja dhe videon që ato sapo kishin parë. Mjedisi mësimor u bë shumë i gjallë.

Nxënësit ishin të gjithë të angazhuar dhe në fund dakordësuan kush do t'i përfaqësojë për të prezantuar mendimet e tyre. Të ndarë në grupe, nxënësit mundën të mësojnë edhe nga puna e realizuar nga grupi tjetër, ndërkohë që mësuesja saktësonte përgjigjet dhe përmbledhte informacionin e sjellë nga ata. Pasi përfundoi të punës në grup, mësuesja i ftoi nxënësit të vlerësojnë njëri tjetrin për të nxjerrë grupin fitues. Drejt fundit, mësuesja ftoi nxënësit të realizojnë një kuic të shkurtër online, në platformë, për të matur nivelin e kuptueshmërisë. Ora u finalizua me udhëzimet e mësueses mbi realizimin e detyrës, e cila do të ngarkohet në platformë.

### **Pikat e forta të orës mësimore**

- Shfrytëzimi optimal i mundësive që krijon platforma, për realizimin me sukses të një ore mësimore të kombinuar, duke ndërthurur angazhimin tradicional me atë online.
- Planifikimi i aktiviteteve të larmishme, ku nxënësi vendoset në qendër të orës mësimore dhe mësuesi luan rolin e lehtësuesit.
- Angazhimi i lartë i nxënësve përgjatë gjithë orës së mësimi, si gjatë veprimtarive tradicionale, ashtu edhe gjatë atyre nëpërmjet platformës.
- Format e ndryshme të matjes së shkallës së kuptueshmërisë së informacionit të ri, duke përfshirë vlerësimin mes të njëjtëve (puna në grup) dhe vlerësimin digjital (kuic).

### **Këshilla për replikimin e orës**

- Në rast të replikimit të kësaj ore mësimore nga kolegë të tjerë, t'i kushtohet vëmendje e veçantë kalimit nga modaliteti online në atë tradicional dhe e kundërta.
- Kujdes i shtuar në sigurimin dhe mirëfunksionimin e mjeteve të punës dhe infrastrukturës fizike dhe digjitale, si rrjedhojë e mbështetjes së gjerë të veprimtarive mësimore në to.
- Marrje në konsideratë e aftësive digjitale të mësuesit/-es dhe të nxënësve, duke qenë se një model i tillë ore mësimore karakterizohet nga një kalim i shpeshtë nga njëra veprimtari në tjetrën.

Mësuese:  
**Nertila Dundo**

Drejtimi:  
**Hoteleri- Turizëm**

Lënda:  
**Ekonomi e turizmit XIII**

Tema/çështja:  
**Politikat e zhvillimit të turizmit /  
Politika monetare**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënët:**

1. Përkufizon politikën monetare.
2. Shpjegon llojet e politikës monetare.
3. Analizon kufizimet e politikës monetare.

**Metoda e aplikuar:**

ERR (Evokim – Realizim i kuptimit – Reflektim)



### Planifikimi i orës mësimore

Faza e orës së mësimit	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
Prezantim i temës dhe i objektivave mësimorë		Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	2 min	Nxënësit njihen me çështjen e ditës dhe me objektivat mësimorë të saj
Evokimi	Pyetje-përgjigje nga vendi	Tradicional	–	3 min	Nxënësve iu drejtohen pyetje të shkurtra për rifreskim njohurish
Evokimi	Forum: Interpretim i një thënieje të njohur	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Monitor; kompjuter (mësuesi); laptopë/ (nxënësit); platforma digjitale MësoVET	7 min	Udhëzim i nxënësve mbi vendndodhjen dhe zhvillimin e veprimtarisë në platformë; mësuesi ndjek nga platforma përgjigjet dhe realizon një pëmbledhje
Realizimi i kuptimit	Njohje me konceptet e reja + pyetje/ përgjigje të shpejta	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës + tradicional	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	15 min	Prezantohen konceptet e reja, duke iu referuar edhe shembujve nga përditshmëria
Reflektimi	Lojë fjali-formuese (puzzle)	Tradicional	–	8 min	Punë në grupe për formimin e fjalive nëpërmjet renditjes logjike të fletëve të koncepteve; vendosje e fletëve në tabelën e bardhë
Reflektimi	Kuic (3 pyetje me alternativa)	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Monitor; kompjuter (mësuesi); laptopë (nxënësit); platforma digjitale MësoVET	Fleta me koncepte; tabelë e bardhë	Dhënie e udhëzimeve mbi kuicin; dhënie e feedback-ut të shpjegët nga mësuesi pas përfundimit
Caktimi i detyrave të shtëpisë		Duke shfaqur përmbajtjen e platformës + online (nga shtëpia)	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	5 min	Dhënie udhëzimesh për realizimin e detyrës dhe ngarkimin në platformë

Një orë me aktivizim të lartë të nxënësve falë ndërveprimit tradicional dhe nëpërmjet platformës digjitale të përdorur, është një orë që flet për efikasitet në mënyrën e zhvillimit të saj dhe në ndikimin që ka tek aftësimi i nxënësve. Në orën e saj të hapur, mësuese Nertila Dundo kishte planifikuar veprimtari të larmishme, me përdorim të një game të gjerë mjetesh dhe materialesh në funksion të të nxënësve dhe të angazhimit të nxënësve. Me qëllim evokues, ora nisi me pyetje mbi njohuritë e marra më parë, duke i referuar edhe situatës aktuale në vend mbi çështjet e trajtuara. Mësuesja i njohu nxënësit me objektivat e orës së mësimi, duke përdorur platformën e shfaqur në monitor, ndërkohë që i kishte shënuar ato paraprakisht edhe në flipchart, për t'i paraprirë ndonjë problemi të mundshëm teknik.

Më pas, nxënësit u ftuan të logohen në platformë për të marrë pjesë në një forum, ku do të diskutonin mbi kuptimin që ata i jepnin një shprehje të njohur të cituar. Mësuesja asistonte nga afër ata që ndeshën vështirësi për t'u loguar apo për të gjetur vendndodhjen e veprimtarisë në platformë. Që në fillim të orës, mësuesja mori natyrshëm rolin e facilitueses së të nxënësve. Me hyrjen në forum, nxënësit komentuan shprehjen e cituar nëpërmjet dhënies së mendimit të tyre. Ky aktivitet nxiti shprehjen e mendimit të tyre të lirë dhe të ndarjes së opinionit edhe me të tjerët, edhe nga nxënës që me gojë ndoshta do të kishin hezituar. Mësuesja ndoqi ecurinë e plotësimit të forumit nëpërmjet monitorit, ftoi disa nxënës të lexojnë përgjigjen e dhënë, si dhe bëri disa komente përmbledhëse.

Në vazhdim, u kalua në fazën e realizimit të kuptimit, duke shfrytëzuar sërish platformën, kësaj here duke i referuar shfaqjes së saj në monitor, ku nxënësit u njohën me një prezantim sintetik mbi njohuritë e reja. Mësuesja thellohet gradualisht në koncepte, duke nxitur edhe nxënësit të aktivizohen nëpërmjet pyetjeve të herëpashershme. Prania e skemave në prezantim, të vizatuara si plan B edhe në flipchart, si dhe interpretimi i tyre nga ana e nxënësve, e bënë më efikas procesin e transmetimit të njohurive më efikas, pra rënë pre e monotonisë. Në fazën e reflektimit, mësuesja kishte përgatitur mjetet e punës për të realizuar një lojë fjaliformuese, nëpërmjet disa fletëve ku shkruheshin koncepte që nxënësit, të ndarë në grupe, duhet t'i renditin për të krijuar fjali me kuptim, në lidhje me temën e re. Gjatë punës në grup, mësuesja theksoi vazhdimisht rëndësinë e menaxhimit të kohës, atë të punës në grup, të dhënies së zgjidhjeve praktike (organizimi i punës gjatë lidhjes dhe ngjithësisht letrave për të krijuar fjalinë), si aftësi të rëndësishme për t'u fituar prej nxënësve. Klasa u shndërrua në një mjedis plot jetë, ku nxënësit ishin të gjithë të angazhuar, në komunikim brenda grupit dhe mes grupeve. Sipas fazave të punës, u krijuan bërthama të ndryshme, me disa nxënës në tabelë, disa në banka, si dhe disa duke orientuar shokët. Pasi përfundoi loja, nxënësit lexuan fjalitë e formuara, shoqëruar me një përmbledhje të shkurtër nga ana e mësueses. Krahas kësaj veprimtarie në formatin tradicional, faza e reflektimit u përforcua edhe me zhvillimin e një kuici nëpërmjet platformës për matjen e nivelit të kuptueshmërisë së njohurive. Pas marrjes së udhëzimeve për gjetjen e veprimtarisë në platformë, duke shfaqur përmbajtjen në monitor, të gjithë nxënësit punuan për zgjidhjen e kuicit, teksa mësuesja monitoronte rezultatet në të dhënat tabelare të gjeneruara nga platforma. Veprimtaria në platformë u përmbyll nëpërmjet feedback-ut mbi saktësinë e përgjigjeve dhe nevojat për përmirësim. Në fund të orës, mësuesja caktoi detyrat e shtëpisë, të cilat nxënësit do t'i realizonin në word dhe do t'i ngarkonin në platformë. Në tërësi, ora ishte dinamike dhe me larmi veprimtarish. U përdorën mjete të ndryshme që lehtësojnë të kuptuarit: platforma, flipchart, skematizim i shpejtë në tabelën e bardhë etj. Deri në fund të orës, mësuesja konfirmoi vazhdimisht përvetësimin e njohurive nëpërmjet pyetjeve të ndryshme dhe koha u menaxhua më së miri.

### **Pikat e forta të orës mësimore**

- Pozicionimi me sukses i mësueses në rolin e lehtësuesit, duke asistuar nxënësit në ndërtimin e njohurive dhe duke nxitur angazhimin e tyre, veçanërisht në pjesëmarrjen në veprimtari online.
- Përdorimi i një larmie mjetesh dhe instrumentesh në shërbim të të nxënësve: platforma digjitale, flipchart, skica, letra ngjithësisht për fjalët kyçe, etj., duke krijuar një mjedis mësimor të gjallë dhe angazhues, si dhe duke lehtësuar përvetësimin e njohurive.
- Përgatitja e një "plani B" për t'i paraprirë problemeve të mundshme teknike, duke sjellë pjesët kyçe të materialit (objektiva, skica, tabela etj.) edhe në version tradicional, në flipchart.

### **Këshilla për replikimin e orës**

- Vetëdijësimi i mësuesve replikues mbi shkathtësinë e tyre në përdorimin intensiv të platformës gjatë orës së mësimi dhe në kapërcimin nga një modalitet veprimtarie në tjetrën, në kushtet e një larmie të tillë veprimtarish dhe mjetesh të punës.
- Parapërgatitja e kujdesshme e veprimtarive, materialeve dhe mjeteve të përdorura, si e atyre tradicionale, ashtu edhe atyre të mbështetura në teknologji/përdorim platforme, për të menaxhuar optimalisht klasën dhe kohën në dispozicion të orës së mësimi.



Mësuese:

**Gentiana Hazinedari**

Drejtimi:

**Shërbime Sociale dhe  
Shëndetësore**

Lënda:

**Gjeografi X**

Tema/çështja:

**Liqenet**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënët:**

1. Përshkruan kuptimin e termave: liqen, peizazh liqenor, lagunë.
2. Rendit faktorët liqenformues.
3. Analizon liqenet sipas origjinës së formimit të tyre, shoqëruar me shembuj konkretë nga bota dhe vendi ynë.
4. Identifikon faktorët që ndikojnë në shndërrimin e liqeneve në kënetë.
5. Vlerëson rëndësinë e liqeneve për jetën e njerëzve dhe rolin e veprimtarisë njerëzore në mbrojtjen e tyre.

**Metoda e aplikuar:**

PNP (*Parashikim – Ndërtim njohurish – Përforcim*)

**Planifikimi i orës mësimore**



Faza e orës së mëimit	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
Prezantimi i temës dhe i rezultateve të të nxënët		Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Smart TV; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	2 min	–
Parashikimi	Pyetje-përgjigje nga vendi / diskutim mbi detyrat e shtëpisë	Tradicional + duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Smart TV; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	6 min	Nxënësve iu drejtohen pyetje të shkurtra për rifreskim njohurish; shqyrtohet detyra e shtëpisë me shembuj nëpërmjet platformës
Ndërtim i njohurive	Shfaqje e një videoje /evidentim njohurish kyçe	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës + tradicional	Smart TV; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET; fletushka	7 min	Ndihet dhe komentohet videoja në platformë; nxënësit shënojnë në fletushka konceptet më të rëndësishme
Ndërtimi i njohurive	Përcjellje njohurish	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës (prezantimi)	Smart TV; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale	8 min	Nxënësit njihen me prezantimin (slides) mbi njohuritë e reja; pyetje-përgjigje
Përforcimi	Shënime të strukturuar	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës + tradicional	Smart TV; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET; fleta të mëdha; flipchart	15 min	Punë në ekip (4 grupe) sipas ceshtjeve të prezantuara; prezantim i shënimeve të strukturuar për secilin grup (ekspozim i përgjigjeve në flipchart); vlerësim mes shokëve
Përforcimi	Kuic (3 pyetje me alternativa)	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Smart TV; kompjuter (mësuesi dhe nxënësit); platforma digjitale MësoVET	5 min	Dhënie e udhëzimeve mbi kuicin; dhënie e feedback-ut të shpjeguar nga mësuesi pas përfundimit; demonstrim rezultatesh nga platforma
	Caktimi i detyrave të shtëpisë	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës + online (nga shtëpia)	Smart TV; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	2 min	Dhënie udhëzimesh për realizimin e detyrës dhe ngarkimin në në platformë



Ora e hapur e realizuar nga mësuese Gentiana Hazinedari ishte një orë dinamike, e karakterizuar nga përdorimi i mënyrave dhe mjeteve të larmishme të transferimit të njohurive, si dhe të realizimit të vlerësimit. Platforma MësoVET u integrua me sukses përgjatë gjithë veprimtarive të realizuara, duke ndërthurur, sipas llojit të veprimtarisë, prezantimin e përmbajtjes së platformës nëpërmjet monitorit me punën e nxënësve në platformë. E gjithë përmbajtja dhe veprimtaritë e gjendura në platformë ishin vendosur rishtazi nga ana e mësueses, pikërisht për të mundësuar orën e hapur, duke qenë se lënda në fjalë nuk disponon materiale të plota digjitale mësimore si lëndë të tjera. Duke patur parasysh rëndësinë e njohjes paraprake të nxënësve me rezultatet e të nxënësve, ora nisi duke i prezantuar ato dhe duke krijuar te nxënësit pritshmëritë e duhura përgjatë mësimit. Në kuadër të aplikimit të metodës PNP, ora vijoi me fazën e parashikimit, të cilën mësuesja e nisi në formatin tradicional, duke realizuar aktivizimin e njohurive ekzistuese të nxënësve nëpërmjet disa pyetjeve me gojë, të cilave nxënësit iu përgjigjën me shkathtësi dhe me nivel të kënaqshëm aktivizimi. Në funksion të lidhjes graduale me njohuritë e reja, por edhe për të nxjerrë në pah shkallën e kuptueshmërisë së koncepteve tashmë të fituara, ora vazhdoi me prezantimin e detyrave të shtëpisë, të cilat ishin ngarkuar nga nxënësit në platformën MësoVET. Mësuesja tregoi në monitor, në formë shembulli, disa detyra të realizuara. Një nxënës uftua të shpjegonte mënyrën e konceptimit të detyrës, ndërkohë që të tjerët e ndiqnin nëpërmjet monitorit. Një element për t'u vlerësuar ishte dhënia e feedback-ut me shkrim nga ana e mësueses për çdo detyrë, duke opsionet për postim në platformë. U kalua më pas në ndërtimin e njohurive të reja. Këtë fazë të orës së mësimit, mësuesja e kishte konceptuar nëpërmjet shfaqjes së një videoje mbi liqenet, e cila është ngarkuar paraprakisht në platformë. Nxënësit ndoqën me interes videon në monitor, teksa mësuesja u shpërndante fletushka për t'u plotësuar me informacionin që nxënësit e konsideronin më të rëndësishëm nga përmbajtja e videos, si pjesë e aplikimit të një qasjeje konstruktiviste në të nxënë. Mësuesja komentonte herë pas here videon, theksonte konceptet themelore, si dhe drejtonte pyetje për të verifikuar qartësinë dhe shkallën e përvetësimit të informacionit të dhënë. Pas plotësimit të fletushkave, nxënësit i ngjiten në tabelën e bardhë, duke lëvizur lirshëm nëpërmjet klasës dhe duke u ndjerë maksimalisht të përfshirë. Faza vijoi me dhënien e komenteve mbi informacionin e nxjerrë nga nxënësit, duke evidentuar edhe konceptet e fituara me parë me ato të reja. Pas videos, njohuritë e reja vijuan të përcillen me anë të një prezantimi të ngarkuar sërish në platformë dhe të shfaqur në monitor. Mësuesja vazhdoi të punojë me konceptet e reja, si dhe të bëjë pyetje të shpeshta mbi to. Më pas, në kuadër të përfundimit, nxënësit u përfshinë në një tjetër veprimtari, atë të shënimeve të strukturuar, të organizuar në formën e një pune në ekip (4 grupe), sipas çështjeve të temës së re. Secili grup u pajis me një fletë të madhe, ku nxënësit, me udhëzimet e mësueses, punuan bashkërisht sipas roleve të caktuara. Mësuesja ndiqte nga afër avancimin e secilit grup në plotësimin e fletës. Më pas, fletët u ngjiten në flipchart dhe grupet komentuan punën e njëri-tjetrit, duke dhënë edhe vlerësim mes shokëve. Drejt fundit të orës, faza e përfundimit u kompletua edhe me një kuic që nxënësit e realizuan individualisht nëpërmjet platformës, duke përdorur laptopët në dispozicion. Sipas ritmit të tyre të punës, nxënësit dhanë përgjigjet e kuicit, të cilat u diskutuan edhe nga mësuesja nëpërmjet gjenerimit të automatizuar të tabelës përmbledhëse të rezultateve. Në prag të mbylljes së orës, mësuesja udhëzoi nxënësit për realizimin e detyrës së shtëpisë – ndërtimi i një diagrami Veni – që nxënësit do ta ngarkonin në platformë. Nxënësit ishin të përqendruar dhe aktivë deri në fund të orës së mësimit.

### Pikat e forta të orës mësimore

- Lënda e Gjeografisë nuk disponon materiale mësimore digjitale të përgatitura në platformë, si në rastin e lëndëve të tjera, megjithatë vendosja e përmbajtjes digjitale dhe krijimi i veprimtarive në platformë u bë i mundur dhe u shfrytëzua në mbështetje të orës së mësimit.
- Larmia e veprimtarive dhe mjeteve të përdorura gjatë fazës së ndërtimit të njohurive: ndjekje e një videoje, prezantimi me power point dhe seanca të shkurtra pyetje-përgjigjesh, duke ndërthurur edhe punën në grup.
- Procesi i kombinimit të veprimtarive tradicionale dhe online u shtri edhe në dhënien e feedback-ut, falë postimit të komenteve mbi secilën detyrë të shtëpisë, të ngarkuar në platformë, duke mundësuar kalimin përtej kontrollit tradicional të detyrave të shtëpisë.

### Këshilla për replikimin e orës

- Reduktim i numrit të veprimtarive, për të menaxhuar më me sukses kohën në dispozicion, duke marrë parasysh edhe kohën shtesë që mund të shpenzohet gjatë dhënies së instruksioneve për kryerjen e veprimtarive online, vonesave të mundshme të nxënësve për t'u orientuar në platformë apo pengesave të mundshme teknike.
- Përdorimi i platformës me pjesëmarrjen e nxënësve edhe në ndonjë veprimtari tjetër, si p.sh. integrimi i një forumi diskutimi në përputhje me tematikën.

Mësues :  
**Resmi Tallas**

Drejtimi:  
**Shërbime sociale dhe  
shëndetësore**

Lënda:  
**Kimi X**

Tema/çështja:  
**Detyrë eksperimentale (punë laborator)  
/ Elektroliza tretësirës së klorurit  
të natriumit të përqendruar dhe  
sulfatit të bakrit (II)**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënit:**

1. Tregon aftësi në përdorimin e teknikave, aparateve dhe materialeve.
2. Realizon me shumë kujdes të gjitha veprimtaritë.
3. Vrojton me kujdes të gjithë ecurinë e eksperimentit.
4. Analizon dhe arrin në konkluzione.



**Metoda e aplikuar:**

Veprimtari praktike (*Eksperimenti*)

### Planifikimi i orës mësimore

Faza e orës së mësimimit	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
Prezantim i temës dhe i objektivave mësimore		Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Video-projektor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	2 min	Nxënësve u prezantohet tema dhe objektivat mësimore që synohen të arrihen.
Parashikimi	Parashikim me terma paraprake (video)	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Video-projektor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	4 min	Shfaqje e përmbajtjes së platformës në video-projektor; shfaqje e videos për elektrolizën e tretësirës së përqendruar të CuSO <sub>4</sub> .
Ndërtim i njohurive	Prezantimi i grupeve të punës	Tradicional	–	10 min	Prezantohet përbërja e grupeve dhe veprimtaria që do të kryhet
Eksperimenti	Ndërtimi i aparatit të elektrolizës / kryerje e elektrolizës	Tradicional	Mjete/instrumente laboratorike	15 min	Grupet kryejnë eksperimentin & mbajnë shënime për ecurinë e tij.
Analiza e punës	Analiza e ecurisë së eksperimentit	Tradicional	–	10 min	Përgjegjësit e grupeve analizojnë përfundimet e nxjerra nga eksperimenti i kryer.
Caktimi i detyrave të shtëpisë	Detyrë me shkrim	Tradicional	–	4 min	Dhënie udhëzimesh mbi detyrën: plotësimi i kolonës së përfundimeve të eksperimentit në fletoren e punës laboratorike

Në klasat tradicionale laboratorike, mësuesit planifikojnë veprimtaritë praktike, dizenojnë eksperimentet dhe sigurojnë disponueshmërinë e pajisjeve dhe materialeve të nevojshme, ndërsa nxënësit marrin pjesë në punë laboratorike, ku marrin udhëzime, kryejnë veprimtaritë praktike (eksperimentet), dokumentojnë dhe analizojnë rezultatet. Në mënyrë që klasat laboratorike të bëhen më dinamike dhe interaktive, mësuesi Resmiu ka gjetur format e integritit të elementeve të mësimin online falë njohjes me disa nga funksionalitetet e platformës MësoVET dhe mënyrës se si ato mund të përdoren në avantazh të orës laboratorike.

Ekzistojnë forma të ndryshme se si mësuesit mund ta përdorin platformën, duke lejuar nxënësit të angazhohen përtej kufijve të hapësirës fizike të laboratorit. Mësuesit mund të ndajnë me nxënësit dokumente të formateve të ndryshëm, burime, të ngarkojnë detyra, etj. Kjo u lejon nxënësve të kenë akses në to në çdo kohë dhe kudo. Nga ana tjetër, nxënësit mund të paraqesin raportet laboratorike elektronikisht, të marrin pjesë në diskutime online dhe të bashkëpunojnë në projekte. Për realizimin e temës 'Elektroliza tretësirës së klorurit të natriumit të përqendruar dhe sulfatit të bakrit (II)', mësuesi Resmiu ka përdorur elementin multimedia, më konkretisht videot. Ora u mbështet pjesërisht në modelin e klasës së përmbysur, ku nxënësit ishin udhëzuar paraprakisht për të ndjekur dy video mësimore nëpërmjet platformës.

Pas prezantimit të temës së ditës, objektivat mësimore dhe veprimtarive praktike që do të realizohen, ora nisi me rishikimin e videove. Shfaqja epërmbajtjes së platformës në monitor ndikoi pozitivisht në ruajtjen e fokusimit të nxënësve dhe në vizualizimin e proceseve që u shpjeguan. Mësuesi Resmiu, duke integruar videot në lëndën e Kimisë në platformën MësoVET, e bëri orën e laboratorit më dinamike, tërheqëse dhe efektive. Demonstrimi vizual e në mënyrë të detajuar i hapave e procedurave laboratorike lejoi nxënësit të vëzhgojnë dhe kuptojnë procesin në mënyrë më efektive krahasuar me udhëzimet e shkruara, si dhe aksesin e tyre në çdo kohë krijoi fleksibilitet tek nxënësit, duke i lejuar ata të shohin e rishohin videot në ritmin dhe mënyrën e tyre të përshtatshme, si para ashtu dhe gjatë eksperimentit.

Me ndihmën e mësuesit, nxënësit evidentuan nga përmbajtja digjitale koncepte tashmë të njohura për ta, si dhe ndërtuan gradualisht njohuritë e reja të shfaqura në video, duke ia lënë radhën ndarjes në grupe dhe realizimit të veprimtarisë praktike. Faza e eksperimentit dhe analizës së punës u krye në modalitetin tradicional. Grupet kryen eksperimentin dhe mbajtën shënime për ecurinë e tij dhe më pas përgjegjësit e grupeve analizuan përfundimet që kanë dalë nga eksperimenti i kryer. Në fund të orës, mësuesi orientoi nxënësit për realizimin e detyrës së shtëpisë.

### **Pikat e forta të orës mësimore**

- Videot mund të përdoren për të demonstruar hapat e eksperimenteve laboratorike në mënyrë të detajuar. Ky demonstrim vizual lejon nxënësit të vëzhgojnë dhe kuptojnë procesin në mënyrë më efektive krahasuar me udhëzimet e shkruara.
- Nxënësit mund të angazhohen me materialet në formë video-je në ritmin dhe mënyrën e tyre të dëshiruar. Nxënësit mund t'i rikthehen e të rishikojnë demonstrimet në video për të përforcuar kuptimin e koncepteve dhe hapave ose për të rifreskuar njohuritë.
- Duke integruar videot në platformën MësoVET, ora laboratorike bëhen më dinamike, tërheqëse dhe të arritshme. Nxënësit mund të përfitojnë nga demonstrimet vizuale dhe mundësia për të rishikuar përmbajtjen digjitale kur është e nevojshme.

### **Këshilla për replikimin e orës**

- Dhënia e udhëzimeve sa më të qarta për punën që nxënësit do të realizojnë në platformë para ardhjes në orën e mësimin (aplikimi i klasës së përmbysur).
- Ngarkimi me kujdes i videos në platformë, duke siguruar që të gjithë nxënësit kanë akses dhe lehtësi në gjetjen e përmbajtjes digjitale dhe mund ta shohin atë kurdo e kudo.
- Përdorni videot për të nxitur bashkëpunimin midis nxënësve. Mund t'iu kërkoni atyre të shkëmbejnë mendime, të ndajnë vëzhgimet e tyre dhe të diskutojnë rezultatet e eksperimentit duke përdorur forumet online.

Mësuese:  
**Silvana Duraj**

Drejtimi:  
**Hoteleri-Turizëm**

Lënda:  
**Gjeografi turistike XIII**

Tema/çështja:  
**Oferta gjeografiko-natyrore e Shqipërisë në fushën e turizmit / Pasuria ujore e Shqipërisë dhe ndikimi i saj turistik**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënit:**

1. Evidenton format e pasurive ujore turistike në Shqipëri?
2. Interpretton pikat më të rëndësishme turistike që lidhen me pasurinë ujore
3. Analizon pse pasuria ujore përbën një element të rëndësishëm të ofertës turistike

**Metoda e aplikuar:**

PNP (Parashikim – Ndërtim njohurish – Përforsim)



### Planifikimi i orës mësimore

Faza e orës së mësimt	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
	Prezantim i temës dhe i objektivave mësimorë	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	2 min	Nxënësve u prezantohet tema dhe objektivat mësimorë
Parashikimi	Interpretim i një fotoje	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës (kartat e kthyer - flipcards)	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	5 min	Përdorimi i funksionalitetit Flipcard – në njëën anë të kartës ndodhet pyetja rreth fotos dhe në anën tjetër përgjigjia
Parashikimi	Forum	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Monitor ; kompjuter(mësuesi); laptopë (nxënësit); platforma digjitale MësoVET	5 min	Udhëzim i nxënësve mbi vendndodhjen dhe zhvillimin e veprimtarisë në platformë; mësuesi ndjek nga platforma përgjigjet dhe komenton mbi to
Ndërtim i njohurive	Njohje me konceptet e reja + pyetje/ përgjigje të shpejta	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës (prezantimi)	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	10 min	Nëpërmjet një prezantimi PowerPoint prezantohen konceptet e reja
Përforsimi	Punë/lojë në grupe	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë + tradicional	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET; flipchart	15 min	Nëpërmjet Lojës së Memories në MësoVET, nxënësit në grupe identifikojnë elemente dhe japin informacion mbi to
Përforsimi	Kuic (5 pyetje me alternativa)	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Monitor ; kompjuter(mësuesi); laptopë (nxënësit); platforma digjitale MësoVET	5 min	Dhënie e udhëzimeve mbi kuicin; feedback automatik nga platforma



Në përgjithësi, përdorimi i lojërave interaktive në mësimdhënie sjell një ndryshim tërheqës dhe efektiv në mënyrën se si nxënësit mësojnë. Këto lojëra promovojnë angazhimin e tyre, duke i bërë ata të ndjehen të përfshirë në mësim. Në vend që të jenë vetëm dëgjues pasivë, ata marrin pjesë në veprimtari interaktive që ndikojnë në trurin dhe shqisat e tyre. Përdorimi i lojërave interaktive ndihmon në përmirësimin e aftësive të ndryshme të nxënësve. Ata zhvillojnë aftësi kognitive, si përqendrimi, kujtesa apo zgjidhja e problemeve. Përveç kësaj, nxënësit ndjekin dhe vlerësojnë progresin e tyre përmes vlerësimeve dhe rezultateve të shfaqura gjatë lojës. Sidoqoftë, integrimi i lojërave interaktive në mësimdhënie mund të realizohet vetëm në kontekstin e një planifikimi të qartë dhe të përshtatshëm. Ato duhet të mbështetnin objektivat mësimore dhe të plotësohen me materiale të tjera mësimore.

Duke konsideruar të gjithë elementët e sapopërmendura, mësuese Silvana kishte konceptuar një orë mësimore duke përdorur në avantazh të saj lojërat interaktive. Të gjithë nxënësit ndodheshin në stacionin e tyre, me një laptop përpara, të loguar në platformën MësoVET. Pas prezantimit të temës së ditës dhe objektivave mësimore, ora nisi me lojën 'Kartat e kthyer' (Flipcard), një funksionalitet i cili ofrohet nga platforma MësoVET. Nga njëra anë e kartës mësuesja kishte vendosur një imazh dhe ftoi nxënësit të përgjigjen duke u bazuar në njohuritë e tyre ekzistuese. Pasi nxënësit përgjigjeshin, diskutonin dhe plotësonin lirshëm njëri-tjetrin, mësuesja kthente kartën nga ana tjetër në mënyrë që nxënësittë zbulonin përgjigjen e saktë. Të nxitur nga loja, mësuesja ftoi nxënësit të shprehin mendimin e tyre në një pyetje të hapur në forumin online në platformën MësoVET. Mësuesja ndiqte nga platforma përgjigjet dhe komenton mbi to në klasë duke mundësuar një kalim të natyrshëm nga faza e parashikimit drejt fazës së ndërtimit të njohurive të reja. Për këtë të fundit, mësuesja kishte përgatitur një prezantim në PowerPoint, të cilin nxënësit mund ta aksesonin online përmes platformës MësoVET.

Ndërtimi i njohurive të reja u përforcua me realizimin e një loje tjetër interaktive, 'Lojës së memories' ose të quajtur ndryshe 'Loja e përputhjes', këtë herë të realizuar në grupe. Duke luajtur, secili grup duhet të zbulonte e të shkruante sa më shumë elementë në flipchart, të cilat do të prezantoheshin në fund të minutazhit të përcaktuar. Gjatë kësaj faze të orës mësimore, u ndërtua një ndjenjë bashkëpunimi dhe përkrahjeje reciproke, duke ndihmuar në rritjen e aftësisë së nxënësve për të punuar në grup dhe për të mësuar nga njëri-tjetri. Në momentet e fundit të orës mësimore, mësuesja ftoi nxënësit të uleshin në stacionin e tyre të punës, ku secili prej tyre duhet të realizonte online njëkuic të shkurtër në platformën MësoVET. Me mbarimin e kuicit, mësuesja orientoi nxënësit se ku do të ngarkonin detyrën e shtëpisë në platformë.

### Pikat e forta të orës mësimore

- Lojërat ofrojnë një përvojë mësimore tërheqëse dhe përfshirëse. Përmes përdorimit të elementëve të lojës, si sfidat, ndjekja e rezultateve dhe shpërblimi në fund, nxënësit angazhohen dhe ndihen më të motivuar për të mësuar dhe për të arritur objektivat mësimore.
- Lojërat u përdoren për të përforcuar dhe rishikuar konceptet kyçe të mësimin. Përmes përgjigjeve, nxënësit patën mundësinë të testonin njohuritë e tyre, të identifikonin pikat e dobëta dhe të punonin mbi to për t'i përmirësuar.
- Lojërat krijuan një mjedis të kënaqshëm dhe të këndshëm, duke nxitur ndjenjën e suksesit dhe konkurrencës. Ky ndjesi pozitive i inkurajoi ata të jenë më të motivuar dhe të angazhohen në mësim duke ndarë edhe eksperiencën personale.

### Këshilla për replikimin e orës

- Përpara se të integroni lojërat interaktive në mësimdhënie, sigurohuni që ato përshtaten me objektivat mësimore dhe konceptet të cilat dëshironi të përforconi. Lojërat duhet t'i shërbejnë një qëllimi dhe duhet të ndihmojnë nxënësit të arrijnë rezultatet mësimore të dëshiruara.
- Jepni nxënësve tuaj udhëzimet e duhura, duke iu shpjeguar atyre qartë rregullat e lojës dhe çfarë pritet prej tyre.
- Jepni feedback të menjëhershëm në mënyrë që nxënësit të kuptojnë progresin e tyre. Feedback-u mund të jepet nëpërmjet pikëve, çmimeve apo komenteve në lidhje me pyetjet e sakta ose të gabuara.





Rastet e mira

Shkolla "Salih Ceka", Elbasan

Mësuese:  
**Mirela Sarja**

Drejtimi:  
**Ekonomi - Biznes**

Lënda:  
**Sjellje sipërmarrëse XIII**


Tema/çështja:  
**Karakteri dhe synimi i sjelljes sipërmarrëse sipërmarrëse / Aty ku të tjerët shohin problem, sipërmarrësit shohin shanse**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënët:**

1. Argumenton rëndësinë e aftësisë së zgjidhjes së problemeve në sipërmarrje.
2. Evidenton dhe shpjegon metodën e zgjidhjes së problemeve.
3. Aplikon metodën e zgjidhjes së problemeve.

**Metoda e aplikuar:**

PNP (*Parashikim – Ndërtim njohurish – Përforcim*)



### Planifikimi i orës mësimore

Faza e orës së mëimit	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
Parashikimi	Aktivizim i njohurive të mëparshme (rrjet diskutimi)	Online, duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET; flipchart	5 min	Pyetje-përgjigje me klasën; mësuesja liston në flipchart konceptet kryesore të identifikuara nga nxënësit; diskutim i ideve
Ndërtimi i njohurive	Punë individuale	Tradicional	Letra individuale të shkruara	8 min	Secilit nxënës i jepet një problem i vogël i shkruar në një fletë, të cilit duhet t'i japin zgjidhje.
Ndërtim i njohurive	Diskutim mbi njohuritë e reja	Online, duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	12 min	Nisur nga zgjidhjet e kryera, prezantohet materiali në platformë, duke evidentuar në tabelë pikat kyçe.
Përforcimi	Punë në grup me situatë rasti	Tradicional	Flipchart, markera, fleta A4 me situatë rasti	13 min	Dhënia e zgjidhjes së situatës së rastit nga secili grup
Përforcimi	Kuic	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Monitor; kompjuter (mësuesi); laptopë (nxënësit); platforma digjitale MësoVET	5 min	Diskutimi i saktësisë së përgjigjeve të dhëna dhe vlerësim/vetëvlerësim.
Caktimi i detyrave të shtëpisë	Forum	Online (nga shtëpia)	Monitor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	2 min	Udhëzime mbi realizimin e detyrës në platformë

Mësuese Mirela, si një ndër pioneret e hartimit të materialeve mësimore digjitale për arsimin profesional në drejtimin Ekonomi-Biznes, ka arritur të planifikojë një orë të larmishme mësimore, ku gërshetohen më së miri aktivitetet online me ato tradicionale. Mësuesja kishte vendosur të aplikonte modelin e mëimit të kombinuar 'Rotacion sipas stacioneve'. Gjatë orës mësimore, të gjithë nxënësit qarkulluan në të njëjtën kohë në të njëjtat veprimtari. Stacionet përfshinë llojet e veprimtarive të nxënësve: një stacion përmbante punën individuale të nxënësit, një tjetër punën në grup, etj. Qarkullimi i njëkohshëm sipas stacioneve i mundësoi mësueses të monitoronte ecurinë e nxënësve gjatë gjithë procesit.

Ora nisi me rifreskimin e njohurive të fituara më pare nga nxënësit. Në monitor u shfaq materiali i aktivizimit të njohurive nga platforma Mësovet: diskutim rreth thënies së Albert Anjsthanit - "Nëse do të kisha 60 minuta për të zgjidhur një problem, do të kaloja 55 minuta për ta përcaktuar dhe 5 minuta për ta zgjidhur". Nxënësit reflektojnë dhe diskutojnë mbi këtë shprehje, duke zhvilluar mendimin kritik, duke dhënë mendimet e tyre dhe respektuar mendimin ndryshe. Kur njëri prej tyre merrte fjalën, pjesa tjetër degjonte në mënyrë aktive. Më pas, nxënësit ftoheshin në stacionin e tyre të parë të punës. Secilit prej tyre i jepet një problem i vogël i shkruar në një fletë, të cilit duhet t'i japin zgjidhje individualisht dhe paraqesin zgjidhjen me alternativat eventuale. Pasi nxënësit përfunduan punën individuale, mësuesja i ftoi t'i përgjigjen me gojë pyetjes: "Pra aftësia e zgjidhjes së problemeve është natyrale apo mund të mësohet?" - duke kaluar kështu natyrshëm drejt ndërtimit të njohurive të reja që lidhen me temën e ditës. E lidhur me platformën "Mësovet.al" dhe u shpjegoi nxënësve metodën e zgjidhjes së problemeve me 5 hapat e saj.

Gjatë shpjegimit mësuesja shtron pyetje të ndryshme rreth aftësisë së zgjidhjes së problemeve për të angazhuar pjesëmarrjen e nxënësve në shpjegim. Kalimi në stacionin e radhës u bë shumë natyrshëm. Nxënësit u ftuan për të punuar në grup. Klasa u nda në tre grupe. Secilit grup iu dha një situatë rasti për të diskutuar dhe për të gjetur alternativat për zgjidhjen e problemit. Në stacionet e tyre nxënësit ndanë mendime dhe u ndërtua një ndjenjë bashkëpunimi për gjetjen e alternativave të ndryshme. Çdo grup i pasqyroi në flip-chart ato dhe në fund të minutazhit të përcaktuar i prezantoi tek pjesa tjetër e klasës. Që të plotësonin kriteret e mëimit të kombinuar, mësuesja kishte planifikuar disa stacione pune online. Në minutat e fundit të orës, nxënësit, të lidhur në platformën Mësovet, zgjidhën kuicin e çështjes përkatëse. Sipas udhëzimeve të mësueses, detyra e shtëpisë do të realizohej në platformë, në temën e hapur në forum. Mësuesja u komunikoi nxënësve se do t'i rikujtonte ata me një mesazh në llogarinë e tyre në MësoVET.

### Pikat e forta të orës mësimore

- Shfrytëzimi i mirë i funksionaliteteve dhe i materialeve digjitale të disponueshme në platformën MësoVET, të cilat mundësojnë aplikimin e modeleve të ndryshme të mëimit të kombinuar - në rastin konkret 'Rotacioni sipas stacioneve'.
- Aktivizimi i të gjithë nxënësve përgjatë gjithë orës mësimore, falë përvojës mësimore tërheqëse të tyre si në angazhimin në punë individuale ashtu edhe në punë në grup, si në modalitetin online ashtu edhe në atë tradicional.
- Zhvillimi i aftësive të buta si: dëgjimin aktiv, respektimi i mendimeve ndryshe, komunikimi në mënyrë etike duke rritur pozitivitetin dhe zgjidhja e problemeve nëpërmjet mendimit kritik dhe punës në grup
- t'Veprimtaritë e përzgjedhura për fazën e përfundimit të njohurive të reja dhe larmishmëria e tyre ndihmuan më së miri nxënësit për të përfunduar dhe rishikuar konceptet kyçe të orës mësimore..

### Këshilla për replikimin e orës

- Marrja në konsideratë e aftësive digjitale të mësuesit/-es dhe të nxënësve, duke qenë se një model i tillë i orës mësimore karakterizohet nga një kalim i shpeshtë nga njëra veprimtari në tjetrën.
- Vëmendje e veçantë në menaxhimin e kohës së secilit aktivitet kur ato janë të shumta në numër dhe kërkojnë ndryshim modaliteti.
- Dhënia e udhëzimeve paraprake tek nxënësit ose njohja me to në fillim të orës së mëimit, në mënyrë që nxënësit të jenë fleksibël gjatë aplikimit të modelit të 'Rotacionit sipas stacioneve'.

Mësues:  
**Juljan Kasapi**

Drejtimi:  
**TIK**

Lënda:  
**Marketingu digjital XII**

Tema/çështja:  
**Hyrje në marketingun digjital**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënit:**

1. Njeh konceptin e marketingut tradicional.
2. Njeh konceptin e marketingut digjital.
3. Krahason marketingun tradicional me atë digjital.
4. Shpjegon komponentët kryesorë të marketingut digjital.

**Metoda e aplikuar:**

PNP (*Parashikim – Ndërtim njohurish – Përforcim*)



### Planifikimi i orës mësimore

Faza e orës së mëimit	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
Prezantim i temës dhe i objektivave mësimorë		Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Monitor, kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	7 min	Nxënësve u prezantohet tema dhe objektivat mësimorë që synohen të arrihen
Parashikimi	Aktivizimi i njohurive ekzistuese	Tradicional	–	6 min	Me anë të pyetjeve të hapura dhe të mbyllura drejtuar nxënësve, mësuesi kupton nivelin e tyre në një veprimtari të caktuar që po zhvillohet
Ndërtimi i njohurive	Demonstrim i veprimtarisë	Duke shfaqur përmbajtjen e platformave	Monitor, kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET; platforma të tjera	7 min	Mësuesi demonstroi me shembuj nga jeta reale në mënyrë që nxënësit ta kenë më të lehtë për ta kuptuar.
Përforcimi	Praktikë e pavarur	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platforma	Monitor, kompjuter (mësuesi dhe nxënësit); platforma digjitale MësoVET; platforma të tjera	20 min	Nxënësit navigojnë online dhe hapin diskutime në klasë mbi rezultatet e kërkimeve të bëra.
Caktimi i detyrave të shtëpisë		Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Monitor; kompjuter (mësuesi dhe nxënësit); platforma digjitale MësoVET	5 min	Dhënie udhëzimesh për realizimin e detyrës së shtëpisë.

## Realizimi i orës mësimore

---

Të gjithë nxënësit janë të pajisur me desktope AiO (All in One), duke qenë se ora realizohet në laboratorin e TIK. Nxënësit ftohen të logohen në platformën MësoVET dhe mësuesi asiston nga afër dhe me shkathtësi ata që kanë vështirësi për t'u loguar, që kanë nevojë të rikthejnë fjalëkalimin apo të gjejnë vendndodhjen e materialit të ditës në platformë. Ora nisi me pyetje të hapura e të mbyllura mbi njohuritë e përgjithshme të nxënësve. Që në fillim të orës, mësuesi mori natyrshëm rolin e facilituesit të të nxënës duke përmendur fakte dhe sjellë informacion të përditësuar për të nxitur diskutimin. Në mënyrë fluide, mësuesi kanalizoi bisedën drejt informacionit të ri për të cilën përdori përmbajtjen digjitale në platformën MësoVET.

Me qëllim vendosjen e nxënësve në qendër të orës mësimore, pas shpjegimit të koncepteve kryesore, mësuesi i ftoi ata të navigojnë së bashku në faqe të ndryshme në internet. Kalimi nga platforma MësoVET në faqe të tjera interneti dhe përsëri në MësoVET, realizohej me lehtësi. Në këtë orë ra në sy larmishmëria e burimeve të hapura të informacionit dhe formës digjitale se si ato ishin sjellë në platformë- tekst, video, faqe të integruara, pdf, etj. Materiali ishte përditësuar dhe personalizuar paraprakisht nga mësuesi për t'iu përshtatur metodës së mësimdhënies, si dhe për të ndihmuar nxënësit gjatë punës së tyre të pavarur. Nëpërmjet rezultateve të sjella nga nxënësit nga puna e pavarur, mësuesi arrin të përcjelljellë informacionin e ri. Ai drejtonte vazhdimisht pyetje frontale, saktësonte përgjigjet në thellohej në nocione. Në fund, mësuesi u prezantoi nxënësve një raport digjital për vitin 2023 "We are social 2023", ku theksohej gjithçka që ata duhet të dinë rreth trendeve të mediave sociale, internetit, aparatit celular dhe tregtisë elektronike në mbarë botën. Mjedisi mësimor është i gjallë dhe nxënësit ndihen të përfshirë, falë vënies në dispozicion statistikave interesante botërore dhe rajonale dhe informacionit të larmishëm dhe i kontekstualizuar me temën e ditës.

Mësuesi vendosi theksin sesi nxënësit mund të përdornin informacionin në avantazhin e tyre dhe pse ai do t'ju shërbejë nëse ato vendosin të profilizohen në marketing digjital. Në 5 minutat e fundit, mësuesi orientoi nxënësit se ku mund të realizojnë kuicin online në platformën MësoVET në kushtet e shtëpisë, si dhe dha detyrën e shtëpisë, ku paskërkimit të informacionit mbi një temë të caktuar, nxënësit do të shprehnin në forumin e hapur online mendimin e tyre mbi këtë temë.

### **Pikat e forta të orës mësimore**

- Natyrshmëria në përdorimin e teknologjive digjitale nga ana e nxënësve, duke mundësuar përfundimin maksimal nga secila veprimtari.
- Menaxhimi mjaft i mirë i kohës, pa krijuar ngut te nxënësit në pjesëmarrjen në veprimtari dhe pa përsheptuar procesin e përcjelljes së njohurive të reja.
- Shfrytëzimi i një larmie burimesh informacioni dhe materialesh mësimore në shërbim, duke krijuar një mjedis të nxënësve të pasur, të gjallë dhe angazhues, ku aftësitë konsolidohen më lehtë.

### **Këshilla për replikimin e orës**

- Platforma MësoVET të mundëson larmishmëri në funksionalitete dhe burimet e hapura të informacionit që mund të integrohen, por koha në dispozicion është e limituar. Për këtë arsye, këshillohet përzgjedhja me kujdes e burimeve të përdorura në klasë, të përmbledhura, të strukturuar dhe të përshtatshme për nxënësit tuaj, si dhe e atyre që nxënësit mund të konsultojnë në kushtet e shtëpisë.
- Sigurohuni që të gjithë nxënësit të kenë një llogari dhe akses në materialet digjitale të një lëndës. Udhëzoni nxënësit tuaj që të testojnë hyrjen në platformë para orës së mësimi.



Mësuese:  
**Fabiola Grykshi**

Drejtimi:  
**Ekonomi-biznes**

Lënda:  
**Marketing XII**

Tema/çështja:  
**Menaxhimi i marketingut / Marketingu në tregti, rëndësia e tij**

**Objektivat/ rezultatet e të nxënit:**

1. Tregon çfarë është marketingu tregtar.
2. Përshkruan karakteristikat e marketingut tregtar.
3. Analizon dobinë e marketingut në tregti.

**Metoda e aplikuar:**

PNP (*Parashikim – Ndërtim njohurish – Përforcim*)



## Planifikimi i orës mësimore

Faza e orës së mëimit	Veprimtaria	Modaliteti i zhvillimit	Infrastruktura	Koha	Shënime
Prezantimi i temës së mëimit dhe i objektivave mësimorë		Duke shfaqur përmbajtjen e platformës	Videoprojektor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	5 min	Njohja e nxënësve me temën e mëimit dhe objektivat e synuar për t'u arritur gjatë orës
Parashikimi	Stuhi mendimesh	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës (prezantim)	Videoprojektor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET	5 min	Ftohen nxënësit të japin idetë e tyre mbi thënien "Marketingu në Tregti, thelbi i zinxhirit të furnizimit"
Ndërtimi i njohurive	Prezantim / punë në dyshe	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës + tradicional	Videoprojektor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET; letra me ngjyra; flipchart	20 min	Shpjegim i koncepteve me anë të prezantimit; ndërtim i njohurive me anë të diskutimit në epike dyshe; paraqitje e inputit të nxënësve në flipchart
Përforcimi	Kuic	Online, me ndërveprimin e nxënësve në platformë	Videoprojektor; kompjuter (mësuesi); aparate celulare (nxënësit); platforma Kahoot!	5 min	Dhënie udhëzimesh mbi logimin në platformën Kahoot!; zhvillim i kuicit; feedback mbi përgjigjet e dhëna; shpallje fituesish
Caktimi i detyrave të shtëpisë	Ese	Tradicional	–	2 min	Tema e esesë "Kush e përdor marketingun tregtar"; dhënie udhëzimesh mbi realizimin
Vlerësim	Vlerësimi i shokut	Duke shfaqur përmbajtjen e platformës + tradicional	Videoprojektor; kompjuter (mësuesi); platforma digjitale MësoVET; letra me ngjyra	8 min	Shfaqje e kritereve të vlerësimit të shokut nëpërmjet prezantimit në platformë; qarkullim i fletave për dhënie vlerësimi; argumentim

Ndërtimi i një ore mësimore që u ofron nxënësve një përvojë të pasur dhe efikase mësimore është synimi kryesor i çdo mësuesi. Shfrytëzimi i platformave digjitale, pavarësisht sfidave tashmë të njohura, e lehtëson shumë këtë mision. Ky vizion prin edhe punën e përditshme të mësuese Fabiola Grykshit, e cila realizoi një orë të suksesshme mësimore edhe në kuadër të orëve të hapura, me përdorimin e teknologjive digjitale. Ora nisi me prezantimin e çështjes së ditës dhe të objektivave të synuara, duke përfshirë edhe identifikimin e aftësive të buta që do të përforcohen. Prezantimi, i realizuar në programin Power Point, u aksesua nga platforma MësoVET, në të cilin ishte ngarkuar. Duke u ndalur në një prej slide-eve të prezantimit, ku u shfaq thënia "Marketingu në Tregti, thelbi i zinxhirit të furnizimit", mësuesja i ftoi nxënësit të aktivizoheshin në një stuhi mendimesh (brainstorming), në kuadër të fazës së parashikimit. Përgjigjet e nxënësve u dhanë me gojë nga vendi, teksa mësuesja i sintetizonte në flipchart, duke theksuar edhe konceptet thelbësore.

Pas fazës sëparashikimit, u kalua te ndërtimi i njohurive, përmes një prezantimi në Power point dhe punës në dyshe. Dysheve iu caktua të diskutonin mes tyre mbi rëndësinë e marketingut në tregti dhe më pas të përmbledhnin diskutimin në fleta me ngjyra, të cilat u ngjiten nga mësuesja te fleta e flipchartit. Veprimtaria vijoi me leximin dhe komentimin e përgjigjeve nga mësuesja. Një veprimtari e tillë, e mbështetur në qasjen e konstruktivizimit social, u shoqërua me gjallëri dhe motivim të nxënësve në klasë. Gradualisht, ora avancoi drejt fazës së përforcimit të njohurive përmes realizimit të një kuici në platformën Kahoot!. Të gjithë nxënësit aksesuan kuicin përmes aparateve të tyre celulare, duke u ndërvepruar me përmbajtjen dhe opsionet e kësaj platforme dhe aktivitetit të përzgjedhur.

Përmes të nxënit nëpërmjet lojës, ora mori një dimension interaktiv dhe nxënësit përfituan duke konsoliduar konceptet e reja në mënyrë argëtuese. Pas mbarimit të lojës, duke shfrytëzuar edhe opsionet e platformës Kahoot!, mësuesja shpalli dhe përgëzoi tri fituesit. Më tej, ora vijoi me dhënien e detyrave të shtëpisë, në formën e një eseje mbi marketingun tregtar. Nxënësit u ftuan të japin shkurtimisht ide për zhvillimin e detyrës, ndërkohë që mësuesja komentonte vazhdimisht idetë e tyre dhe i motivonte për t'i vënë në jetë.

Ora u pasua nga një tjetër veprimtari, nëpërmjet së cilës u realizua « vlerësimi i shokut », nëpërmjet kriterëve të paraqitura në slide-t e prezantimit, sipas një shkalle nga 1 në 5 pikë. Nxënësit çarkulluan fletat me ngjyra ku kishin shënuar emrin e nxënësit apo të nxënësës dhe përkrah shënonin vlerësimin sipas kriterëve. Në fund, mësuesja i njohu nxënësit me vlerësimin, duke u ndalur tek arsyet, në bashkëpunim me nxënësin/en që e kishte përcaktuar atë vlerësim. Kjo veprimtari përmbylli edhe orën e hapur. Në tërësi, ora ishte dinamike dhe më larmi veprimtarish që synuan jo vetëm përforcimin e njohurive, por edhe zbatimin e koncepteve teorike në praktikë. Interesi ishte i lartë, nxënësit u menaxhuan mirë dhe qëndruan të motivuar deri në fund të orës.

### **Pikat e forta të orës mësimore**

- Përdorimi i një larmie metodash dhe mjetesh në shërbim të të nxënit, si: material i përmbledhur mësimor në formë prezantimi të aksesuar nga platforma MësoVET, brainstorming në karta moderimi, kuic në kahoot, duke krijuar një mjedis mësimor angazhues, si dhe duke lehtësuar procesin e përthithjes së njohurive.
- Menaxhimi i suksesshëm i klasës edhe pse në një format zhvillimi jotradicional të orës mësimore.
- Përdorimi i teknikës së vlerësimit të shokut, si një vlerë e shtuar në procesin e vlerësimit në tërësi.

### **Këshilla për replikimin e orës**

- Shfrytëzimi i modalitetit të punës së nxënësve në dyshe për të vendosur edhe më shumë theksin tek aftësitë e buta, si: dëgjimi aktiv, komunikimi i strukturuar, mendimi kritik, bashkëpunimi etj.
- Përdorimi më kompleks i platformës MësoVET, për të realizuar veprimtari me pjesëmarrjen aktive të nxënësve në të, duke rritur edhe nivelin e angazhimit.

## Në vend të mbylljes...

---

Vënia në jetë e nismës së orëve të hapura, së bashku me diskutimet dhe dhënien e feedback-ut nga ekspertë dhe kolegë, mundësoi nxjerrjen e disa mësimëve të vlefshme, si dhe sugjerimet e mëposhtme:

### Mësimet e nxjerra:

- Orët mësimore në modalitet të kombinuar realizohen me sukses si nga mësues me përvojë të kufizuar në përdorimin e teknologjive arsimore në mësimdhënie, ashtu edhe me aftësi bazë digjitale.
- Përdorimi i platformave arsimore rrit efikasitetin e orëve mësimore në të gjitha lëndët, qoftë ato të kulturës së përgjithshme, profesionale, teorike apo praktike.
- Mungesa e materialeve mësimore digjitale të gatshme në platformën MësoVET, nuk paraqet pengesë për zhvillimin e orëve mësimore përmes saj, pasi mund të përshtaten dhe krijohen veprimtari të reja.
- Mësuesit kanë nevojë për zhvillim të mëtejshëm të aftësive digjitale, njohurive mbi mësimdhënien e kombinuar, si dhe të përdorimit të platformave arsimore në mënyrë organike.
- Ora mësimorë nëpërmjet MësoVET rrit efikasitetin e procesit mësimor: nxitet ndërveprimi, rritet angazhimi i nxënësve dhe orët janë më tërheqëse.

### Sugjerime për mësuesit:

- Reduktimi i numrit të veprimtarive brenda një orë mësimore, për të shmangur shpërqendrimin e nxënësve dhe kalimin e përciptë të fazës së përcjelljes së njohurive të reja.
- Përshtatja ndaj ritmit të punës së nxënësve, sidomos gjatë veprimtarive online, duke harmonizuar numrin e veprimtarive dhe minutazhin në dispozicion.
- Shfrytëzim më eficient i kohës, duke aplikuar klasën e përmbysur në disa veprimtari online që mund të kryhen para orës mësimore (p.sh. ndjekja e një videoje paraprakisht nga nxënësit).
- Përdorimi i një larmie më të gjerë veprimtarish në platformë, duke nxitur pjesëmarrjen aktive të nxënësve (p.sh. Wiki, Choice, Debate etj, përveç prezantimeve, kuiceve, forumeve dhe detyrave).
- Përdorimi i MësoVET edhe në dhënien e feedback-ut në kuadër të vlerësimit të vazhduar (p.sh. për detyrat e shtëpisë).
- Referim më i shpeshtë ndaj rezultateve automatike të gjeneruara nga platforma në veprimtari si kuici apo forma të tjera të matjes së njohurive të nxënësve.
- Thjeshtim i perceptimit të mësuesve mbi orën e mësimit të zhvilluar nëpërmjet platformave arsimore.
- Vijim i zhvillimit të orëve mësimore nëpërmjet platformës, për të fituar më shumë përvojë e siguri.

Në tërësi, eksperiencia me orët e hapura përmes platformës MësoVET dëshmoi se pavarësisht nivelit të aftësive digjitale, përvojës në ndërthurjen e teknologjive arsimore në mësimdhënie apo natyrës së lëndës, të gjithë mësuesit mund të realizojnë mësimin e mbështetur në përdorimin e platformës MësoVET. Kjo mund të kryhet në modalitete të ndryshme të organizimit të orës, sipas një qasjeje graduale. Njëkohësisht, duke e përdorur platformën herë si prezantim i përmbajtjes digjitale në ekran, herë duke ftuar nxënësit të aktivizohen në të, mësuesit dhe kolegët pjesëmarrës në orët e tyre të hapura u ndërgjegjësuam më tej mbi fleksibilitetin dhe mundësinë që krijon përdorimi i platformave arsimore në funksion të objektivave mësimore dhe angazhimit të nxënësve.



## Nga vizioni në realitet

Raste të suksesshme të një ore mësimore me platformën MësoVET

## RASTE STUDIMORE 2023

---

### Le të mbetemi në kontakt!

 [www.aftesiperpune.al](http://www.aftesiperpune.al)  [@S4J.Swisscontact](https://www.facebook.com/S4J.Swisscontact)  [skills\\_for\\_jobs](https://www.instagram.com/skills_for_jobs)

 [Skills for Jobs Albania](https://www.linkedin.com/company/skills-for-jobs-albania)  [Aftësi për Punë S4J](https://www.youtube.com/channel/UC...)

Regjistrohuni te buletini ynë: [al.info@swisscontact.org](mailto:al.info@swisscontact.org)